

ANDREA LLUKANI

**KRISTOFOR KISI
KRYEPESHKOPI I PARË KANONIK
I KISHËS ORTODOKSE**



Tiranë, 2020

ANDREA LLUKANI

KRISTOFOR KISI

**KRYEPESHKOPI I PARË KANONIK
I KISHËS ORTODOKSE**

Tiranë, 2020

© Të gjitha të drejtat janë të autorit

Redaktor: **Prof. dr. Hajri Shehu**

PARATHËNIE

Kristofor Kisi (1890-1958) ka lindur në lagjen “Kala” të Beratit në vitin 1890. Studimet e larta i ndoqi në “Shkollën Patriarkale” të Halkit ku u diplomua në vitin 1906. Tema që mbrojti diplomën ishte “Mbi prejardhjen e jetës monakale”. Me përfundimin e studimeve teologjike më 1908 u kthye në atdhe dhe filloi punë në gjimnazin e Jovan Bangës në Korçë. Para Luftës Ballkanike vajti në Kostandinopojë dhe në vitin 1916 u dorëzua në gradën priftërore. Ai ishte kryefamulltar në Makrohor. Më vonë u hirotonis episkop i Sinadës, post të cilin e mbajti deri në vitin 1923. Pikërisht këtë vit, duke parë përpjekjet e otodoksëve shqiptarë për autoqefali, Imzot Kristofori u kthye vullnetarisht në Shqipëri, ku mori në drejtim Mitropolinë e Beratit duke pasur titullin "Mitropolit i Beratit, Vlorës dhe Kaninës". Më 21 nëntor 1923 Imzot Kristofori së bashku me Imzot Jerotheun dorëzuan në gradën episkopale Theofan Nolin në kishën e "Shën Gjergjit" në Korçë. Në vitin 1929 u tërhoq në manastir duke mos marrë pjesë në veprimet antikanonike, që po kryheshin në Kishën Ortodokse Shqiptare. Më 1934 Imzot Kristofori zuri vendin e "Mitropolitit të Korçës" dhe në vitin 1937 u zgjodh Kryetar i Sinodit të Shenjtë dhe Kryepiskop i gjithë Shqipërisë. Për shumë vjet qëndroi në krye të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Në vitin 1942 Kryepiskop Kristofori u thirr prej mëkëmbësit të mbretit Viktor Emanuelit III, Jakomonit dhe iu bë presion, që në vendet vakante të dorëzoheshin episkopë unitë dhe të bëhej konvertimi i popullsisë ortodokse të Shqipërisë në uniata. Kryepiskopi Kristofor i detyruar nga kushtet e vështira që po kalonte Kisha Ortodokse nën sundimin fashist në fillim pranoi, por ndërkohë u mundua që ta shtynte çështjen për më vonë. Ai thirri teologun Irine Banushi dhe i propozoi që të dorëzohej në gradën episkopale, duke shmangur kështu një rrezik të madh për kishën. Më 1948 Kryepiskopin Kristofor e internuan dhe më 17 qershor 1958 ai vdiq në rrethana të dyshimta në kishën e "Shën Prokopit". Ai nuk pranoi që të mohonte kryqin për lavdinë tokësore, që i ofroi regjimi komunist, prandaj e helmuan. Varrimi i Kryepiskopit Kristofor Kisi u bë më datën 18 qershor 1958. Arkivoli që mbante lipsanin e tij u vendos në mesin e kishës katedrale të “Ungjillëzimit” në Tiranë. Ceremonia e përmortshme u kryesua nga Fortlumturia e tij, Paisi, me pjesëmarrjen e Episkopit Ndhimës Sofronit, Arkimandrit Dhanil Çulit, Stavrofor Thoma Popës, Ikonom Marko Papajanit, Saqellar Petro Doçit, Kryedhjakonit Sotir Kanxherit etj. Në prani të të afërmve dhe besimtarëve të shumtë që kishin mbushur kishën, foli Sekretari i Sinodit të Shenjtë, Niko Çane, i cili theksoi virtytet e të ndjerit. Ndër të tjera ai përmendi ndershmërinë, urtësinë dhe kulturën e gjerë të Kryepiskopit Kristofor¹.

¹-Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 178-180; Andrea Llukani, *Krishterimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2014, faqe 132; Dhimitër Beduli, *Teologë me origjinë shqiptare që janë diplomuar në Institutin Teologjik të Halkit*, Ngjallja, tetor 1996, faqe 10; Kristofor Beduli, *At Marko Papajani dhe shënimet e tij*, Tiranë 2004, faqe 37-38; *Personalitet madhor i Kishës sonë Orthodhokse*, Ngjallja, korrik 1996, faqe 9.

KREU I PARË

KONGRESI I BERATIT

Nismëtari për mbledhjen e kongresit ishte kryetari i Bashkisë së Durrësit, Kostë Paftali. Ky i fundit duke u nisur nga qëllimi i mirë për eliminimin e përçarjes² midis ortodoksëve shqiptarë³ mori nismën, që të organizonte kongresin. Për këtë qëllim u dërgoi telegrame⁴ qarqeve ortodokse të prefekturave dhe nënprefekturave të Korçës, Beratit, Gjirokastrës, Vlorës, Elbasanit, Durrësit dhe Shkodrës. Çdo rreth zgjodhi dy delegatë dhe u tregua kujdes i veçantë që ata t'i përfaqësonin denjësisht. Peshën më të rëndë nga ana organizative dhe kanonike e mbajti Visarion Xhuvani, si njohës i mirë i kanoneve kishtare dhe i ligjeve të shtetit, si anëtar i Këshillit Kombëtar i zgjedhur nga Kongresi i Lushnjës.

Më 10 shtator të vitit 1922, në sallën e shkollës qendrore të qytetit të Beratit, u mbledhën delegatët e kongresit kishtar⁵, që ishin dërguar nga ortodoksët e prefekturave

²-Noli nuk mori pjesë në Kongresin e Beratit, që të mos kishte përplasje midis rrymave kishtare. Qëllimi i kongresit ishte që të bindte Patriarkanën Ekumenike të pranonte një përfaqësi nga kisha shqiptare për të diskutuar për çështjen e dhënies së autoqefalisë. Prandaj në marrëveshje me qeverinë Noli qëndroi i mënjanuar, sepse pjesëmarrja e një episkopi të vetëshpallur do të ngjallte reagimin e Patriarkanës Ekumenike. Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 115.

³-Dy rrymat midis delegatëve të kongresit qenë: 1-Fanolistët, që përfaqësoheshin nga delegatët e Mitropolitë së Korçës atë Josif Qirici, Dhosi Havjari, atë Jorgji, Anastas Çekrezi, Oshënar Sofroni, Dhimitri Ndini, atë Vangjel Çamçe, Thomo Prifti, Stathi Kondi, Vasil Zoto, Vasil Marku etj. 2-Përkrahësit e Visar Xhuvanit qenë: Gjergj Manushi, Kostë Paftali, Leonidha Nishku, Rist Gjybaçiç, Gjok Nikolliç etj. Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 118.

⁴-Në telegram shkruhej: "I nënshkruemi tue marrë parasysh përçamjen dhe mosmarrëveshjet që po vazhdojnë ndërmjet vëllezëve shqiptarë ortodoksë mbi çashtje që i përkasin kishës ortodokse, me që kjo gjendje po damton jo vetëm çashtjen fetare ortodokse por damton rreptësisht edhe shtetin tonë shqiptar si dhe kombin, po marr leje me i propozue vëllezëve shqiptarë që të formohet sa ma parë një kongres për me shërue këtë plagë të hapun dhe në mbrojtje të dinjitetit si komb e si fe". Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi 647, Dosja nr. 206, fl. 1-2.

⁵-Delegatët qenë sipas rretheve: Korça - Ikonom Papa Josifin dhe Dhori Havjarin. Pogradeci - Atë Vasil Marku dhe Thanas P. Kërzhallin. Bilishti - Atë Josifin dhe Anastas Çekrezin. Kolonja - Oshënar Sofronin dhe Dhimitër P. Ninin. Leskoviku - Atë Vangjel Çamçen dhe Thanas Priftin. Berati - Perikli Konën dhe Dhimitër Tutulanin. Fieri - Loni Xhoxhën dhe Dhimitër Qilicën. Durrësi - Arkimandrit Visar Xhuvanin dhe Gjergji Manushin. Përmeti - Dr. Kondin dhe Vasil Kotën. Vlora - Tol Arapin dhe Jani Seranin. Lushnja - Tun Gjergjin dhe Llazar Bozon. Kavaja - Pal Xhumarin dhe Andrea Ikonomin. Tirana - Papa Simonin dhe Mark Hobdarin. Elbasani - Vasil Llapushin (Fig.6) dhe Simon Shuteriqin. Shpati - Taq Budën dhe Dhimitër Pappariston. Dibra - Leonidha Nishkun dhe Kostë Paftalin. Libohova - Spiro Katin. Visarion Xhuvani, *Kujtim veprë dhe intrige*, shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926, faqe 7-8; Nos Xhuvani, Pavli Haxhillazi, *Na flet Visarion Xhuvani*, Tekno Paper, Tiranë 2008, faqe 57; *Visarion Xhuvani, në kishë, në parlament dhe në burg*, Vepra, botimet 55, Tiranë 2007, faqe 56; Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Si nisi lëvizja për shqiptarizimin e kishës ortodokse autoqefale*, Tema, 10-11 prill 2005, faqe 9; Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016; faqe 119; Andrea Llukani, *Kanonet dhe statutet e Kishës Ortodokse*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 187; Andrea Llukani, *Krishterimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2014, faqe 85-86; Dhimitër Beduli, *Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë deri në vitin 1944*, botim i

dhe të nënprefekturave për të paraqitur letër kredencialet. Për verifikimin e tyre u zgjodh një komision i posaçëm me kryetar Perikli Konën, sekretar Vasil Llapushin dhe anëtarë atë Vangjel Çamçen, Stathi Kondin dhe Taq Budën.

Mbas një pune serioze dhe cilësore përgatitore, Kongresi (Fig.1) u mbledh në sallën e shkollës së Mangalemit ditën e hënë më 11 shtator 1922. Kryetari i komisionit të mandateve Perikli Kona ia dha fjalën Kryetarit të Bashkisë së Beratit, i cili u uroi të pranishmëve mirëseardhjen. Mbas fjalës përshëndetëse të iniciatorit Kostë Paftali e mori fjalën përfaqësuesi i qeverisë Zenel Prodani, mbas tij arkimandrit Visarion Xhuvani dhe mbas tij delegati i Pogradecit, atë Vasil Marku⁶. Punimet e Kongresit u kryesuan nga atë Josif Qirici nga Korça në shenjë respekti për atë qytet që ishte pararendësi i përpjekjeve për autoqefalinë e kishës shqiptare. Atë Josifi njoftoi të pranishmit se qëllimi i mbledhjes së Kongresit të Beratit ishte shpallja e Kishës Autoqefale Ortodokse Kombëtare.

Menjëherë pas tij, arkimandrit Visar Xhuvani shpalli pavarësinë administrative të Kishës Ortodokse të Shqipërisë sipas vendimit: "Të gjithë Delegatët e Kongresit, Klerik e Laik, me një zë dhe entuzjazëm në emër të gjithë klerit dhe popullit ortodoks shqiptar, duke u bazuar edhe në faktin se Shqipëria u njoh prej gjithë shteteve të botës si një shtet i pavarur dhe sovran dhe mbi këtë bazë sipas kanoneve të shenjtë të Kishës Ortodokse në shtet të pavarur - kishë e pavarur, duke pasur për shembull edhe kishat autoqefale të Rusisë, Greqisë, Rumanisë etj, deklarojmë në emrin e Trinisë së Shenjtë të njëqenishme dhe të pandarë Autoqefalinë e Kishës Ortodokse të Shqipërisë, "de facto" sepse "de jure" ka qenë që prej ditës së shpalljes së independencës politike të shtetit shqiptar, duke mbajtur lidhje shpirtërore, dogmatike e apostolike me Patriarkanën Ekumenike dhe me kishat e tjera ortodokse autoqefale të botës. Rroftë Kisha Autoqefale"⁷. Të pranishmit u ngritën më këmbë dhe brohoritën "Rroftë Kisha Autoqefale" dhe në vijim nënshkruan. Sipas veendimit të Kongresit të Beratit Kisha Ortodokse e Shqipërisë ishte autoqefale prej vitit 1912, atëherë kur u shpall pavarësia e Shqipërisë. Ky fakt bazohej në parimin "kishë e pavarur në shtet të pavarur". Problemi ishte që nuk kishte asnjë episkop në Shqipëri. Që një kishë të ishte autoqefale duhej të kishte të paktën katër episkopë të dorëzuar në mënyrë kanonike. Kongresi i Beratit kërkoi edhe ndihmën e qeverisë që t'i bëhej kërkesë Patriarkanës Ekumenike për njohjen e pavarësisë së Kishës Ortodokse të Shqipërisë, si dhe për emërimin e dy mitropolitëve me origjinë shqiptare të propozuar nga këshilli.

K.O.A.Sh-it, Tiranë, 1992, faqe 22; Dhimitër Beduli, *Kishë dhe kulturë*, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2006, faqe 47.

⁶-Kaliopi Naska, *Kongresi themeltar i Kishës Ortodokse Autoqefale në Berat*, në *70-vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Akademia e shkencave, Tiranë 1993, faqe 14-15.

⁷-Fletore Zyrtare, Nr. 49, datë 26.10.1922; Visarion Xhuvani, *Kujtim veprë dhe intrige*, shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926, faqe 7; Dhimitër Beduli, *Kisha Orthodokse Autoqefale e Shqipërisë deri në vitin 1944*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë, 1992, faqe 22-23; Dhimitër Beduli, *Kishë dhe kulturë*, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2006, faqe 47-48.

Në ditën e tretë të punimeve Kongresi votoi Statutin⁸ e parë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, i cili përbëhej nga 14 artikuj. Në nenin I, Statuti përcaktonte se Kisha Ortodokse Autoqefale Kombëtare e Shqipërisë ishte pjesë e pandarë e Kishës së Përgjithshme Ortodokse. Ajo përbëhej nga ortodoksët e shtetit shqiptar dhe sundohej prej episkopëve kanonikë, duke ruajtur kanonet e shenjta apostolike e sinodike. Statuti përcaktonte se kisha do të drejtohej nga sinodi i cili do të përbëhej prej peshkopësh kanonikë nën kryesinë e një mitropoliti. Ky sinod do të kishte titullin e Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale Kombëtare të Shqipërisë. Kisha do të drejtohej nga Këshilli i Lartë Kishtar, derisa të zgjidheshin episkopët kanonikë me pëlqimin nga Patriarkana Ekumenike ose nga kishat e tjera simotra vrenda dy vjetëve. Episkopët që do të dorëzoheshin do të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Kishtar pasi të betoheshin me ndërgjegje priftërore para Perëndisë për besnikëri ndaj shtetit shqiptar dhe Kishës Ortodokse Autoqefale Kombëtare të Shqipërisë. Në nenin X, Statuti përcaktonte se gjuha e kishës qe shqipja. Meqenëse mungonin përkthimet kishtarë Paqësoret⁹, Ungjilli¹⁰, Apostulli¹¹ dhe lutja Ati ynë do të lëçiteshin detyrimisht në shqip. Këshilli i Lartë Kishtar do të bashkonte të gjitha episkopatat e atyre viseve që patën mbetur jashtë kufirit të shtetit shqiptar. Librat për përdorimin liturgjik do të njiheshin vetëm nëse kishin vulën e Këshillit të Lartë Kishtar. Duhet theksuar se deri në atë kohë qenë përkthyer këta libra liturgjikë

⁸-Statuti i Kishës Orthodokse Autoqefale të Shqipërisë, Dhori Koti, Korçë 1923; Visarion Xhuvani, *Kujtim vepra dhe intrige*, shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926, faqe 8-10; Visarion Xhuvani, në *Kishë, në Parlament dhe në burg*, Vepra, botimet 55, Tiranë 2007, faqe 57-59; Nos Xhuvani, Pavli Haxhillazi, *Na flet Visarion Xhuvani*, Tekno Paper, Tiranë 2008, faqe 58-60; Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Si nisi lëvizja për shqiptarizimin e kishës ortodokse autoqefale*, Tema, 10-11 prill 2005, faqe 9; Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Si betoheshin episkopët e kishës ortodokse shqiptare*, Tema, 12 prill 2005, faqe 9; Andrea Llukani, *Kanonet dhe statutet e Kishës Ortodokse*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 184-186; Andrea Llukani, *Krishterimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2014, faqe 87-90.

⁹-Paqësoret janë lutje, të cilat fillojnë me fjalët “me paqe” ose “për paqen”. Quhen paqësore, sepse nëpërmjet tyre kërkojmë paqen e Perëndisë. Me anën e paqësoreve lutemi për shpëtimin e shpirtave, për qëndrimin e mirë të kishave të Perëndisë dhe për bashkimin e të gjithëve, për ata që hyjnë në kishë me shprestari dhe frikë Perëndie. Lutemi për peshkopët, priftërinjtë, dhiakonët dhe për gjithë popullin, për kombin, presidentin, qytetin dhe vendin, për begatinë e pemëve, për udhëtarët, për të sëmurët, vuajtësit dhe robërit. *Dhiaku: Me paqe le t'i lutemi Zotit*. Dhiaku fton besmirët që t'i luten Zotit me paqe, qetësi dhe në heshtje. Besimtarët duhet të jenë të përkushtuar tek Perëndia dhe të ndjekin paqësisht lutjen e përbashkët. Andrea Llukani, *Si kusari thërres, komenti i liturgjisë hyjnore të Joan Gojartit*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2010, faqe 8-9.

¹⁰-Me Ungjill kuptojmë librin liturgjik të kishës, i cili përmban pjesë nga të katër librat e shenjtë atë të Matheut, Markut, Lukës dhe Joanit, të cilët flasin për jetën dhe mësimdhënien e Isu Krishtit. Pjesët ungjillore lëçiten gjatë Liturgjisë Hyjnore ose nëpër shërbesa të tjera të kishës. Ungjilli simbolizon Krishtin, prandaj vendoset mbi Tryezën e Shenjtë. Andrea Llukani, *Si kusari thërres, komenti i liturgjisë hyjnore të Joan Gojartit*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2010, faqe 21-22.

¹¹-Apostulli përmban pjesë nga Veprat e Apostujve dhe letrat e Dhiatës së Re, për të dielat, të kremtet, ditët e zakonshme dhe për shërbesa të ndryshme. Kisha ka një seri të caktuar të këndimeve të Apostullit për çdo ditë të vitit, me përjashtim të ditëve të javës së Kreshmeve të Mëdha. Apostulli zakonisht lëçitet prej lexuesit (anagnostit) nga solea e kishës. Pas mbarimit të “Shenjt Perëndi ...” dhiaku del te Dera e Bukur. Lexuesi (anagnosti) thotë vargun e parë të Apostullit. Andrea Llukani, *Si kusari thërres, komenti i liturgjisë hyjnore të Joan Gojartit*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2010, faqe 20-21.

kishtarë nga Fan Noli: "Shërbesat e Javës së Madhe"¹², "Librë i shërbesave të Shënjtja të Kishës Orthodokse"¹³, "Të kremtet e mëdha të Kishës Orthodokse"¹⁴, "Triodi i vogël"¹⁵, "Lutësorja"¹⁶ dhe "Pesëdhjetore e vogël"¹⁷. Tre muaj pasi të qe krijuar Sinodi i Shënjtë, një Asamble Kishtarë do të mblidhej për të miratuar statutin dhe rregulloren përfundimtare. Statuti u këndua para kongresit dhe u pëlqye e u nënshkrua nga delegatët pjesëmarrës.

Autoriteti më i lartë i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë ishte Këshilli i Lartë ose siç quhej ndryshe Sinodi Provizor. Ky Këshill do të merrej me çështjet e drejtimit të kishës deri në krijimin e Sinodit Episkopal. Kryetar i Këshillit të Lartë Kishtar u zgjodh delegati i Pogradecit, atë Vasil Marku¹⁸. Këshilli i Lartë Kishtar përbëhej nga katër klerikë dhe katër laikë. Anëtarët klerikë të Këshillit të Lartë Kishtar (1922-1923) qenë: Kryetar Atë Vasil Marku, Anëtarë klerikë:

¹²-Në vitin 1908 Imzot Theofani përktheu librin liturgjik "Shërbesat e Javës së Madhe", 103 faqe, botuar nga Kisha Ortodokse shqiptare në Amerikë. Ky libër përmban himne dhe lexime të Javës së Madhe dhe të Pashkëve.

¹³-“Librë i shërbesave të Shënjtja të Kishës Orthodokse” është përkthyer prej të përndershmit At Theofan Nolit dhe është botuar në Boston Mass të Amerikës në vitin 1909. Libri përmban shërbesat e Mbrëmësore, Mëngjesore, Blata e Hyjshme, Meshat e Gojartit, Pagëzimi, Martesa, Rrëfimi, Prehja për të vdekurin, Bekimi i Vogël i Ujit, Hymne prej Lutjesore, dhe Zbritësoret e Motit. Në fund të librit gjendet një fjalor i termave të kishës, i cili jep shpjegimin e termave teologjikë shqip-greqisht. Libri përfundon me listën e ndihmëtarëve. Në parathënien e librit lexojmë: “Po u fal shqiptarëve Ortodokë këtë librë e cila është e dyta, dhe pandeh që përdorja e saj do t’i siellë një shërbim vëndit tonë. I kam dhënë zotim kombit t’im t’u ap vëllezërve të mi bashkëfetarë librat më të nevojshme për të praktikuar faljen e tyre më gjuhën kombëtare, dhe zotimin t’im do t’a mbaroj ndofta brënda në pak kohë, në qoftë se Shqipëtarët janë gati të më ndihnin, sikundër më ndihne më të shtypurit e këtyre dy librave. Më të kthyer të kësaj libre u përpoqa të mos largohem nga teksti gërqisht dhe besoj që u dhashë Shqipëtarëve një kthim exakt të lutjeve të kishës Orthodokse...”. Kthenjësi. *Librë e Shërbesave të shënjtja të Kishës Orthodokse*, kthyer nga gërqishtja prej priftit Orthodok Fan S. Noli, Boston Mass 1909; Mehmet Gëzhilli, *Fan S. Noli*, Argeta LMG, Tiranë 2003, faqe 20.

¹⁴-Në vitin 1911 Imzot Theofani përktheu librin liturgjik "Të kremtet e mëdha të Kishës Orthodokse", 318 faqe, botuar nga Kisha Ortodokse shqiptare në Amerikë. Ky libër përmban himne dhe lexime të të kremteve kryesore.

¹⁵-Në vitin 1913 Imzot Theofani përktheu librin liturgjik "Triodi i vogël", 270 faqe, botuar nga qeveria rumune në Bukuresht dhe përmban himne dhe lexime të Kreshmëve të dhe Pashkëve.

¹⁶-Në vitin 1914 Imzot Theofani përktheu librin liturgjik "Lutësorja", 96 faqe, botuar nga Kisha Ortodokse shqiptare në Amerikë. Ky libër përmban himnet e së Dielës në tetë zëra, Kanunin e Vogël dhe Kanunin e Madh të Shën Mërisë. Në përkushtimin e librit lexojmë: "Motrës s'ime të dashur Shirma Noli, me lutje që të gjejë në qiell lumturinë që i mohoi kjo botë. Këtë vepër i detikoj".

¹⁷-Në vitin 1914 Imzot Theofani përktheu librin liturgjik "Pesëdhjetore e vogël", 94 faqe, botuar nga Kisha Ortodokse shqiptare në Amerikë. Ky libër përmban himnet dhe leximet e të Dielave nga Pashkët deri te Rushajet dhe të Dielën e gjithë Shenjtorëve. Në përkushtimin e librit lexojmë: "Tim eti që më rriti e më mësoj, dhe që vdiq i lënduar se më pa prift, i detikoj këtë libër duke i lypur ndjesë". Fan Noli, *Pesëdhjetore e Vogël*, Boston, Mass 1914, faqe 3.

¹⁸-Fanolistët propozuan emrin e atë Vangjel Çamçes për kryetar të Këshillit të Lartë Kishtar. Arkimandrit Visar Xhuvani ishte një kandidat i tjetër e mundshme. Megjithatë qeveria dhe fanolistët u pajtuan me kandidaturën e atë Vasil Markut. Ky i fundit ishte prift i martuar dhe nuk mund të pretendonte për gradën episkopale. Kjo ishte edhe arsyeja që Visar Xhuvani pranoi që atë Vasil Marku të zgjidhej kryetar i Këshillit të Lartë Kishtar. Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 121.

zëvendësmropolit i Durrësit, Arkimandrit Visar Xhuvani, zëvendësmropolit i Korçës, Atë Josif Qirici, zëvendësmropolit i Beratit Atë Anastasi dhe zëvendësmropolit i Gjirokastrës Atë Pano Çuçi. Anëtarët laikë qenë: Z. Simon Shuteriqi për mitropolinë e Durrësit, Z. Dhosi Havari për mitropolinë e Korçës, Z. Tol Arapi për mitropolinë e Beratit dhe Z. Stathi Kondi për mitropolinë e Gjirokastrës¹⁹. (Fig.2)

Në Kongresin e Beratit u diskutua edhe për Rregulloren²⁰ e Kishës Shqiptare, ku u bënë propozime të ndryshme, që kishin të bënin me të ardhurat e kishave dhe të manastireve, duke zgjedhur një komision për kontrollin e tyre. Në nenin I, Rregullorja përcaktonte se Kisha Ortodokse Autoqefale Kombëtare e Shqipërisë përbëhej nga katë episkopatat: të Korçës, të Durrësit, të Beratit dhe të Gjirokastrës. Episkopatat do të vepronin sipas rregulloreve të Patriarkanës Ekumenike; zëvendësitë lokale do të drejtoheshin zëvendësmropolitit dhe ky i fundit Këshillit të Lartë Kishtar. Në nenin 3 të Rregullores përcaktoheshin detyrat e kryetarit të Këshillit të Lartë Kishtar. Mbledhjet e Këshillit do të drejtoheshin nga kryetari ose në rast mungese të tij, nga ai që e pasonte në shkallë kryepriëtorë. Mbledhjet që të quheshin të ligjshme duhet të kishin më shumë se gjysmën e anëtarëve. Vendimet e mbledhjeve duhet të miratoheshin me shumicë votash dhe në rast barazie fitonte ana e kryetarit. Një anëtar i Këshillit nëse mungonte pa arsye në dy mbledhje shpalljei i rrëzuar dhe vendin e tij e zinte një tjetër. Në kompetencë të këshillit që zgjedhja e arkëtarit, ndërsa me emërimet e personelit merrej kryetari. Arkëtari nuk duhej të bënte pagesa pa nënshkrimin e kryetarit, ndërsa kryetari nuk duhej të urdhëronte pagesa pa vendimin e këshillit. Neni 9 dhe i fundit përcaktonte pagesat e anëtarëve të këshillit dhe të personelit kishtar.

Kongresi u mor me çështjen se ku do të vendosej selia e Këshillit të Lartë Kishtar. Delegati i Kavajës, Pal Xhumari propozoi që si qendër e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë të ishte qyteti i Korçës²¹. Ky propozim u aprovua njëzëri nga kongresi. Në përfundim atë Josif Qirici nënshkroi telegramin, me anë të së cilit njoftoheshin kishat autoqefale se Kongresi i Beratit shpalli Kishën Autoqefale Ortodokse Kombëtare të Shqipërisë. Në fletoren zyrtare të Shtetit Shqiptar të vitit 1922 shpallja e Kongresit u quajt ditë historike.

Megjithatë, zbatimi i vendimeve të Kongresit të Beratit nuk eci me atë shpejtësi që kërkonte koha. Përplasjet e brendshme filluan të përçanin anëtarët e Këshillit të Lartë Kishtar. Përfaqësuesi laik i Mitropolisë së Durrësit në Këshillin e Lartë Kishtar, Simon Shuteriqi me anën e një telegrami i kërkoi pleqësive kishtarë të

¹⁹-Visarion Xhuvani, *Kujtim veprë dhe intrige*, shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926, faqe 11; Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 124; Andrea Llukani, *Kanonet dhe statutet e Kishës Ortodokse*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 184.

²⁰-Visarion Xhuvani, *Kujtim veprë dhe intrige*, shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926, faqe 10-11; Visarion Xhuvani, *në Kishë, në Parlament dhe në burg*, Vepra, botimet 55, Tiranë 2007, faqe 59-60; Nos Xhuvani, Pavli Haxhillazi, *Na flet Visarion Xhuvani*, Tekno Paper, Tiranë 2008, faqe 61-62; Andrea Llukani, *Kanonet dhe statutet e Kishës Ortodokse*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 188-189.

²¹-Dhori Qiriazhi, *Krishterimi në Shqipëri*, Argeta LMG, Tiranë 2000, faqe 162.

zgjidhnin një zëvendësmropolit tjetër në vendin e Visar Xhuvanit²². Pleqësitë zgjodhën atë Dhimitër Dhimitrukën²³. Në muajin nëntor 1922 Xhuvani shkoi në Korçë për të marrë pjesë në mbledhjen e Këshillit të Lartë Kishtar, por atë Vasil Marku nuk e pranoi me pretendimin se qe i shkarkuar. Visar Xhuvani e kundërshtoi, duke ia bërë të qartë se asnjë anëtar i këshillit nuk do të zgjidhej nëse pyeteshin pleqësitë kishtarë. Zgjedhja e tij ishte bërë nga delegatët e Kongresit të Beratit. Nuk vonoi shumë dhe kryepërgj. e fshatrave të Shpatit kërkuan riemërimin e arkimandrit Visar Xhuvanit si zëvendësmropolit i Durrësit²⁴. Edhe pleqësia kishtarë e lagjes Shën Koll të Elbasanit e mbështeti fuqishën Visarin. Gjithashtu edhe 100 besimtarë nga Lagja Kala e Elbasanit, e mbështetën Xhuvanin. Ndër ta kishte emra të njohur si: Aleksandër Xhuvani, Dhimitër Taja, Jeftimi Buda, Jan Nosi etj²⁵. Në këtë situatë Këshilli i Lartë Kishtar vendosi të mos pranonte asnjë anëtar klerik nga Mitropolia e Durrësit derisa të zgjidhej mosmarrëveshja. Kështu prej 26 dhjetorit 1922 deri më 1 janar 1924 Mitropolia e Durrësit mbeti pa zëvendësmropolit.

Në Mitropolinë e Drinopojës, Këshilli i Lartë Kishtar pati emëruar atë Pano Gjirokastrën si zëvendësmropolit. Zgjedhja e tij solli grindje pas një takimi që pati me Komisionin Hetimor të Lidhjes së Kombeve. Atë Pano Gjirokastra qe shprehur se meshimi në gjuhën shqipe²⁶ do të ishte i detyruar për të krishterët shqipfolës. Inspektori i administratës, Vasil Dilo në emër të ortodoksëve të qytetit kërkoi zëvendësimin e tij. Prania e atë Pano Gjirokastrës sillte përçarje me grekomanët e

²²-Në telegram është shkruar: Dhimogjerondisë, Zgjidhni antarin klerik, Zv Mitr. të Përgj. të Dioqezës së Durrësit tjetër në vend të Arqimandrit Vissar Xhuvanit. Simon Shuteriqi. Visarion Xhuvani, *Kujtim veprë dhe intrige*, shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926, faqe 12; *Visarion Xhuvani, në Kishë, në Parlament dhe në burg*, Vepra, botimet 55, Tiranë 2007, faqe 62; Nos Xhuvani, Pavli Haxhillazi, *Na flet Visarion Xhuvani*, Tekno Paper, Tiranë 2008, faqe 64.

²³-Në telegram është shkruar: Kryesisë së Kishës. Korçë. Në vend të Arqimandrit Vissar Xhuvanit kemi zgjedhur Papa Dhimitrukën anëtar Klerik të Këshillit të Lartë Kishtar si dhe për Zv. Mitrop. të Përgj. të Dioqezës së Durrësit. Dhimogjerondia. Visarion Xhuvani, *Kujtim veprë dhe intrige*, shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926, faqe 12; *Visarion Xhuvani, në Kishë, në Parlament dhe në burg*, Vepra, botimet 55, Tiranë 2007, faqe 62; Nos Xhuvani, Pavli Haxhillazi, *Na flet Visarion Xhuvani*, Tekno Paper, Tiranë 2008, faqe 64.

²⁴-Pamë në gazetën "Post" e Korçës" që shkruente se Elbasani ka protestuemun zgjedhjen e Arkimandrit Xhuvanit si zavendës i Përgjithshëm të Mitropolitit të Durrësit. Kjo nuk asht e drejtë se Dhimogjerondia e lagjes Kala nuk përfaqëson edhe lagjen e Shinkollit e Krahinën e Shpatit, të cilat pas vendimit të Kongresit Kishtar të Beratit në një 4 të statutit pranojnë si zavendës të përgjithshëm të Mitropolisë së Durrësit Arqimandrit Xhuvanin. Vijnë firmat e kryepërgj.

²⁵-Pamë në gazetën "Post" e Korçës" se populli Orthodhoks i Elbasanit ka protestuemun zgjedhjen e Hirsisë së Tij Vissar Xhuvanit për zavendës të përgjithshëm të Mitropolitit të Durrësit që e zgjodhi Kongresi Kishtar i Beratit. Ky protestim nuk asht i vërtetë dhe ne të nënshkruemit populli Orthodhoks i lagjes Kala t'Elbasanit qëndrojmë në vendimin e Kongresit të Beratit dhe njofim për zavendës të përgjithshëm Mitropolitit të Mitropolisë sonë të Durrësit Hirsinë e Tij Arkimandrit Vissar Xhuvanin dhe as ndonji pleqësi (Dhimogjerondi) etj, nuk njofim kompetent për me veprue kundra këtij emnimit të Arkimandritit të përmendun dhe këtë kemi vendosë edhe më 1919; dhe vazhdimi në detyrën e sipërme të Arkimandritit V. Xhuvani asht dëshira jonë. Vijnë firmat.

²⁶-Alqi Jani, *Papapano Gjirokastra-figurë e shquar e kishës shqiptare, në 70-vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Akademia e shkencave, Tiranë 1993, faqe 88-92.

fshatrave përreth Gjirokastrës, prandaj vetëm pak kohë pas emërimit atë e shkarkuan. Në vendin e tij u zgjodh atë Thanas Nikolla²⁷.

Patriarkana Ekumenike e informuar për zhvillimet që po ndodhnin në Shqipëri, më 11 shtator 1922 vendosi krijimin e një komisioni që do të shqyrtonte çështjen shqiptare. Në përbërje të komisionit qenë katër ish-mitropolitët e dioqezave shqiptare, ndërsa kryetar u zgjodh Mitropolit i Rodhit. Një nga anëtarët e komisionit, Joakim Martiniani²⁸ vuri në dijeni anëtarin e Këshillit të Lartë të Shtetit, Sotir Pecin. Ish-mitropolit i Beratit, Joakimi rendi në zyrën e Konsullatës Shqiptare, në Stamboll dhe njoftoi konsullin Nezir Leskovikun se komisioni kërkonte dërgimin e një përfaqësie nga ortodoksët e Shqipërisë. Gjithashtu, e bëri me dije se Patriarkana Ekuemnike kishte vendosur të dërgonte Mitropolitin e Meletit, Jerotheun²⁹ si eksark patriarkal në Shqipëri. Jerotheu mbërriti në Korçë më 30 nëntor 1922, ku u takua me anëtarët e Këshillit të Lartë Kishtar dhe deputetët ortodoksë që kishin dalë për ta pritur. Më 2 dhjetor 1922 Jerotheu meshoi në kishën e Shën Gjergjit në Korçë. Në fjalën e tij tha se ishte i dërguar nga patriku Meleti IV për çështjen e autoqefalësë së kishës shqiptare. Jerotheu i dërgoi Patriarkanës Ekumenike raportin përkatës dhe i

²⁷-Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 123-124.

²⁸-Joakim Martiniani ka lindur në Voskopojë, më 1875. Studimet e larta i ndoqi në shkollën teologjike të Halkit. Në vitin 1903 u dorëzua dhjak në kishën patriarkale të Shën Gjergjit, nga Patriku Ekumenik Joakimi III. Më 4 korrik të vitit 1911 Joakim Martiniani u zgjodh mitropolit i Beratit, ndërsa ceremonia e fronëzimit u celebrua më 10 korrik 1911. Sapo mbërriti në Berat, mitropolit i Joakim ngriti një shkollë hierartike në manastirin e Ardenicës. Në Vlorë ngriti shtypshkronjën, ku botonte një gazetë të përjavshme. Mitropolit i Joakim inventarizoi pasuritë e paluajtshme të manastireve. Me interesimin e tij u restaurua manastiri i Zvërnecit. Gjithashtu ndërtoi një bibliotekë të pasur në mitropolinë e Beratit, e cila u dogj më 14 shtator të vitit 1913. Në vitin 1920 vajti në Korfuz dhe nuk e jëluan të kthehej në mitropolinë e tij. Dr. Dion Tushi, *Joakim Martiniani*, Kërkim, Nr. 6, Tiranë 2010, faqe 59-62.

²⁹-Jerotheu (+1956) ka lindur në fshatin Çarshovë të Përmetit. I ati quhej Andon Jaho dhe e ëma Kostandina. Janaqi vitet e fëmijërisë i kaloi në vendlindje. Në moshën e rinisë vajti tek i ati në Stamboll për të ndjekur studimet e larta në Shkollën Teologjike të Halkit, të cilat i përfundoi në vitin 1907. Tema me të cilën mbrojti diplomën ishte: "Hirotonia dhe zgjedhja kanonike e Fotit". Pas përfundimit të studimeve përqafon jetën monakale dhe ushtrohet në Skitin e Shën Anës duke marrë emrin Jerothe. Vite më vonë e gjejmë Kryefamulltar në Kalqedoni të Stambollit. Duke ngjitur njëra pas tjetrës shkallët e hierarkisë kishtarë arriti që më 12 janar të vitit 1914 të hirotoniset Episkop i Melitopojës. Pas Kongresit të Beratit, Patriarkana Ekumenike vendosi të dërgonte Mitropolitin e Melitopojës, Jerotheun si eksark patriarkal, i cili mbërriti në Korçë më 27 nëntor 1922. Hirësia e Tij Jerotheu i dërgoi Patriarkanës Ekumenike raportin përkatës më 8 dhjetor 1922 duke i kërkuar që të dërgonte në Shqipëri Mitropolitin e Sinadonit Kristofor Kisin. Me ardhjen e këtij të fundit, më 4 dhjetor 1923 Jerotheu dhe Kristofori dorëzuan në gradën episkopale Theofan Nolin në Kishën e Shën Gjergjit në Korçë. Imzot Jerotheu u zgjodh Mitropolit i Beratit. Me interesimin e Imzot Jerotheut u botua Revista "Zëri i Orthodhoksisë". Kjo revistë u botua në qytetin e Korçës ndërmjet viteve 1924-1925. Kjo ishte edhe revista e parë e Kishës Orthodhokse. Dhimitër Beduli, *Teologë me origjinë shqiptare që janë diplomuar në Institutin Teologjik të Halkit*, Ngjallja, tetor 1996, faqe 10; Ilia Spiro Vasili, *Si e gjeta Episkopin Jerotheos*, Ngjallja, gusht 1996, faqe 9; Ilia Spiro Vasili, *Jeta dhe veprimtaria e dhespotit Jerotheos*, Ngjallja, maj 2003, faqe 9,10; Kristofor Beduli, *Revista Zëri i Orthodhoksisë*, Ngjallja, qershor 2002, faqe 4; Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 133-134.

kërkoi dërgimin e një delegacioni nga kisha shqiptare për t'u sqaruar³⁰. Delegacioni u nis në maj të vitit 1923 dhe kryesohej nga Kryetari i Këshillit të Lartë atë Vasil Marku, i cili i paraqiti Patriarkanës Ekumenike vendimet e Kongresit të Beratit, si dhe u parashtroi dëshirën e shtetit shqiptar për krijimin e një kishe autoqefale, sikundër që vepruar në Greqi, Serbi dhe Rumani. Në këtë pikë Patriku Ekumenik, Meleti IV kundërshtoi njësimin me shtetet e tjera, pasi Shqipëria nuk kishte shumicë të popullsisë ortodokse. Delegacioni u kthye në Shqipëri pa rënë dakort me autonominë e pjesshme që parashikonte Patriarkana, gjë që ishte në kundërshtim me vendimet e Kongresit të Beratit.

Për të fuqizuar kishën ortodokse me kandidatë për episkopë, Jerotheu më 15 dhjetor 1922 ngriti atë Vangjel Çamçen në rangun e arkimandritit. Ndërkohë, Patriku Meleti IV thirri Jerotheun në Stamboll, duke e njoftuar se misioni i tij në Shqipëri kishte mbaruar. Jerotheu u dëshpërua pa masë. Disa muaj pas kthimit të delegacionit në Shqipëri, më 17 gusht të vitit 1923 Mitropoliti i Sinadës, Kristofor Kisi (Fig.3) erdhi vullnetarisht për t'i shërbyer çështjes së kishës shqiptare. Patriarkana urdhëroi ndalimin e çdo lloj veprimtarie kishtarë të Kisit. Mirëpo as Jerotheu dhe as Kisi nuk iu bindën urdhërit të Patriarkanës³¹.

Në tetor 1923 Këshilli i Lartë Kishtar kishte emëruar Jerotheun, Mitropolit të Korçës dhe Kristofor Kisin, Mitropolit të Beratit. Në muajin nëntor 1923 u bë fronëzimi i tyre. Më 4 dhjetor 1923 Jerotheu dhe Kristofori dorëzuan në gradën episkopale Theofan Nolin (Fig.4) në kishën e Shën Gjergjit në Korçë. Shërbesa u zhvillua me pjesëmarrjen e Ministrit të Jashtëm, Pandeli Evangjeli, kryebashkiakut Vasil Avrami, si dhe të mjaft personaliteteve të tjerë. Pas dorëzimit në gradën episkopale, Theofan Noli do të fronëzohej në fillim të janarit 1924. Vetëm Mitropolia e Gjirokastrës mbetej pa episkop.

Këshilli i Lartë Kishtar në vitet 1923-1925 përbëhej nga: Atë Vasil Marku, Kryetar; Anëtarët klerikë: Mitropoliti i Durrësit, Hirësi Theofan Noli; Mitropoliti i Korçës, Hirësi Jerothe Jaho; Mitropoliti i Beratit, Hirësi Kristofor Kisi; Zëvendësmitropoliti i Gjirokastrës, Atë Thanas Nikolla. Anëtarët laikë: për Durrësin,

³⁰-Në letrën që i dërgoi Kryetarit të Këshillit të Lartë, eksarku patriarkal Jerotheu ka shkruar: Fort i përndershëm! Duke bekuar vendimet dhe statutin e Kongresit Kishtar që u mblodh në Berat në shtator të vitit 1922, sipas qarkores së imët që bëri kleri dhe populli ortodoks i Shqipërisë, si Eksark Patriarkal që jam i them dhe e shtyj Atërisht Këshillin Kishtar të Përzier, që ndodhet në veprim dhe punon si e do puna me goditje, i them pra këtij Këshilli të shkojë me çapa të fortë e të sinqertë udhës që ka hapur Kongresi i Beratit me anën e Statutit, i cili u vërtetua plotësisht nga Qeveria e Ndershme Shqiptare. Urime të dala nga thellësia e zemrës së Patrikut Ekumenik për forcimin dhe përparimin e Qeverisë Shqiptare dhe të Kishës Ortodokse të Shqipërisë u shfaqën dhe po shfaqen me anën time zyrtarisht si Eksark Patriarkal që jam dhe kam besim të patronditur se në kohën që e do puna Kisha e Madhe e Krishtit ka për ta njohur edhe Kishën Ortodokse të Shqipërisë, e cila sapo u lind duke e siguruar këtë plotësisht sipas zakonit me anë të Tomit Kishtar sikundër urdhërojnë Kanonet e Shenjta. Korçë 19.12.1922. Urimtar i flaktë me Krishtin ndaj Perëndisë. Eksarku Patriarkal Jerotheu, i Melitopojës. Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi 141, Dosja nr. 438, viti 1922.

³¹-Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 131-138.

Simon Shuteriqi; për Korçën Dhosi Havjari; për Beratin, Tol Arapi dhe për Gjirokastrën, Stathi Kondi³².

Menjëherë pas dorëzimit, Imzot Theofani mori në dorë drejtimin e lëvizjes kishtare shqiptare. Tashmë tre mitropolitët e kishës shqiptare i dërguan Patriarkanës Ekumenike vendimin për krijimin e sinodit me pjesëmarrjen e Theofan Nolit, Mitropolit të Durrësit; Hirësi Kristoforit, Mitropolit i Beratit dhe Hirësi Jerotheut, Mitropolit i Korçës. Qenë plotësuar kushtet për dorëzimin e mitropolitit të katër, që ishte Arkimandrit Vangjel Çamçe, i cili do të dorëzohej Mitropolit i Gjirokastrës, duke formuar Sinodin e Shenjtë me pjesëmarrjen e katër mitropolitëve: Theofanit, Jerotheut, Kristoforit dhe Vangjelit. Ndërkohë me trazirat e vitit 1924, Imzot Theofani u detyrua të largohej nga Shqipëria³³, vetëm pak ditë përpara se të fronëzohej Kryepiskop. Kjo ishte brena më e madhe e Nolit.

DORËZIMI I VISARIONIT NË GRADËN EPISKOPALE

Më 24 mars 1925 Ministria e Brendshme i kërkoi Këshillit të Lartë Kishtar, që në vendin e Theofan Nolit të emërohej arkimandrit Visar Xhuvani. Besimtarët e Elbasanit³⁴, Pogradecit³⁵ dhe të Tiranës³⁶, kërkonin emërimin e Visarit. Këshilli i Lartë

³²-Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 139.

³³-Fan S. Noli, *Vepra II*, Zgjedhur dhe përgatitur nga prof. Nasho Jorgaqi, Dudaj, Tiranë 2003, faqe 350; Dhimitër Beduli, *Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë deri në vitin 1944*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë, 1992, faqe 25; Dhimitër Beduli, *Kishë dhe kulturë*, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2006, faqe 49; Dhori Qiriazhi, *Krishterimi në Shqipëri*, Argeta LMG, Tiranë 2000, faqe 164.

³⁴-Sot më 8 Mars 1925 u mbledh Dhimogjerondija nën Kryesinë e Zavendës Mitropolitit Ikonom At Dhimitrukës, dhe pasi bisedoi gjatë e gjanë, vendosi me zana të përbashkëta, sa vijon: Tue marrë parasysh dëshirën e nevojat fetare të popullit të qytetit e të rrethit t'Elbasanit, të çfaqun edhe dy herë ma parë me vendime të posaçme, bamun në muejt Shtatuer e Nanduer të vitit 1919, si dhe propozimin e bamun në Kongresin Orthodhoks të Beratit, ashtu edhe cilsinat e duhuna të Hirsisë së Tij Arkimandrit Dr. Vissar Xhuvanit, të kërkohet prej Këshillit të Naltë Kishtar dorzimi i Tij sa ma shpejt si Episkop për Episkopatën Tonë. Për me i mbërrri këtij qëllimi, t'i njoftohet ky vendim Dhimogjerondinave të qyteteve tjera t'Episkopatës me lutje që ta përkrahin këtë inisiativë, tue i u drejtue edhe ato Këshillit të Naltë Kishtar në Korçë. Visarion Xhuvani, *Kujtim vepre dhe intrige*, shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926, faqe 21.

³⁵-Tue marrë parasysh dëshirën e nevojat fetare të popullit të qytetit tonë dhe të rrethit të Pogradecit dhe tue marrë parasysh cilësinat e duhuna të Hirsisë së Tij Arqimandrit Dr. Vissar Xhuvanit, të kërkohet prej Këshillit të Naltë Kishtar dorzimi i Tij sa ma shpejt si Episkop i Episkopatës sonë. Për me i a mbërrri këti qëllimi t'i njoftohet ky vendim Dhimogjerondinave të qyteteve të tjera t' Episkopatës me lutje që ta përkrahin këtë inisiativë, tue i-u drejtue së bashku Këshillit të Naltë Kishtar në Korçë. Pogradec 14-III-925. Visarion Xhuvani, *Kujtim vepre dhe intrige*, shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926, faqe 21-22.

³⁶-Sot më 19-III-925 të nënshkruemit me dëshirë vllaznore si pas vendimit t'Elbasanit D. 8-III-925 dhe Pogradecit d. 14-III-925 vendosën sa vijon: Tue marrë parasysh nevojat fetare të qytetit tonë Tiranës dhe tue marrë parasysh cilsinat e duhuna të Hirësisë së Tij Arqimandrit Dr. Vissar Xhuvanit, të kërkohet prej Këshillit të Naltë Kishtar dorzimi i Tij sa ma shpejt si Episkop t'Episkopatës sonë. Për

Kishtar duke marrë parasysh kërkesën e tyre më 28 mars 1925 e emëroi arkimandrit Visar Xhuvanin zëvendësmropolit të Durrësit, Gorës dhe Shpatit. Me emërimin e Visar Xhuvanit, Këshilli i Lartë Kishtar në vitet 1925-1925 përbëhej: Kryetar: Atë Vasil Marku; Anëtarë Klerikë: Zëvendësmropolit i Durrësit, arkimandrit Visar Xhuvani; atë Vangjel Çamçe, Mitropolit i Korçës, Hirësi Jerotheu; Mitropolit i Beratit, Hirësi Kristofori; Zëvendësmropolit i Gjirokastrës, atë Thanas Nikolla. Anëtarë laikë: Simon Shuteriqi për Durrësin; Vasil Rusi; Dhosi Havjari për Korçën; Tol Arapi për Beratin dhe Stathi Kondi për Gjirokastrën³⁷.

Në prill 1925 Visar Xhuvani iu drejtua dy episkopëve Jerotheut dhe Kisit, nëse ata qenë të gatshëm ta dorëzonin në gradën episkopale. Përgjigja e Jerotheut ishte se nuk mund të dorëzonte asnjë episkop pa lejen e Patriarkanës Ekumenike, ndërsa Kristofori pranoi me kushtin që të gjendej një episkop kanonik, për kryerjen e dorëzimit. Në këto kushte Visar Xhuvani më 3 maj 1925, duke marrë bekimin e patrikut të Serbisë, Dhimitrit u dorëzua në gradën episkopale në Manastirin e Savinës në Kotorr prej dy episkopëve rusë; Ermogenit të Ekaterinosllavit dhe Mihailit të Aleksandrovskit.

Dorëzimi i Visarionit në gradën episkopale solli pështjellime në kishë, sepse nuk ishte emëruar nga Këshilli i Lartë Kishtar, kryetari i të cilit Atë Vasil Marku nuk e njohu dorëzimin. Madje, ai njoftoi ministrin e Drejtësisë, Petro Poga, se dorëzimi ishte i paligjshëm. Atë Vasil Marku kërkoi ndalimin e Xhuvanit nga shërbesat fetare. Më 16 maj 1925 erdhi përgjigja nga ministri Poga, i cili theksonte se Xhuvani nuk duhej të lejohej të meshonte si episkop. Në këto kushte Këshilli i Lartë Kishtar emëroi anëtari laik të Këshillit të Lartë Kishtar Vasil Rusi si zëvendësmropolit të Durrësit. Më 19 qershor 1925 Pleqësia Kishtare e Elbasanit³⁸ kërkoi emërimin e Visarionit, Mitropolit të Durrësit.

PROTOKOLLI I TIRANËS

Në vitin 1926 Patriarkana Ekumenike, me ndërmjetësinë e qeverisë greke dërgoi në Shqipëri Mitropolitin e Trapezuntës Krisanthin si eksark patriarkal, që të bisedonte për çështjen e autoqefalisë. Patriku Ekumenik Vasili, më 13 prill 1926 i shkroi një letër

me ai mri këti qëllimi ti njoftohet ky vendim qyteteve të tjera të Episkopatës me lutje që ta përkrahin këtë iniciativë, tue iu drejtue edhe këshillit të Naltë Kishtar në Korçë për këtë punë. Parësia dhe populli i Tiranës. Visarion Xhuvani, *Kujtim vepre dhe intrige*, shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926, faqe 19-20.

³⁷-Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 157.

³⁸-Sot më 19 Qershor 1925, u mblodh Dhimgogjerondija e Elbasanit dhe mbasi bisedoi mbi bazë të vendimevet të saj, dhanun ma parë, si dhe tue marrun para sysh dëshirën e gjithë popullit të qytetit e të qarkut bashkë me atë të krahinës së Shpatit, vendosi me zana të përbashkëta, që të kërkojë nga kryesia e Kishës, njohjen e Hirsisë së Tij Episkop Vissarion Xhuvanit si Episkop dhe emnimin e Tij për Mitropolit t'Episkopatës sonë. Dhe për këtë qëllim vendosi që n'emnin e kësaj Dhimgogjerondije, t'i drejtohet Kryesisë së Kishës kjo lutje telegrafike: "Të shtyemun nga dëshira e gjithë popullit Orthodhoks të qytetit e të qarkut së bashku me krahinën e Shpatit, i paraqisim rishtazi Qendrës sonë Shpirtnore lutjen për me pranue në gji të Kishës së Shenjtë Episkopin Vissarion Xhuvani, tue e emnue Mitropolit t'Episkopatës së Durrsit". Elbasan më 19 Qershuer 1925. Visarion Xhuvani, *Kujtim vepre dhe intrige*, shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926, faqe 31.

Ahmet Zogut, ku theksonte përkujdesjen atërore patriarkale ndaj ortodoksëve shqiptarë. Krisanthi mbërriti në Tiranë në fillim maji të vitit 1926. Këshilli i Ministrave ngriti një komision të posaçëm për të biseduar me Krisanthin. Në përbërje të komisionit qenë: Kreu i Senatit, Pandeli Evangjeli, Kryetari i Dhomës së Deputetëve, Koço Kota, senatorët Pilo Papa, Andon Beça, deputetët Mihal Kaso, Vasil Rusi, Dr. Simonidhi dhe Vasil Bamiha. Bisedimet nisën më 24 maj 1926 dhe zgjatën 40 ditë. Më 6 qershor 1926, komisioni i deputetëve dhe senatorëve dhe Mitropoliti i Trapezuntës, Krisanthi nënshkruan marrëveshjen përfundimtare, që u quajt Protokolli i Tiranës³⁹. Marrëveshja përcaktonte krijimin e Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare. Protokolli i Tiranës kishte tetë nene si edhe një shtojcë. Neni i parë përcaktonte se Kisha Ortodokse Shqiptare do të përbëhej nga pesë mitropoli, të cilat qenë: e Tiranës, e Korçës, e Gjirokastrës, e Beratit dhe e Durrësit. Neni i dytë theksonte se: Mitropoliti i Tiranës, do të ishte Kryepiskopi i Kishës Ortodokse Shqiptare dhe njëkohësisht Kryetar i Sinodit të Shenjtë. Neni tre përcaktonte se në mitropolitë e paplotësuar me mitropolitë komisioni i posaçëm ortodoks do të propozonte tre emra, të cilët do të emëroheshin nga Patriku Ekumenik. Neni i katërt theksonte për bashkësitë ortodokse se do të përdorej gjuha amtare, që ishte shqipja. Protokolli i Tiranës theksonte gjithashtu, se të drejtat e pakicës etnike greke do të përmbusheshin nga Shpallja për Mbrojtjen e Pakicave, që qe dorëzuar në Lidhjen e Kombeve. Neni i shtatë përcaktonte se Shqipëria do të dëmshpërblente Patriarkanën Ekumenike për manastiret stavropigjike⁴⁰, të cilat kalonin në varësinë e Kishës Ortodokse Shqiptare. Neni i tetë theksonte se Patriarkana Ekumenike do të bekonte autoqefalinë e kishës, duke dorëzuar Tomosin përkatës. Shtojca e Protokollit të Tiranës bënte fjalë për tre emrat e propozuar në tre mitropolitë vakante për të formuar Sinodin e Shenjtë⁴¹. Krisanthi ia kishte bërë të ditur qeverisë shqiptare se Tomosi do të dorëzohej në Lidhjen e Kombeve. Gjithashtu si parakusht qe shfuqizimi i Statutit të miratuar në Kongresin e Beratit dhe i Këshillit të Lartë Kishtar. Heqja nga detyra e Mitropolitit të Durrësit, Theofan Nolit etj. Krisanthi ishte takuar edhe me Visarion Xhuvanin në Tiranë. Në bisedë me të Visarioni kishte pranuar se kishte shkelur kanonet, por jo deri në atë shkallë sa vetëshpallja e Nolit. Mitropoliti i Trapezuntës, Krisanthi u largua nga Shqipëria më 17 qershor 1926. Gjatë kohës së bisedimeve Visarion Xhuvani botoi dy vëllimet e librit "*Çashtje politiko-religjioze Kostandinopoli-Tiranë*". Në vëllimin e parë⁴² argumentonte përse Kisha në Shqipëri

³⁹-Fatmira Rama, *Sinodi i parë shqiptar dhe Kongresi i dytë panortodoks i Kishës Ortodokse Autoqefale Kombëtare, 70-vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1993, faqe 62.

⁴⁰-Manastiret që administroheshin direkt nga Patriku i Kostandinopojës dhe gëzonin statusin e manastirit stavropigjik në Shqipëri qenë: manastiri i Cepos, manastiri i Kamenës, manastiri i Spilesë në Saraqinisht, manastiri i Prodhromit në Voskopojë dhe manastiri i Drianos në Zervat të Dropullit. Andrea Llukani, *Ndihmesa e Theofan Popës për shpëtimin e mbishkrimeve dhe objekteve liturgjike kishtarë*, (Monografi), Trifon Xhagjika, Tiranë 2019.

⁴¹-Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 170-171.

⁴²-Visarion Xhuvani, *Çashtje politiko-religjioze Kostandinopoli-Tiranë*, Pjesa I, shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926.

duhej të ishte kombëtare, ndërsa në vëllimin e dytë⁴³ sqaronte përse Kisha Shqiptare duhet të ishte autoqefale. Visarion Xhuvani⁴⁴ në atë kohë ka shkruar për gjendjen e mjeruar të Kishës Ortodokse Shqiptare. Më 19 maj 1927 Sinodi i Shenjtë i Patriarkanës Ekumenike kishte vendosur për dhënien e Autoqefalisë së Kishës Shqiptare, sipas protokollit të Tiranës. Patriku Ekumenik, Vasili sqaronte se ishte e rëndësishme të ruhej fryma e nenit të pestë të Protokollit, që siguronte pavarësinë e plotë të Kishës Ortodokse Shqiptare. Pranimi i marrëveshjes do të shoqërohej me dorëzimin e pesë mitropolitëve. Pas kësaj një përfaqësi do të dërgohej në Stamboll për të marrë pjesë në ceremoninë e dorëzimit të Tomosit. Ndërkohë që komisioni i posaçëm ortodoks falënderoi Patriarkanën Ekumenike për pranimin e Protokollit të Tiranës, i cili i jepte zgjidhje çështjes kishtare. Mitropoliti i Trapezuntës, Krisanthi i dërgoi një letër Patrikut Ekumenik, Vasilit, ku i thoshte që ta zvarriste çështjen. Në këto rrethana, qeveria shqiptare kishte vetëm dy zgjidhje. E para ishte të priste kërkesat e reja që do të paraqiste Krisanthi, të cilat do të shqyrtoheshin nga komisioni i posaçëm, do të miratoheshin nga Këshilli i Ministrave dhe më pas do ti përcilleshin Patriarkanës

⁴³-Visarion Xhuvani, *Çashtje politiko-religjioze Kostandinopoli-Tiranë*, Pjesa II, shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926.

⁴⁴-Xhuvani në broshurën *Kujtim vepre dhe intrige* duke përshkruar gjendjen e kishës ka shkruar: 1) Shumica e Priftnavet t'Episkopatës së Gjinokastrës në Shqipni meshtojnë në Kishë n'emën të ish Mitropolitit të Gjinokastrës Vasilit, që Kongresi Kishtar i Beratit e ka rrëzue zyrtarisht si antishqiptar. Këtë përmendin për kryefetar rrethi i katundevet të Prefekturës së Gjinokastrës edhe sot. 2) Në Episkopatën e Beratit-Vlonë, Episkopi Em. Kristofori përmend (kujton) në meshë rregullisht Patrikun e Kostandinopojës edhe çdo Episkop t'Orthodhoksëvet deri sot. 3) Në Episkopatën e Korçës-Përmet, Episkopi Emz. Ierotheu meshton gjithashtu si i sipërmi në emën të Patrikut të Kostandinopojës, dhe vetëm në emën të Tij. 4) Në Episkopatën e Durrsit-Tiranë-Elbasan kleri meshton në emën të çdo Episkopie Orthodhokse (që do me thanë në emën të një kishë indipendente po pa Episkop kryetar dhe pa Episkop të kësaj Episkopate, të Durrsit). 5) Në Shkodër kleri meshton në emën të Patriarhut të Serbisë. 6) Në qytetin Korçë mbrenda At Vasil Markoja, një Prift që asht Kryetar i Kishës Orthodhokse Kombëtare Autoqefale të Shqipnisë (d.m.th. ka gradën e Patrikut, përveç titullit), dhe ky, kur meshton atje përmend edhe Episkop Ierotheun, i cili si thamë meshton në emën të Patrikut të Kostandinopojës. 7) Imz. Ierotheu dhe Imz. Kristofori a) erdhën në Shqipni, b) morën Episkopata të cilave Episkopë ishin të tjerë sipas pikpamjes kanonike të Patriarhisë së Kostandinopojës, - dhe c) dorzuen Episkop Fan Nolin, pa lejen e patriarhisë, kishës, nga e cila kur erdhën këtu urdhënoheshin, dhe nën juridiksionin e së cilës ishin kur erdhën këtu, si edhe sot prej Patriarhisë së Kostandinopojës njifen për Episkopë të asaj kishë. Por ajo Patriarhi nuk bani asnjë veprim kundra tyne tash 5 vjet, sa do që Eksarhu, delegati Patriarhal Imz. Krisanthi, kto ditë në Shqipni tha se Patriarhia Imz. Ierothenë dhe Kristoforin i njef për Episkopë që vepruen në Shqipni kundra rregullavet dhe kanonevet Ierarhike disiplinore. 8) Statuti i Kishës dhe vendimet themeltare të Kongresit Kishtar të Beratit, si u spjegue në kët libër, u shkelën keq, sidomos nyji i 10-të që i përket gjuhës shqipe në Meshë. 9) Vendimi i Kongresit Kishtar të Beratit për zv. Mitropolit të Gjinokastrës dhe antar klerik në Këshillin e N.K. të asaj dioqeze u shkel prej Këshillit të Naltë Kishtar. 10) Vendimi i Kongresit K. të Beratit që na emnonte ne provizorisht Zv. Mitropolit të përgjithshëm të dioqezës së Durrsit dhe pasandaj për Mitropolit definitiv, si u spjegue në kët libërzë, u shkel. 11) Mbasi Imz. Ierotheu, Imz. Kristofori dhe Këshilli i Naltë Kishtar e lanë Kishën 4 vjet pa Sinodh Episkopal pse nuk donin të dorzonin një Episkop të katërt që të mos formohet kështu Sinodhi Episkopal Shqiptar. Visarion Xhuvani, *Kujtim vepre dhe intrige*, shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926, faqe 22-23.

Ekumenike për miratim. Ndërsa zgjidhja e dytë ishte krijimi i Sinodit të Shenjtë, duke e vënë Patriarkanën Ekumenike para një fakti të kryer⁴⁵.

KRIJIMI I SINODIT TË SHENJTË

Që të sanksionohej plotësisht autoqefalia e Kishës Ortodokse të Shqipërisë nevojitej të krijohej një sinod, i cili do të udhëhiqte kishën. Por, që të formohej Sinodi i Shenjtë nevojiteshin të paktën katër episkopë, ndërsa në Shqipëri në atë kohë kishte mbetur vetëm një episkop, që ishte Visarioni. Atë Vasil Marku, në cilësinë e Kryetarit të Këshillit të Lartë Kishtar, e emëroi zyrtarisht Visarionin, Mitropolit të Durrësit dhe Tiranës. Gjithashtu e ngarkoi me detyrën që të shkonte në Beograd për të kërkuar ndihmë për zgjidhjen e çështjes së Sinodit të Shenjtë. Për të dorëzuar episkopët e tjerë nevojiteshin të ishin të paktën dy mitropolitë, prandaj Visarioni vajti në Shkodër, ku kërkoi ndihmën e mitropolitit serb, Imzot Viktorit. Kështu më 12, 13 dhe 17 shkurt të vitit 1929 në katedralen e Ungjillëzimit në Tiranë u bë dorëzimi i episkopëve nga Imzot Visarini dhe Imzot Viktori. Kryeministri Koço Kota, kur mësoi se Visarioni ja kishte dalë mbanë i telefonoi sekretarit të tij, Dr. Zoi Xoxa dhe i kërkoi që ta shoqëronte për të shkuar në kishë⁴⁶.

Në meshën e datës 12 shkurt 1929 në katedralen e Ungjillëzimit në Tiranë, Hirësi Visarioni me Hirësi Viktorin dorëzuan në gradën episkopale arkimandrit Vangjel Çamçen, i cili pas dorëzimit mori emrin Agathangjel. Në ceremoninë e dorëzimit merrnin pjesë Kryeministri Koço Kota, deputetë, përfaqësuesi i Mbretit, kolonel Sereqi etj. Visarion Xhuvani foli për vullnetin e Mbretit dhe qeverisë për zgjidhjen e çështjes së Sinodit të Shenjtë. Hirësi Agathangjeli në fjalën e tij, vlerësoi vullnetin e Mbretit dhe të Kryeministrit dhe u zotua që do të plotësonte detyrat e ngarkuara. Më 13 shkurt 1929 Imzot Vizarioni, Imzot Viktori dhe Imzot Agathangjeli dorëzuan në gradën episkopale atë Efthim Konomin, i cili mori emrin Eugjen⁴⁷. Më 17 shkurt 1929 në katedralen e Ungjillëzimit në Tiranë u dorëzua në gradën episkopale Thanas Ambrozi.

Të nesërmen më 18 shkurt 1929 Këshilli i Lartë Kishtar formoi Sinodin e Shenjtë⁴⁸ (Fig.5) të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, i cili përbëhej nga: 1-Visarion Xhuvani, Mitropolit i Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit. 2-Agathangjel Çamçe, Episkop i Beratit dhe Vlorës. 3-Thanas Ambrosi, Episkop i Gjirokastrës,

⁴⁵-Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 182-186.

⁴⁶-Zoi Xoxa, *Kujtimet e një gazetari*, 55, Tiranë 2007, faqe 126.

⁴⁷-Atë Efthim Konomi (Imzot Eugjeni) ka lindur në vitin 1870, në Hoshtevë të Zagorisë. Fillimisht ka punuar si mësues dhe më vonë ka studiuar teologji në Athinë. Pasi u dorëzua prift në Kavallë u kthye në atdhe dhe u emëruan në Mitropolinë e Korçës, ku është shquar për atdhetari. Alqi Jani, *Të njohim dhe nderojmë klerikët e Kishës Ortodokse të Shqipërisë: Episkopi Eugjen Hoshteva*, Republika, 27 maj 2009, faqe 14-15.

⁴⁸-Fatmira Rama, *Sinodi i parë shqiptar dhe Kongresi i dytë panortodoks i Kishës Ortodokse Autoqefale Kombëtare, 70-vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1993, faqe 65.

Delvinës dhe Himarës. Ndërsa Eugjeni u caktua Episkop ndihmës i Kryeepiskopit. 4-Ikonom i Madh Mitrofor Atë Vasil Marku. Mitropolia e Korçës kishte mbetur pa mitropolit, prandaj Pleqësia Kishtare vendosi që Hirësi Visarioni të ishte zëvendësisht Mitropolit i Korçës⁴⁹.

Në mbledhjen e parë të Sinodit, pas votimit të anëtarëve të zgjedhur Fortlumturia e tij, Visarioni u zgjodh kryetar i Sinodit të Shenjtë të Kishës së Shqipërisë. Hirësi Eugjeni u emërua ndihmës i Kryeepiskopit, si Episkop i Peshkopisë. Dr. Zoi Xoxa u emërua Sekretar i Sinodit. Rezidenca e Sinodit të Shenjtë u caktua në Korçë. Sinodi ngriti një komision për përkthimin e librave liturgjikë, në përbërje të së cilit qenë emra të njohur si prof. Aleksandër Xhuvani, Zoi Xoxa, Mihal Sherko etj.

Sinodi i Shenjtë me anën e një shkresë⁵⁰ iu drejtua Kryeministrit Koço Kota. Meshja e parë episkopale u celebrua më 24 shkurt 1929, në Kishën e Shën Gjergjit në Korçë. Gjatë meshën atë Vasil Marku u dorëzua Ikonom i Madh Mitrofor. Në përfundim të liturgjisë atë Vasil Marku i dorëzoi Fortlumturisë së Tij, Visarionit, kryqin historik të Kongresit të Beratit. Kjo ishte shenja simbolike e dorëzimit përfundimtar të kryesisë së kishës.

Më 21 shkurt 1929 Patriarku Ekumenik, Vasili u dërgoi një letër kishave autoqefale që qenë në varësinë e tij, me anën e së cilës i njoftonte se një prift kundërshtar duke bashkëpunuar me një episkop të huaj kanë bërë dorëzimin e parregullt të episkopëve, në kundërshtim me Protokollin e Tiranës, pavarësisht se nga kisha mëmë qenë bërë të gjitha përpjekjet për shpalljen kanonike të autoqefalisë. Patriarkana Ekumenike, si pushteti më i lartë kishtar i quajti antikanonike dorëzimet e Visarion Xhuvanit, Agathangjelit, Eugjenit dhe Ambrozit. Në mbledhjen e radhës së Sinodit të Shenjtë të patriarkanës Elumenike, që u mbajt më 5 mars 1929 u vendos mosnjohja e Ikonomit të madh Mitrofor Vasil Marku⁵¹. Sinodi theksonte se qeveria shqiptare kishte izoluar Imzot Kristoforin dhe kishte dëbuar Imzot Jerotheun⁵².

⁴⁹-Fan S. Noli, *Vepra II*, Zgjedhur dhe përgatitur nga prof. Nasho Jorgaqi, Dudaj, Tiranë 2003, faqe 353; Nos Xhuvani, *Visarion Xhuvani apostull i atdhetarizmit dhe i ortodoksisë shqiptare*, Tiranë 2003, faqe 70; Nos Xhuvani, Pavli Haxhillazi, *Na flet Visarion Xhuvani*, Tekno Paper, Tiranë 2008, faqe 163; Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 182-204; Dhori Qiriazi, *Krishterimi në Shqipëri*, Argeta LMG, Tiranë 2000; faqe 166; Fatmira Rama, *Sinodi i parë shqiptar dhe Kongresi i Dytë Paortodoks i Kishës Autoqefale Kombëtare*, në *në 70-vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Akademia e shkencave, Tiranë 1993, faqe 64-65; Andrea Llukani, *Krishterimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2014, faqe 98; Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *1929, si u krijua Sinodi i parë i KOASH-it*, Tema, 16 prill 2005, faqe 9.

⁵⁰-Në shkresë thuhet: "I shkëlqyeshëm Kryeministër! Sipas vendimit të marrun më datë 18 shkurt 1929 nga ana e hierarkisë shqiptare dhe në bazë të kanoneve kishtare, si dhe në konformitet të plotë me statutin kishtar të votuem në Berat, u formue Sinodi i Parë i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare. Kini mirësinë me pranue nderimet tona të nalta. Kryetari i Sinodit të Shenjtë, Kryeepiskop i Tiranës, Durrësit, Fortlumtunia e Tij, Visarioni".

⁵¹-Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 230-231.

⁵²-Në vitin 1929 Imzot Jerotheu pasi u largua nga Shqipëria u vendos në Skitin e Shën Anës në Shën Elefteri Vuleftira në Malin Athos. Për 27 vjet rresht ka qenë i vetmi episkop në Malin e Shenjtë. Imzot Jerotheu fjeti përgjithmonë më 1 shkurt të vitit 1956. Ceremonia e përmortshme u zhvillua më 2 shkurt në katedralen e Shën Dhimitrit në Selanik. Fjalën e rastit e mbajti teologu me origjinë nga Përmeti

Më 16 mars 1929 Fortlumturia e Tij, Kryeepiskop Visarioni u dërgoi një qarkore mërgatave shqiptare në Uashington, Ankara, Aleksandri, Bukuresht, Sofje dhe Athinë, ku i njoftonte për krijimin e Sinodit të Shenjtë. Ai kërkoi mbështetjen e gjithë shqiptarëve për këtë fitore historike të arritur me aq mund e përpjekje. Mërgatat e Bullgarisë dhe të Turqisë e mirëpritën lajmin dhe menjëherë nisën falënderimet e urimit. Theofan Noli qortonte rrugën e ndjekur për krijimin e Sinodit të Shenjtë, me ndihmën e Kishës të Serbisë, mirëpo nga ana tjetër ishte optimist se kjo rrugëzgjdhje shmangu vendosjen e kishës nën tutelën e kishës së Greqisë. Përfundimisht vetëm kisha e Trinisë së Shenjtë në Boston⁵³ u bashkua me Kishën Shqiptare më 14 qershor 1933. Një kundërshtar i flaktë ishte Koço Tasi, i cili nisi një fushatë kundër zgjidhjes së gjetur për çështjen kishtarë. Tasi ishte mbështetës i një Kise Autoqefale të drejtuar nga episkopë shqiptarë, me gjuhë meshimi shqipen, por i frikësohej një sundimi të mundshëm të shumicës myslimane mbi pakicën ortodokse⁵⁴.

KONGRESI I KORÇËS

Imzot Visarioni menjëherë filloi të konsolidonte strukturat e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Ai thirri Kongresin e dytë⁵⁵ (Fig.5) Kleriko-laik në qytetin e Korçës më 16 qershor të vitit 1929. Organizimi i Kongresit kishte nevojë për fonde dhe ato në pjesën më të madhe u siguruan nga shteti shqiptar i kohës. Në Kongres u zgjodhën intelektualët e shquar të vendit⁵⁶, klerikë me merita kishtarë,

Vasil Joanidhi. Varri i Imzot Jerotheut është në Skitin e Shën Anës në Malin Athos. Ilia Spiro Vasili, *Si e gjeta Episkopin Jerotheos*, Ngjallja, gusht 1996, faqe 9; Ilia Spiro Vasili, *Jeta dhe veprimtaria e dhespotit Jerotheos*, Ngjallja, maj 2003, faqe 9,10; Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 133-134.

⁵³-Kryesia e Kishës Autoqefale, mori nga Bostoni i Amerikës këtë telegram: “Kisha Shën Trinia dëshiron të jetë nën juridiksionin e Kishës Autoqefale të Shqipërisë dhe në pranohe mi lajmëronani telegrafisht se përgjigja asht pague stop. Jemi kundër Peshkopatës këtushme se s’ka lidhje me Kishën në Shqipni. Për komisionin: Kristo Josef, Kryetar d.v. Boston, më 25-X-1930”. *Visarion Xhuvani, në Kishë, në Parlament dhe në burg*, Vepra, botimet 55, Tiranë 2007, faqe 208.

⁵⁴-Koço Tasi, *Shqiptarëvet të Krishten bashkëpunëtorë të Muhamendanëvet*, Athinë 1929.

⁵⁵-Fatmira Rama, *Sinodi i parë shqiptar dhe Kongresi i dytë panortodoks i Kishës Ortodokse Autoqefale Kombëtare, 70-vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1993, faqe 65.

⁵⁶-Delegatët e këtij Kongresi qenë: Delegat i Tiranës Kryepeshkop Visarioni d.v. Delegat i Tiranës Dr Athanas Shundi d.v. Delegat i Tiranës Dr Zoi Xoxa d.v. Delegat i Shpatit Taq Buda d.v. Delegat i Shkodrës Atë Velisha Popoviq Delegat i Shkodrës Naim Plevneshi d.v. Delegat i Shkodrës Mitro Llazareviq d.v. Delegat i Korçës Ik. i M. Mitrofor at Vasil Marko d.v. Delegat i Korçës Stavraq Ballauri d.v. Delegat i Korçës Thoma Turtulli d.v. Delegat i Korçës Vasil Avrami d.v. Delegat i Korçës Sotir Kotta d.v. Delegat i Përmetit Dhimitri Kacimbra d.v. Delegat i Gjinokastrës Thoma Papapano d.v. Delegat i Gjinokastrës Kostandin Lito d.v. Delegat i Gjinokastrës Episkop Ambrozi d. v. Delegat i Gjinokastrës Ikonon Papavlashi Delegat i Libohovës Dhimoshten Haxhoglu d.v. Delegat i Leskovikut Andon Kito d.v. Delegat i Lushnjës Lllazar Bozo d.v. Delegat i Vlorës Kristaq Ikonon d. v. Delegat i Vlorës Atë Isaia d.v. Delegat i Vlorës Kristo Karbunara d.v. Delegat i Delvinës Mihal Maksakuli d.v. Delegat i Sarandës Apostol Dhima d.v. Delegat i Konispolit Loli Qesko d.v. Delegat i Durrësit Kristaq Zaguridhi d.v. Delegat i Durrësit Vasil Bakalli d.v. Delegat i Durrësit Moisi Popa d.v.

tregtarë dhe zanatçinj, të gjithë bij të bindur dhe besimtarë të aftë për të mbrojtur Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë.

Platforma kishtarë e Kongresit u përcaktua me vëmendje të madhe nga Visarion Xhuvani. Në të u parashikuan vendimet e pritshme, detyrat e komisioneve për organizimin e Kongresit dhe ceremonitë festive. Bazën kryesore të Kongresit e përbënte zgjidhja e drejtë e interesave fetaro-kombëtare, sigurimi i independencës dhe i tërësisë territoriale të vendit. Vendimet e tij duhej të mos lejonin në të ardhmen asnjë veprim që të binte ndesh me interesat kishtarë-kombëtare dhe brezat e rinj të ishin syhapur e të kujdeseshin për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Në të gjitha materialet e Kongresit vëmendje e veçantë iu kushtua zbatimit të kanoneve të shenjta. Sinodi i Shenjtë kishte vendosur që Kongresin e dytë do ta drejtonte kjo pari: Kryetar Imzot Visarioni, nënkryetar Vasil Avrami, kryesekretar Dr. Zoi Xoxa dhe kujdestar Thoma Papapano. Më 16 qershor të vitit 1929, të 46 delegatët përfaqësues të klerit dhe të ortodoksëve shqiptarë u mblodhën në Korçë për të filluar punimet e Kongresit të dytë Kishtar. Në fjalën e tij Imzot Visarioni parashitroi përmbajtjen kryesore të Statutit dhe të Rregullores së Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë.

Kongresi vazhdoi punimet 15 ditë. Mbas miratimit të parim, vendosi të krijojë një komision të posaçëm të përbërë nga: Mitrofor Vasil Marku, Vasil Avrami, Dhimitër Kacimbra, Taq Buda, Vasil Bakalli, Athanas Shundi, Lllazar Bozo, Nikolla Haxhinasto, Kristaq Ikonimi, Thoma Papapano, Mihal Cani, Milto Maksakuli dhe dr. Zoi Xoxa, të cilët do t'i jepnin statutit formën përfundimtare. Mbas 15 ditë diskutimesh në orën 7.30 të datës 29 qershor të vitit 1929 të gjithë delegatët firmosën dokumentet për tu miratuar në statut përfundimtar. Ky Statut⁵⁷ e vuri në themele të qëndrueshme Kishën Ortodokse Autoqefale Shqiptare. Në vijim Kongresi i dytë kishtar i Korçës shqyrtoi Rregulloren⁵⁸ e Administrimit të Përgjithshëm të Kishës, e

Delegat i Kavajës Kleanth Mineu d.v. Delegat i Himarës Dr Mihal Cane Delegat i Beratit Episkop Agathangjeli d.v. Delegat i Beratit Dr Nikolla Haxhistasa d.v. Delegat i Beratit Ikon. at Theodor Brisku d.v. Delegat i Fierit Jovan Xoxa d.v. Delegat i Mallakastrës Ikonom atë Polizozi d.v. Delegat i Kolonjës (Ersekë) Petro Prodani d.v. Delegat i Bilishtit Petro Ilia d.v. Delegat i Tepelenës Dhimitër Mole d.v. Delegat i Elbasanit Kostaq Cipo d.v. Delegat i Elbasanit Kov Deliana d.v. Delegat i Elbasanit Dhimitër Papajani d.v. Delegat i Poradecit Spiro Naço d.v. Delegat i Dibrës Stavrofor Ik. Josifi d.v. Delegat i Dibrës Dr Filip Papajani d.v. Delegat i Dibrës Gavril Lasku d.v. Komisioni i Qeverisë pranë Kongresit Panorthodhoks Shqiptar në Korçë: Vasil Bidoshi d.v. Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 215; Andrea Llukani, *Kanonet dhe statutet e Kishës Ortodokse*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 206-207; Andrea Llukani, *Krishterimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2014, faqe 104-106; Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Historia e fshehur e Kongresit të dytë të KOASH-it*, Tema, 5-6 qershor 2005, faqe 12-13.

⁵⁷-Dhori Qiriazi, *Krishterimi në Shqipëri*, Argeta LMG, Tiranë 2000, faqe 165; Nos Xhuvani, Pavli Haxhillazi, *Na flet Visarion Xhuvani*, Tekno Paper, Tiranë 2008, faqe 226-241; Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Si zgjidhej kryepeshkopi ortodoks në bazë të Statutit*, Tema, 7 qershor 2005, faqe 12-13; Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Kryetari i KOASH Visarion Xhuvani shpjegon statutin*, Tema, 8 qershor 2005, faqe 12-13; Andrea Llukani, *Kanonet dhe statutet e Kishës Ortodokse*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 187; Andrea Llukani, *Krishterimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2014, faqe 107-121.

⁵⁸-Rregullore mbi Administrimin e Përgjithshëm të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë; Andrea Llukani, *Kanonet dhe statutet e Kishës Ortodokse*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 209-223; Nos Xhuvani, Pavli Haxhillazi, *Na flet Visarion Xhuvani*, Tekno Paper, Tiranë 2008, faqe 246-

cila përcaktonte të drejtat dhe detyrat e çdo forumi drejtues të Kishës. Për hartimin e Rregullores të Administrimit të Përgjithshëm të Kishës kontribut të shquar kanë dhënë dhespotët Agathangjel e Ambroz, Ikonomi i Madh Mitrofor Vasil Marku, si dhe avokat Ilia Kota, Vasil Avrami, Thoma Papapano, dr. Mihal Cani, Kristaq Zaguridhi, Vasil Bakalli, dr. Zoi Xoxa e në mënyrë të veçantë Kov Deliana. Me punën e tyre të përbashkët më 20 korrik të vitit 1929 u miratua Rregullorja.

Më 9 korrik të vitit 1929 u dekretua ligji për komunitetet fetare, i cili zëvendësonte atë të vitit 1923. Sipas ligjit të ri komunitetet fetare duhet të ishin persona moralë, të cilët gëzonin të drejtat e përcaktuara me ligj. Komunitetet fetare gëzonin të gjitha të drejtat që parashikonte ligji, vetëm kur statuti i paraqitur prej tyre, pranohej nga Këshilli i Ministrave dhe dekretohej prej Mbretit. Statutet nuk duhet të binin ndesh me ligjet e shtetit. Në to theksohej që kryetarët e komuniteteve fetare të ishin shtetas shqiptarë mbi moshën 25-vjeçare dhe prej fisit e gjuhës shqiptarë. Emërimi i tyre dekretohej me dekret mbretëror. Ministria e Drejtësisë kontrollonte zbatimin e legjislacionit dhe miratonte buxhetet dhe rregulloret e komuniteteve fetare⁵⁹. Statuti i miratuar në Kongresin e Korçës, më 14 gusht 1929 u botua në Fletoren Zyrtare⁶⁰.

Në Kongresin e Korçës u vendos ndarja kishtare në bazë dioqeze duke formuar dioqezat e Korçës, Durrësit, Beratit dhe Gjirokastrës. Prej vitit 1922 e deri më mars 1930 qendra kishtare ishte Korça, ndërsa duke filluar nga prilli i vitit 1930 qendra kishtare kaloi në Tiranë duke marrë emrin Mitropolia e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit. Rezenca e Sinodit të Shenjtë u vendos në shkollën dykatëshe, në oborrin e kishës së Ungjillëzimit⁶¹.

Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, me Sinodin e Shenjtë, me Statutin dhe me Rregulloren e Administrimit të Përgjithshëm përmbushi kërkesat kanonike të Autoqefalisë dhe e meritonte Tomin e Patriarkanës së Stambollit. Për fat të keq nuk ndodhi kështu, u deshën edhe gati nëntë vjet që të ulej zemërimi i Patriarkanës Ekumenike. Kjo e fundit arriti të bllokonte ndërkombëtarizimin e Kishës Shqiptare.

Kryepiskop Visarioni ka qenë pjesëmarrës në Mbledhjen e Përbotshme të Kishave në Montro të Zvicrës, që u mbajt në gusht të vitit 1935, ku u takua me Përfaqësuesin e Patriarkanës Ekumenike dhe të dërguarin e Kishës së Greqisë. Prej aktivizimit të Kryepiskop Visarionit nëpër veprimtaritë ndërkombëtare, qëndrimi i disa kishave ortodokse ndaj kishës sonë filloi të ndryshojë. Kjo u duk në telegramet e urimit për Krishtlindjet e vitit 1935 që mori Fortlunturia e Tij nga primatët e kishave të Serbisë, Rumanisë, Polonisë dhe të Bullgarisë⁶². Përpjekjet e Visarionit vijuan me

260; Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Çfarë parashikonte Rregullorja e KOASH-it*, Tema, 9 qershor 2005, faqe 12-13; Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Roli i Mbretit Zog në krijimin e KOASH-it*, Tema, 10 qershor 2005, faqe 12-13.

⁵⁹-*Dekret-Ligj mbi formimin e Komunitetet Fetare*, Korçë, 1929, në "Fletorja Zyrtare", Nr. 38, 16 korrik 1929, faqe 1-3.

⁶⁰-*Statuti i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Korçë, 1929, në "Fletorja Zyrtare", Nr. 45, 14 gusht 1929, faqe 1-8.

⁶¹-Shkolla qe dykatëshe dhe kishte 6-7 dhoma dhe dy sallone. Kristofor Beduli, *At Marko Papajani dhe shënimet e tij*, Neraida, Tiranë 2004, faqe 16.

⁶²-Andrea Llukani, *Visarion Xhuvani martir i Kishës Ortodokse*, 55, 21 maj 2004, faqe 18.

dërgimin e dy telegrameve: më të parin uroi Mbretin e Grekëve, Jorgo II, për rikthimin në detyrë dhe më të dytin njoftoi Patrikun Ekumenik, Foti, se kishte meshuar greqisht me rastin e Krishtlindjeve. Visarioni e përfundonte telegramin e tij me një lutje drejtuar Tërëshenjtërisë së Tij, Patrikut Elumenik duke i kërkuar ndjesë⁶³, por nuk mori përgjigje. Patriarkana kërkonte me çdo kusht dorëheqjen e tij. Në 26 maj të vitit 1936, Kryepiskop Visarioni dha dorëheqjen⁶⁴ nga kryesia e kishës.

TOMI I AUTOQEFALISË

Më 4 janar 1933 Kristofor Kisi, me anën e një letre i parashtrori Kryepiskop Visarionit se ishte i gatshëm ti shërbente kishës shqiptare, pasi kishte kaluar katër vjet i mbyllur në manastir. Pretendimi i Kisit ishte mitropolia e Korçës, e cila kishte mbetur pa episkop. Xhuvani nuk iu përgjigj kërkesës së Kisit. Mirëpo, Kisi me ndërmjetësinë e Koço Kotës mundi të siguronte një takim me Mbretin Zogu I. Gjatë takimit Kisi i kërkoi të merrte drejtimin e një episkopate. Në nëntor 1933 Sinodi i Shenjtë e emëroi Kristofor Kisin Mitropolit të Korçës. Në këto kushte Sinodi i Shenjtë përbëhej nga: Fortlumturia e Tij, Visarioni, Mitropolit i Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit; Hirësi Kristofor Kisi, Episkop i Korçës; Hirësi Agathangjel Çamçe, Episkop i Beratit; Hirësi Ambroz Nikolla, Episkop i Gjirokastrës, Delvinës dhe Himarës; Hirësi Eugjen Hoshteva, Episkop Ndihmës i Peshkopisë dhe Ikonomi i Madh Mitrofor Vasil Marku⁶⁵. Në vitin 1934 Eugjeni dha dorëheqjen dhe u tërhoq në vendlindjen e tij, në Hoshtevë, ndërsa Episkop Ambrozi ndërroi jetë më 20 maj 1934. Sinodi i Shenjtë ia besoi Kisit mbikëqyrjen e Episkopatës së Gjirokastrës.

Më 1936 qeveria shqiptare dërgoi në Athinë kryeministrin Koço Kota për të biseduar me përfaqësuesit e Patriarkanës Ekumenike. Pas kësaj në nëntor të vitit 1936

⁶³-Telegram: Nalt Shenjtënisë së Tij FOTIOS, Patriarh Ekumenik. Mbas Meshës hyjnore të soçme në gjuhën Helenike të Kryostomit, në të cilën kemi lutun Zotin për Shenjtënin Tuej, tue marrë kurajo prej ndjenjave dhe inspiratave që festat e Lindjes së Shpëtimtarit Tonë Jisu duhet të Na sjellin dhe tue dëshirue me besue se, mbas të shtatit vit, asht hedhun ma nga ana e Patriarhisë së Shenjtë në harresën e ndjesës çdo vepër e padëshirueshme atje, por e cila u konsiderue si detyrë e domosdoshme nga ana e Jonë për të mirën e Orthodhoksisë së Shqipnisë dhe tue qenë të sigurtë se i Madhi i Parë ndër të Parët e Orthodhoksisë mallëngjehet kur konstaton sinqeritetin e Kryebijvet të Vet. Ju lutemi me respektin ma të thellë e me devocion me denjue me pranue përshtëndetjet dhe urimet ma të mira të Modestisë Sonë si dhe ato të Orthodhoksisë Shqiptare për jetëgjatësinë dhe lumtuninë e Shenjtënisë Suej dhe të lavdueshmes Patriarhisë Ekumenike stop. I lutemi gjithashtu Shenjtënisë Suej me bekue Modestin Tonë si edhe grigjën Tonë të vogël shpirtnore, të cilën Zoti i mëshirshëm Na e ka besue me anë të hirit të Perëndisë e për me i shërbye Orthodhoksisë këtu, e cila ka nevojë ma shumë se kurdoherë sot për solidarësinë e të gjitha Kishave Motra më Jesu Krishtin. Puthim të Djathtën Tuej të Shenjtë. VISARION. Kryepeshkop i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipnisë. *Visarion Xhuvani, në Kishë, në Parlament dhe në burg*, Vepra, botimet 55, Tiranë 2007, faqe 302; Revista Predikimi, Tiranë, 25.12.1935.

⁶⁴-Më 29 maj 1936 gazeta "Arbënia" botoi të plotë aktin e dorëheqjes së Kryetarit të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipnisë. *Visarion Xhuvani, në Kishë, në Parlament dhe në burg*, Vepra, botimet 55, Tiranë 2007, faqe 311-321.

⁶⁵-Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 270-271.

erdhën në Tiranë Pandelejmon Kotoko, Pandeli Evangjeli dhe Vasil Avrami për të biseduar me Kristofor Kisin. U vendos që një delegacion i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë i përbërë nga Imzot Kristofori dhe Josif Kedhi të shkonte në Athinë më 20 shkurt 1937 për të biseduar me Mitropolitin e Trapezuntës Krisanthin. Pas bisedimeve në Athinë delegacionit iu shtuan edhe dy kandidatët për episkopë Evlogjio Kurilla dhe Pandelejmon Kotoko. Kështu përfaqësia u nis për në Konstandinopojë më 28 mars 1937 dhe në prani të përfaqësuesve të Patriarkanës Ekumenike nënshkruan marrëveshjen. Çështja para se të jepej Tomosi ishte falja e episkopëve. Agathangjel Çamçe e dorëzoi kërkesën për falje më 10 mars 1937, ndërsa Atë Vasil Marku më 20 mars 1937. Patriarkana Ekumenike i fali.

Më datën 11 prill 1937 në Kishën e "Trinisë së Shenjtë" të Halkit u bë dorëzimi në gradën episkopale i Pandelejmonit, dhe po atë ditë në Kishën e "Shën Gjergjit" në Fanar u dorëzua Evlogjio Kurilla. Kështu më 12 prill 1937 Patriku Veniamin dhe Sinodi i Shenjtë i Patriarkanës Ekumenike të Kostandinopojës nëshkruan Tomin Patriarkal të njohjes së Autoqefalisë së Kishës Ortodokse të Shqipërisë. Tomi iu dorëzua Imzot Kristoforit duke e caktuar atë si Kryepiskop të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Ceremonia e dorëzimit të Tomit u zhvillua në Sallën e Madhe të Patriarkanës, me pjesëmarrjen e Patrikut Ekumenik Veniaminit, anëtarëve të Sinodit të Shenjtë të Patriarkanës, Konsullit të Shqipërisë në Stamboll Asaf Çaçulit etj⁶⁶.

Pas dhënies së autoqefalisë dy mitropoli u bënë episkopata, kurse episkopata e tretë, ajo e Gjirokastrës, u formua nga ndarja e Mitropolisë së Drinopolit. Patriarkana Ekumenike, si çmoi mirë nevojat fetare dhe kishtare të popullit ortodoks të Shqipërisë, i cili ndodhet në eparhitë e Korçës, Durrësit, Beratit dhe të Gjirokastrës, njoftoi autoqefalinë e Kishës Ortodokse të Shqipërisë me anën e Tomit⁶⁷ Patriarkal e Sinodik, që u lëshua më 12 prill 1937⁶⁸.

Para se të shpallej autoqefalia ishin bërë këto veprime kishtare prej Patriarkanës: 1-Duke marrë parasysh se qyteti i Tiranës, që ndodhet në mitropolinë e Durrësit, është shpallur kryeqytet i Mbretërisë Shqiptare vendosi të marrë këtë titull: "Mitropolia e Tiranës, Durrësit dhe e Elbasanit". Episkop i kësaj mitropolie u zgjodh me votim të rregullt, episkopi i Sinadës Kristofor Kisi. 2-Duke gjykuar të nevojshme vendosi që mitropolia e Beligradit të marrë titullin: "Episkopata e Hirëshme e Beratit, Vlorës dhe Kaninës". Episkop i kësaj episkopate u zgjodh me votim të rregullt Agathangjel Çamçe (pasi më parë iu hoq dënimi dhe u njoh dorëzimi i tij në gradën episkopale). 3-Për mitropolinë e Korçës u vendos që të marrë titullin: "Episkopata e Hirëshme e Korçës". Episkop i kësaj episkopate u zgjodh me votim të rregullt Evlogjio Kurilla. 4-Gjirokastra si pjesë e shkëputur nga mitropolia e Drinopolit

⁶⁶-Apostolou Glavina, *H Orthodoxoksi Aftoqefali Eklisia tis Alvanias*, Iperesia Dhimosievmaton, Thesaloniki 1998, faqe 66.

⁶⁷-Dhori Qiriaz, *Krishterimi në Shqipëri*, Argeta LMG, Tiranë 2000, faqe 168.

⁶⁸-Viron Koka, *Përpyjekjet për njohjen e Kishës Ortodokse Autoqefale nga Patriarkana (vitet 20-30), 70-vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1993, faqe 74.

formoi një episkopatë të veçantë duke marrë titullin: "Episkopata e Gjirokastrës"⁶⁹. Episkop i kësaj episkopate u zgjodh me votim të rregullt Pandelejmon Kotoko⁷⁰.

Patriarkana Ekumenike i dërgoi mesazh edhe Mbretit Zog dhe Kryeministrit Koço Kota. Delegacioni në përbërje të së cilit qenë katër hierarkët e Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë mbëriti në atdhe, të Dielën e Dafinës më 25 prill të vitit 1937. Me rastin e shpalljes së autoqefalisë në kishën katedrale të Tiranës u celebrua një liturgji panagjirike me pjesëmarrjen e hierarkëve dhe klerikëve të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Në këtë ceremoni ishte i pranishëm edhe mbreti Zog. Nga episkopi i Gjirokastrës Pandelejmon Kotoko u lexua⁷¹ përmbledhja e Tomit Patriarkal për dhënien e autoqefalisë shqiptare. Më 24 maj 1937 Kryepiskopi Kristofor me cilësinë e kryetarit të Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë iu përgjigj me një letër falënderimi Patrikut të Kostandinopojës Veniaminit.

Sinodi (Fig.6) i Shenjtë i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë përbëhej nga Kryehirësia e Tij, Kristofori Kryepiskop i Durrësit, Tiranës dhe i gjithë Shqipërisë, Agathangjel Çamçe Mitropolit i Beratit, Evllogjio Kurilla⁷² Mitropolit i

⁶⁹-Tomi Patriarkal dhe Sinodik për krijimin e Episkopatës së Gjirokastrës. +Veniamini me mëshirë të Perëndisë, Kryepiskop i Konstandinopojës, i Romës së Re dhe Patrik Ekumenik. Kisha ka për detyrë të saj të kujdeset për drejtimin dhe zgjidhjen e të gjitha çështjeve kishtarë dhe duke patur të drejtën e vjetër të krijimit apo të suprimimit të dioqezave, sipas nevojave të çdo kohe, të rregullojë pjesërisht apo tërësisht qenien dhe qeverisjen e tyre. Meqënëse edhe në këtë rast, në mbledhjen e tanishme të Sinodit u pa se një pjesë e Mitropolisë së Shenjtë të Drinopolit e Gjirokastrës, pas shpalljes në kohët e fundit të pavarësisë së Mbretërisë Shqiptare, përfshihet në territorin e saj, u gjykua se është më e dobishme dhe më e përshtatshme me gjendjen e tanishme, të shkëputet nga kjo pjesa tjetër e dioqezës së shenjtë të lartpërmendur dhe të nderohet e të ngrihet në dioqezë kishtarë më vete, sot për sot nën vartësi dhe drejtim nga Froni ynë i Tërëshenjtë Patriarkal, Apostolik dhe Ekumenik dhe që në të ardhmen të bëjë pjesë edhe kjo në Kishën Orthodokse Autoqefale të Shqipërisë që po formohet. Modestia jonë, duke gjykuar bashkë dhe me mitropolitët tanë të hirshëm, vëllezërit tanë të dashur bashkëmeshtarë më shpirtin e shenjtë, vendosëm dhe caktuam sinodikisht që: Pjesa e Mitropolisë së Tërëshenjtë të Drinopolit dhe Gjirokastrës, që ndodhet në Mbretërinë e Shqipërisë, të jetë që tani e tutje dioqezë kishtarë më vete, me nderimin dhe vlerësimin e një aspirote dhe me emrin: "Episkopatë e Hirshme e Gjirokastrës", kryepriifti i vendosur në të me zgjedhje kanonike të emërohet: "Episkop i Hirshëm i Gjirokastrës" duke gëzuar të gjitha të drejtat që u takojnë kryepriiftërinjve në aktivitet. Prandaj, si dëshmi, vërtetim dhe konfirmim të qëndrueshëm të atyre që gjykuan dhe vendosën kishtarisht, u bë dhe Tomi ynë Patriarkal e Sinosik, i regjistruar dhe i nënshkruar në Kodikun e Kishës sonë të madhe e të Shenjtë të Krishtit. Në vitin shpëtimtar 1937, muaji mars (30), periudhë e V-të, Patriku i Konstandinopojës Veniamin, Maksimi i Kalqidonës, Joaqimi i Dherkonit, Polikarpi i Prusës, Thomai i Prinçiponisë, Gjermanoi i Sardës, Gjenadi i Iliopojës dhe Thirës, Leonti i Theodoropojës, Konstandini i Irinopojës, Meleti i Kristopojës, Dorotheu i Laodicesë, Gjermanoi i Enit.

⁷⁰-*Veprimet e fundit Patriarkale dhe Sinodike të Kishës së Kostandinopojës*, Orthodhoksia, Kostandinopojë, viti XII, 1937.

⁷¹-Viron Koka, *Përpyjekjet për njohjen e Kishës Ortodokse Autoqefale nga Patriarkana (vitet 20-30), 70-vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1993, faqe 74.

⁷²-Evllogjio Kurilla ka lindur në fshatin Ziçisht të Korçës në vitin 1880. Studimet e larta teologjike dhe filozofike në Universitetin e Athinës i ka përfunduar në vitin 1912, ndërsa më 1935 mbrojti doktoratën me temë "Voskopoja dhe Akademia e saj". Po këtë vit u emërua profesor i historisë në Universitetin e Selanikut. Evllogjio Kurilla ka marrë pjesë në përfaqësinë, e cila u nis për në Kostandinopojë më 28 mars 1937 dhe në prani të përfaqësuesve të Patriarkanës Ekumenike ka nënshkruar marrëveshjen për

Korçës dhe Pandelejmon Kotoko Mitropolit i Gjirokastrës. Në përbërje të Sinodit të Shenjtë ishte edhe Ikonimi i Madh Mitrofor Atë Vasil Marku. Sipas Tomit të Autoqefalisë, organi më i lartë i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë ishte Sinodi i Shenjtë, i cili përbëhej prej episkopëve kanonikë. Kryetar i Sinodit të Shenjtë do të ishte gjithnjë Kryeepiskopi i Tiranës dhe i gjithë Shqipërisë, i cili ka për detyrë që të kujtojë emrat e Primatëve të Kishave Ortodokse Autoqefale. Gjithashtu në Tomin e Autoqefalisë theksohet që Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë duhet të marrë Miron e Shenjtë nga Patriarkana Ekumenike. Kjo e fundit njoftoi të gjitha Kishat Autoqefale të Aleksandrisë, Antiokisë, Jerusalemit, Greqisë, Polonisë, Qipros, Ivrisë, Sebisë dhe Rumanisë. Në maj të vitit 1937 Patriarkana Ekumenike i dërgoi Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë Miron e Shenjtë. Gjithashtu ofroi edhe dy bursa studimi për në Shkollën Patriarkale të Halkit. Mbledhja e parë e Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë u bë më 9 korrik 1937 me qëllim që hierarkët të qenë njohur me nevojat e grigjës së tyre.

Në 17 prill të vitit 1937 Visarion Xhuvani i drejtohet me anën e një letre Mitropolitit të Trapezundës, Krisanthit, me anë të së cilës i lutet që të ndërhyjë në Patriarkanën Ekumenike të Stambollit, që ajo të heqi dorë nga zhveshja e funksioneve të tij. Me anë të kësaj letre Xhuvani i drejtohet Patrikut Ekumenik Veniaminit I. Letrën ia dorëzoi⁷³ Krisanthit më 28 prill 1937 ambasadori i Shqipërisë në Athinë, Rauf Fico. Përgjigja e Kostandinopojës që e shpejtë, Visarioni falet, i njihet grada episkopale, por i jepet e drejta Sinodit të Tiranës që të vendosë për detyrën e re të tij. Më 5 gusht 1937 Visarion Xhuvani udhëtoi drejt Stambollit, ku u prit nga Patriku

dhënien e Tomit të Autoqefalisë të Kishës Ortodokse të Shqipërisë. Më 11 prill të vitit 1937 u dorëzua Mitropolitit i Korçës në Kishën Patriarkale të "Shën Gjergjit" në Fanar. Imzot Kurilla organizoi shkollën katekiste të së dielës, themeloi korin kishtar nën drejtimin e Sotir Kozmosit, mblodhi materiale folklorike etj. Meritë e tij ishte çelja e seminarit "Jovan Banga" në qytetin e Korçës. Me gjithë këtë aktivitet produktiv Imzot Kurilla nuk u vlerësua, por përkundrazi qeveria shqiptare më 29 shtator të vitit 1939, me anën e një shkresë të firmosur nga Xhafer Ypi e njoftonte se duhej të largohej nga Korça, me pretendimin se nuk kishte nënshtetësinë shqiptare. Pasi u largua nga Shqipëria Imzot Kurilla u emërua profesor i historisë në Universitetin e Athinës. Emrin e Evllogjio Kurillës mbajnë shumë libra, artikuj, transkriptime, fjalime dhe predikime. Si specialist i paleografisë ai ka transkriptuar shumë kodikë dhe dorëshkrime që gjendeshin në Bibliotekën e Athinës. Ai ishte një njeri i shquar në fushën e letrave dhe të teologjisë. Në një libër të tij, botuar në vitin 1935, Kurilla ka shkruar se Voskopoja është themeluar nga shqiptarët dhe më tej është populluar nga popullsia shqiptare dhe vllahë. Gjithashtu ai theksonte se në Voskopoje u ngjiz ideja e bashkimit shqiptar dhe e shkrimit të gjuhës shqipe. Ky pohim dhe disa të tjera si ky, qenë shkaku që në vitin 1942 në një mbledhje të Senatit Akademik të Universitetit të Athinës, Evllogjio Kurillën e akuzuan si nacionalist shqiptar dhe tradhëtar, i cili e kishte kthyer katedrën e historisë së Universitetit të Athinës në një katedër antikombëtare. Imzot Evllogjio Kurilla vdiq më 21 prill të vitit 1961 në Athinë. Shërbesa e përmortshme u zhvillua në Mitropolinë e Athinës me pjesëmarrjen e Kryeepiskopit të Greqisë Theoklitit dhe hierarkëve të tjerë. Për jetën dhe veprimtarinë e Mitropolitit të Korçës Evllogjio, foli episkopi i Gjirokastrës Pandelejmoni. Dr. Dion Tushi, *Pjesë monografie për Evllogjio Kurillën*, Tempulli, Nr. 14, Korçë 2009, faqe 70-75; Pëllumb Xhufi, *Shekulli i Voskopojes*, Toena, Tiranë 2010, faqe 23; Foti Cici, *Midis shqiptarësisë dhe grekësisë*, Globus R, Tiranë 2006, faqe 204-206.

⁷³-Teksti i letrës ka shpëtuar dhe ruhet në arkivin e Mitropolitit të Trapezundës Krisanthit.

Veniamin. Gjatë takimit Xhuvani e falënderoi dhe i shprehu mirënjohjen Patrikut Veniamin⁷⁴.

SINODI I VITIT 1942

Në vitin 1942 Kryeepiskop Kristofori thirri teologun Irine Banushi (Fig.7) dhe i propozoi të dorëzohej në gradën episkopale. Në shkurt të vitit 1942 Ilia u dorëzua në gradën episkopale në manastirin e Shën Naumit⁷⁵, që në atë kohë ishte në administrimin e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë⁷⁶. Pas dorëzimit ai mori emrin Irine dhe me vendim të Sinodit të Shenjtë të K.O.A.Sh-it u emërua Episkop i Strugës⁷⁷, Prespës dhe Caredvorit. Pas bashkimit të trojeve shqiptare gjatë pushtimit italian, u bë edhe riorganizimi i kishës. Kështu katër episkopatave ekzistuese iu

⁷⁴-Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 288.

⁷⁵-Në kohën që Konferenca e Ambasadorëve ia ktheu manastirin Mbretërisë Serbe-Kroate e Sllovene panairi i Shën Naumit zhvillohej regullisht. Për lehtësimin e pelegrinazhit të shtetasve shqiptarë në manastirin e Shën Naumit, Konferenca Ambasadorëve më 6 nëntor 1925, hartoi një rezolutë. Disa nga nenet e rezolutës janë: “U lejohet shtetasve shqiptarë, që në përputhje me dispozitat e këtij protokollit, të kalojnë lirshëm dhe gjatë gjithë vitit kufirin për të kryer pelegrinazh në manastirin e Shën Naumit. Kalimi i kufirit do të bëhet nga rruga, që nis nga fshati shqiptar Tushemisht, në jug të liqenit të Ohrit dhe të çon në manastirin e Shën Naumit, ose udha që ndjek pjesën e poshtme të luginës së Çëravës. Pelegrinazhi duhet të bëhet gjatë ditës, që nga lindja e diellit deri në perëndim të tij dhe pa armë. Pelegrinët duhet të jenë të pajisur me karta identiteti të lëshuara në gjuhën serbe e shqipe nga nënprefekti kompetent shqiptar. Këto karta përveç përshkrimit fizik të pelegrinit, do të përmbajnë datën e krijimit të tyre si dhe firmën dhe vulën e autoritetit që i ka lëshuar. Ato do të jenë të vlefshme për një vit dhe do të mund të rinovohen pas skadimit të këtij afati. Me hyrjen e tyre në territorin e Mbretërisë Serbe-Kroate e Sllovene, pelegrinët, të pajisur me karta do të duhet të paraqiten në postën kufitare, e cila do të ngjisë vizën e saj dhe datën e kalimit mbi kartë. E njëjta procedurë do të duhet të kryhet në dalje. Pelegrinët mund të qëndrojnë në territorin e Mbretërisë Serbe-Kroate e Sllovene maksimumi tri ditë”. Kaliopi Naska, *Shën Naumi dhe diplomacia e kohës*, Kristalina-KH, Tiranë 2012, faqe 673.

⁷⁶-Në vitin 1925 Mbreti i Shqipërisë Ahmet Zogu i dhuroi Mbretit të Serbisë Pashiq Manastirin e Shën Naumit në shkëmbim të disa kullotave në Vermosh. Kjo marrëveshje u miratua edhe nga parlamentet e të dy vendeve. Historiani Paskal Milo në lidhje me këtë marrëveshje thotë: “Zakonisht nuk është praktikë dhurimi i tokave të një shteti dhe ky ishte një veprim i gabuar dhe i dënueshëm duke ditur që Konferenca e Londrës e kishte njohur Shën Naumin si tokë shqiptare”. Ndërsa Akademiku Arben Puto në lidhje me dhurimin e Shën Naumit thekson: “Sipas të drejtës ndërkombëtare ky akt dhurimi nuk mund të kontestohet, pasi marrëveshja është miratuar edhe nga parlamentet e të dy vendeve”. Mbreti i Serbisë Pashiq mbështeti Ahmet Zogun që të vinte në pushtet dhe ky i fundit i dhuroi një nga manastiret më të bukura të Shqipërisë. Ahmet Zogu me mbështetjen politike që i dhanë serbët mundi të rrëzonte kryeministrin Fan Noli. Në vitin 1941 manastiri i Shën Naumit iu kthye Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Të gjitha konferencat e fuqive të mëdha, si për shembull Konferenca e Ambasadorëve e vitit 1922, Traktati i Firences i vitit 1913, Gjyqi Ndërkombëtar i Hagës dhe vendimi i 31 dhjetorit të vitit 1924, që u morën me përcaktimin e kufinjve të Shqipërisë e njohën manastirin e Shën Naumit si manastir shqiptar. Paskal Milo, *Ja si e humbën Shën Naumin*, Gazeta Shqiptare, 29 gusht 2003, faqe 7.

⁷⁷-Sipas Dhimitër Bedulit episkopata e Strugës në atë kohë kishte 35 famulli dhe 36 famulltarë (priftërinj e dhjakonë).

shtuan edhe ato të Prizrenit, të Peshkopisë dhe Strugës⁷⁸. Mitropolit i kësaj të fundit u emërua Imzot Irine Banushi.

Gjithashtu Imzot Agathangjeli qëndroi në fronin e Mitropolitit të Beratit deri në maj të vitit 1942. Agathangjeli u fronëzua Mitropolit i Korçës, post të cilin e mbajti nga viti 1942 deri më 1946 kur edhe fjeti përgjithmonë më Zotin. Vendin e Imzot Agathangjelit si Mitropolit i Beratit e zuri Imzot Visarion Xhuvani. Pas këtyre zhvillimeve Sinodi i Shenjtë i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë në vitin 1942 përbëhej nga Fortlumturia e Tij, Kristofor Kisi, Kryeepiskop i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë, Imzot Agathangjel Çamçe, Mitropolit i Korçës, Imzot Visarion Xhuvani, Mitropolit i Beratit dhe Imzot Irine Banushi episkop i Strugës, Prespës dhe Caredvorit. Gjithashtu anëtar i Sinodit të Shenjtë ishte edhe Ikonomi i Madh Stavrofor Vasil Marku.

LËVIZJA UNITE NË SHQIPËRI

Me pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste më 7 prill 1939 propaganda e romano-katolikëve për t'i kthyer ortodoksët në uniatë u intensifikua edhe më tepër sa që në vitin 1942 ata vepronin me 10 misione në Shqipërinë e Jugut. Por edhe qeveria shqiptare e asaj kohe ishte në shërbim të fashistëve dhe ushtronte presion ndaj Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë për një kthim të mundshëm të ortodoksëve në uniatë. Kështu më 16 gusht 1939 mëkëmbësi i Mbretit Viktor Emanuel III, Jakomoni ka njoftuar Pallatin Kixhi për një kthim të ortodoksëve në uniatizëm. Kryeepiskopi Kristofor nga njëra anë e kishte pranuar marrëveshjen me arbëreshët e Italisë dhe nga ana tjetër përpiquej që ta shtynte çështjen me qëllim që të fitonte kohë. (Fig.8) Anën e Kryeepiskopit Kristofor kanë mbajtur edhe Mitropoliti i Beratit Agathangjeli dhe Ikonomi i Madh Stavrofor Vasil Marku, ndërsa kundër kthimit në uniatizëm ishin Mitropoliti i Korçës Evllogjio dhe Mitropoliti i Gjirokastrës Pandejmoni, të cilët kërkuan me ngulm që të ruhej status-quoja e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Në këto kushte Kryeepiskopi Kristofor deklaroi se ishte gati për të mbledhur Sinodin e Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë për të shpallur bashkimin me kishën romano-katolike. Nëse Sinodi i Shenjtë do ta pranonte bashkimin atëherë edhe popullsia ortodokse do ta pranonte patjetër duke marrë parasysh edhe trysinë e pushtimit fashist. Vendimi i Kryeepiskopit të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë u prit mirë në Romë, megjithatë në Selinë e Shenjtë që në atë kohë drejtohej nga papa Piu XII nuk kishte uniet mendimi për rrugën që duhej ndjekur gjatë kthimit të ortodoksëve shqiptarë në uniatë. Disa qenë të mendimit për një bashkim të menjëhershëm me kishën romano-katolike, ndërsa të tjerë qenë për një kthim të shkallëzuar. Por me kapitullimin e

⁷⁸-Episkopatat e Kishës Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, pas bashkimit të tokave të liruara, me dekretin e këshillit të Nalt qenë: Tiranë-Durrës, Korça, Berati, Gjirokastra, Prizreni, Peshkopia dhe Struga; Dhimitër Beduli, *Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë gjer në vitin 1944*, Tiranë 1992, faqe 29.

Italisë fashiste më 1943 dështuan edhe planet e romano-katolikëve për t'i kthyer ortodoksët në uniatë⁷⁹. (Fig.9)

Gjatë luftës për çlirimin e Tiranës nga okupatorët nazistë, më 4 nëntor 1944 u dogj Selia e Kryesisë së Kishës Ortodokse Autoqefale (Mitropolia) dhe bashkë me të u dogj edhe arkivi. Kjo ishte një humbje e madhe për komunitetin ortodoks të Shqipërisë, sepse në arkiv qenë të depozituara dokumente me vlerë historike për bashkësinë ortodokse⁸⁰. Duhet theksuar se testamentet e ndryshme dhe akte të tjera të rëndësishme, që u përkisnin zëvendësive mitropolitane mbaheshin në arkivin e Kryesisë së Kishës në Tiranë.

⁷⁹-Roberto Moroco della Roka, *Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920-1944*, Tiranë 1993, faqe 216.

⁸⁰-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 995, fl. 1-2; Kristofor Beduli, *At Marko Papajani dhe shënimet e tij*, Neraida, Tiranë 2004, faqe 16.

KREU I DYTË

SHKARKIMI I KOTOKOS

Fitorja e komunistëve në Luftën Antifashiste Nacional-çlirimtare dhe sigurimi i përkrahjes së Jugosllavisë së Titos, i dhanë dorë diktatorit Enver Hoxha të instalonte në Shqipëri një nga regjimet më gjakatore, që ka njohur historia e njerëzimit. Vendi u zhyt në vorbullën e një lufte vëllavrasëse, në altarën e së cilës u flijuan njerëz, bindje, tradita dhe institucione. Në emër të dogmës së edukimit të njeriut të ri shqiptarët u detyruan ti nënshtrohen një procesit të indoktrinimit ideologjik ateist, që konsistonte në çrrënjosjen e bindjeve fetare⁸¹.

Më 31 mars 1945, Kryeepiskopi Kristofor Kisi⁸² u ka dërguar një letër anëtarëve të Sinodit të Shenjtë me Nr. Prot. 176, me anën e së cilës u kërkonte të shfaqnin mendimin e tyre në lidhje me aktivitetin antishqiptar të episkopit të Gjirokastrës, Pandelejmon Kotoko⁸³. Ndër të tjera në letër kryetari i Sinodit të

⁸¹-Pirro Kondili, *Orthodhoksia: burim qëndrese dhe shprehje lirie në Shqipërinë komuniste*, Kërkim, nr.16, Tiranë, 2019, faqe 52-72.

⁸²-Kristofor Kisi (1890-1958) ka lindur në lagjen Kala të Beratit në vitin 1890. Studimet e larta i ndoqi në Shkollën Patriarkale të Halkit ku u diplomua në vitin 1906. Tema që mbrojti diplomën ishte "Mbi prejardhjen e jetës monakale". Me përfundimin e studimeve teologjike më 1908 u kthye në atdhe dhe filloi punë në gjimnazin e Jovan Bangës në Korçë. Në vitin 1916 u dorëzua në gradën priftërore në Kostandinopojë dhe u caktua kryefamullitar në Makrohor. Më vonë u hirotonis episkop i Sinadës, post të cilin e mbajti deri në vitin 1923. Duke parë përpjekjet e otodoksëve shqiptarë për autoqefali, Imzot Kristofori u kthye vullnetarisht në Shqipëri, ku mori në drejtim Mitropolinë e Beratit. Më 21 nëntor 1923 Imzot Kristofori së bashku me Imzot Jerotheun dorëzuan në gradën episkopale Theofan Nolin në kishën e Shën Gjergjit në Korçë. Ndërsa në vitin 1929 u tërhoq në manastir duke mos marrë pjesë në veprimet antikanonike që po kryheshin në Kishën Ortodokse Shqiptare. Më 1934 Imzot Kristofori zuri vendin e Mitropolitit të Korçës dhe në vitin 1937 u zgjodh Kryetar i Sinodit të Shenjtë dhe Kryeepiskop i gjithë Shqipërisë. Për shumë vjet qëndroi në krye të Kishës Ortodokse në Shqipëri. Dhimitër Beduli, *Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë deri në vitin 1944*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë, 1992, faqe 43-44; Dhimitër Beduli, *Kishë dhe kulturë*, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2006, faqe 58; Dhimitër Beduli, *Teologë me origjinë shqiptare që janë diplomuar në Institutin Teologjik të Halkit*, Ngjallja, tetor 1996, faqe 10; Kristofor Beduli, *At Marko Papajani dhe shënimet e tij*, Tiranë 2004, faqe 37-38; *Personalitet madhor i Kishës sonë Orthodhokse*, Ngjallja, korrik 1996, faqe 9; Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 178-180; Andrea Llukani, *Krishtërimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012, faqe 110-111; Tomor Aliko, *Genocidi mbi elitën intelektuale të kombit shqiptar nën terrorin komunist*, Maluka, Tiranë 2007, faqe 261; Tomor Aliko, *Genocide in the intellectual elite od the Albanian nation under the communist terror*, Maluka, Tirana 2007, page 261.

⁸³-Pandelejmon Kotoko ka lindur në Korçë në vitin 1890. Studimet e larta i kreu në Institutin Teologjik të Halkit në Stamboll, ku u diplomua në vitin 1912. Tema me të cilën mbrojti diplomën ishte: "Mësimi i Joan Gojartit për misionin pimantik". Në vitin 1936 mbrojti Doktoraturën në Drejtësi, ndërsa më 11 prill 1937 u dorëzua Mitropolit i Gjirokastrës në kishën e "Trinisë së Shenjtë" të Halkit. Pandelejmon Kotoko e mbajti postin e Mitropolitit të Gjirokastrës nga viti 1937 deri në vitin 1941. Pas ripushtimit të Gjirokastrës prej italianëve Kotoko u largua nga Shqipëria me ushtrinë greke. Pasi u vendos në Athinë themeloi Komitetin Qendror për Epirin e Veriut. Kotoko ka vdekur në Athinë më 24 maj 1969. Dhimitër Beduli, *Teologë me origjinë shqiptare që janë diplomuar në Institutin Teologjik të Halkit*, Ngjallja, tetor 1996, faqe 10; Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011,

Shenjtë, Kisi shkruan se peshkopi dioqezës së Gjirokastrës, Pandelejmon Kotoko *de facto* është shkarkuar nga detyra dhe është zëvendësuar, por vendim pushimi nuk është marë dhe shkarkimi i tij nuk është dekretuar për shkak të pengesave, që paraqet statuti i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, i cili të drejtën e pushimit të kryetarit dhe të anëtarëve të Sinodit ia ka rezervuar vetëm kryetarit të shtetit. (Fig.1) Për t'i dhënë fund kësaj çështjeje kryetari i Sinodit të Shenjtë, Kisi u drejtohet anëtarëve të sinodit që me anën e shkresave përkatëse të shfaqnin mendimin e tyre⁸⁴.

Sipas Statutit të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë Imzot Pandelejmon Kotoko kishte bërë shkelje statutore dhe kanonike sepse kishte braktisur dioqezën e Gjirokastrës. Në letrën e tij, Mitropoliti i Beratit, Vlorës dhe Myzeqesë Imzot Visarion Xhuvani (Fig.2) i sugjeron Sinodit të ndjekë procedurat, që përcakton Statuti në lidhje me Gjykatën Shpirtërore, e cila ishte organi kompetent për të gjykuar çështjen e braktisjes së detyrës kishtarë. Pasi të ndiqeshin të gjitha procedurat përkatëse, atëherë Gjykata Shpirtërore do të vendoste pushimin nga detyra të titullarit të Mitropolisë së Gjirokastrës. Për këtë vendim të Gjykatës Shpirtërore Sinodi i Shenjtë i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë lipsej të njoftonte qeverinë shqiptare sepse ajo e kishte të drejtën e miratimit të shkarkimit nga detyra peshkopale të peshkopëve⁸⁵.

Më 16 maj 1945 u mbledh Sinodi i Shenjtë i KOASh-it, nën kryesinë e Kryeepiskopit Kristofor, Mitropolitit të Korçës dhe zëvendës i përgjithshëm i Dioqezës së Gjirokastrës, Imzot Agathangjelit, mitropolitit të Beratit dhe Vlorës, Imzot Visarionit dhe Ikonomit të Madh Stavrofor Vasil Marku. Sinodi i Shenjtë në mbledhjen e tij të jashtëzakonshme shqyrtoi dhe më pas dekretoi pushimin e Imzot Kotokos. Ndër çështjet që u diskutuan qenë se në vitin 1940 peshkopi Pantelejmon Kotoko, në atë kohë titullar i Dioqezës së Gjirokastrës është larguar nga Shqipëria pa lejen e Kryetarit të Kishës, duke shkelur kështu artikullin 26 të Statutit të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Pas këtij akti Sinodi i Shenjtë e ka konsideruar të dorëhequr dhe Kryeepiskopi ka emëruar si Zëvendës të Përgjithshëm të Dioqezës së Gjirokastrës peshkopin e Korçës Imzot Agathangjelin⁸⁶. (Fig.3) Gjithashtu ka

faqe 221; Andrea Llukani, *Krishtërimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012, faqe 108; Foti Cici, *Midis shqiptarësisë dhe grekësisë*, Globus R, Tiranë 2006, faqe 204-206.

⁸⁴-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1, viti 1945, fl. 1.

⁸⁵-Pavli Haxhillazi, *Një letër e panjohur e Visarion Xhuvanit*, Shqiptarja.com, 14 tetor 2012, faqe 20; Pavli Haxhillazi, *Një letër e panjohur e Visarion Xhuvanit*, Le Radici, Anno 10, Nr. 5, Ottobre 2012, pagina 18; Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1, viti 1945, fl. 3-4.

⁸⁶-Agathangjel Çamçe (1877-1946) ka lindur në qytetin e Korçës më 1877. Në vitin 1913 emigroi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku u shqua si aktivist i lëvizjes kombëtare. Në vitin 1919 u dorëzua në gradën priftërore në Nju Jork, ku shërbeu dy vjet duke celebruar shërbesa fetare në gjuhën shqipe. Në vitin 1921 Atë Agathangjel Çamçe erdhi në Shqipëri dhe një vit më vonë më 1922 mori ofiqin e Arkimandritit. Në muajin shkurt të vitit 1929 u dorëzua Episkop i Beratit, Vlorës dhe Kaninës në Kishën Katedrale të Ungjillëzimit prej Imzot Visarionit dhe Imzot Viktorit. Në vitin 1941 Imzot Agathangjeli u dorëzua Mitropolit i Korçës. Imzot Agathangjel Çamçe ka vdekur në vitin 1946. Dhimitër Beduli, *Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë gjer në vitin 1944*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 1992, faqe 44; Dhimitër Beduli, *Kishë dhe kulturë*, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë

urdhëruar që të mos përmendet gjatë meshës emri i peshkopit të dorëhequr në kishat e peshkopatës së Gjirokastrës. Përpos faktit se është larguar nga Shqipëria pa lejen e Kryetarit të Kishës, peshkopi Pandelejmon Kotoko duke shtuar fajet e tij kanonike ka pranuar dhe kryesinë e një komisioni, që punon kundër integritetit të vendit⁸⁷.

Më 13 qershor 1945 Kryeepiskop Kristofor Kisi i ka dërguar një shkresë me numër protokollit 238 Ministrisë së Drejtësisë, me anën e së cilës i parashtronte për dekretim vendimin e Sinodit të Shenjtë të KOASH-it. Gjithashtu Ministria e Drejtësisë me anën e shkresës që mban numrin e protokollit 794, datë 19 qershor 1945 i përgjigjet se vendimi i Sinodit të Shenjtë është me vend, sepse i përgjigjet misionit të lartë fetar dhe patriotik të institucioneve tona fetare. Kisha Ortodokse me të drejtë nuk mund të toleronte një peshkop, që ka zhvilluar dhe zhvillon veprimtari antikombëtare të vazhdonte të mbante titullin e një dioqeze shqiptare⁸⁸.

Pas shkarkimit të episkopit të Gjirokastrës, Pandelejmon Kotoko, Sinodi i Shenjtë i KOASH-it kishte këtë përbërje: Kristofor Kisi në cilësinë e Kryeepiskopit, Mitropolit i Korçës dhe Zëvendës i Përgjithshëm i Dioqezës së Gjirokastrës, Imzot Agathangjeli, Mitropolit i Beratit, Vlorës dhe Myzeqesë, Imzot Visarioni dhe Ikonimi i Madh Stavrofor Vasil Marku⁸⁹.

Në mbledhjen e Sinodit të Shenjtë të datës 4 korrik 1945 u diskutua çështja e episkopit të Strugës Irine Banushi⁹⁰. (Fig.4) Kryetari i Sinodit të Shenjtë Kristofor

2006, faqe 58-59; Andrea Llukani, *Krishtërimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012, faqe 108-109; Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 6.

⁸⁷-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1, viti 1945, fl. 5-6.

⁸⁸-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1, viti 1945, fl. 7-8.

⁸⁹-Vasil Marku (1888-1949) është nga Borova e Kolonjës. Që në moshë të re emigroi në Amerikë, ku u dorëzua prift në Sant Louis. Në vitin 1919 së bashku me Agathangjel Çamçen erdhën në Shqipëri dhe morrën pjesë aktive në përpjekjet për autoqefalinë e kishës. Në vitin 1922 Kongresi historik i Beratit e zgjodhi Kryetar të Këshillit të Lartë. Më 1923 Atë Vasil Marku ka kryesuar përfaqësinë e kishës shqiptare, e cila shkoi në Kostandinopojë për çështjen e autoqefalisë. Më 24 shkurt 1929 Atë Vasil Marku mori ofiqin e Ikonimit të Madh Mitrofor dhe u caktua anëtar i Sinodit të Shenjtë, në cilësinë e titullarit të dioqezës së Korçës. Ceremonia u zhvillua në Kishën e Shën Gjergjit në Korçë. Dhimitër Beduli, *Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë deri në vitin 1944*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë, 1992, faqe 45-46; Dhimitër Beduli, *Kishë dhe kulturë*, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2006, faqe 59; Andrea Llukani, *Krishtërimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2014, faqe 90; Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 290.

⁹⁰-Irine Banushi (1906-1976) ka lindur në Shkodër në vitin 1906. Mësimet e para i mori në qytetin e lindjes dhe më pas vajti në Seminarin "Bogosllava" të Cetinjës në Malin e Zi. Studimet e larta teologjike i vazhdoi në Beograd dhe i përfundoi në vitin 1938. Menjëherë u kthye në atdhe ku filloi punë në Seminarin "Apostull Pavli" dhe në gjimnazin e Tiranës duke dhënë lëndën e latinishtes. Në prillin e vitit 1939 Ilia Banushi u bashkua me qëndresën antifashiste. Më pas e internuan në provincën e Kolfioritos në Itali nga ku u kthye në vitin 1940. Në atë kohë Kryehirësia e Tij Kristofor Kisi, i cili drejtonte Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, duke shmangur një përpjekje të italianëve për të emëruar një episkop unit, i propozoi Ilia Banushit, i cili shquhej për përgatitje të lartë teologjike dhe përkushtim ndaj atdheut. Kështu në shkurt të vitit 1942 Ilia u dorëzua në gradën episkopale në Manastirin e Shën Naumit që në atë kohë ishte në administrimin e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Pas dorëzimit ai mori emrin Irine. Me vendim të sinodit u dorëzua episkop i Strugës, Prespës dhe Caredvorit. Dhimitër Beduli, *Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë deri në vitin 1944*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë, 1992, faqe 45; Dhimitër Beduli, *Kishë dhe kulturë*, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2006, faqe 59; Andrea Llukani, *Krishtërimi në Shqipëri*, Trifon

Kisi deklaroi se Imzot Irineu është emëruar me vendim sinodi episkop i Strugës, por dekreti qeveritar nuk ka dalë ende, prandaj Sinodi i Shenjtë vendosi që Imzot Irineu të jetë anëtar i sinodit me cilësinë e episkopit të Strugës⁹¹. (Fig.5)

PËRPLASJA E KISIT ME TEOLOGËT E RINJ

Në korrik të vitit 1945 u themelua Lidhja e Teologëve dhe Seminaristëve të K.O.A.Sh-it, e cila zgjodhi si kryetar të saj teologun Theofan Popa⁹². Sekretar i lidhjes u zgjodh teologu Dhimitër Beduli⁹³. Anëtarë të lidhjes qenë: Petro Doçi⁹⁴,

Xhagjika, Tiranë 2014, faqe 141; Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 127-128; *Irine Banushi-martir i Kishës sonë Orthodhokse*, Ngjallja, nëntor 2018, faqe 9.

⁹¹-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1, viti 1945, fl. 18.

⁹²-Theofan Popa ka lindur më 3 nëntor të vitit 1914, në lagjen Kala të Elbasanit në një familje zanatçinsh. Pasi përfundoi shkollën fillore "Kostandin Kristoforidhi", me ndërhyrjen e atë Josif Mihalit mundi të sigurojë një të drejtë studimi për në Seminarin Teologjik "Joan Teologu" në Manastir. Me mbarimin e seminarit në vitin 1936 u kthye në Shqipëri dhe pas një viti me mbështetjen e Kryepeshkopit Visarion Xhuvani mundi të shkonte për të ndjekur studimet e larta në Fakultetin Teologjik të Universitetit Kapodistria të Athinës, në vitin akademik 1937-1938, me bursë nga fondacioni Jovan Banga. Ndërkohë në Shqipëri ndodhën ndryshime të mëdha përsa i përket organizimit kishtar. Më 12 prill 1937, Patriarkana Ekumenike shpalli autoqefalinë e Kishës Ortodokse të Shqipërisë dhe Kryepeshkop i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë u zgjodh Kristofor Kisi. Sapo përfundoi vitin e parë të fakultetit, Theofani mori një letër nga Kryepeshkop Kisi, me anën e së cilës i thuhej se duhej t'i ndërpriste studimet në Athinë, për t'i vazhduar në Kolegjin Anglikan "Ngjallja e Krishtit" në Londër. Pasi qëndroi vetëm disa muaj në Londër (gusht-tetor 1938) u kthye në Athinë për të vazhduar studimet, të cilat i përfundoi në vitin 1941. U kthye në atdhe më 1942 dhe filloi punë në Liceun e Korçës si profesor i gjuhës latine. Më vonë u transferua në Tiranë ku punoi si predikues dhe artikullshkrues pranë kryesisë së kishës. Theofani botonte një buletin dyjavor me predikimet e të dielave, i cili u dërgohej kishave ortodokse të Shqipërisë. Andrea Llukani, *Ndihmesa e Theofan Popës për shpëtimin e mbishkrimeve dhe objekteve liturgjike kishtarë*, (monografi), Trifon Xhagjika, Tiranë, 2019, faqe 13; Andrea Llukani, *Dosja e teologut Theofan Popa*, Global Challenge, Revistë Shkencore Periodike, Botim i Akademisë Diplomatike Shqiptare, Volumi VI, Numri 2, Tiranë, Maj 2017, faqe 93; Andrea Llukani, *Krishtërimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012, faqe 286; Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 278-279; Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Dosje formulare, Nr. 3328, faqe 16.

⁹³-Dhimitër Beduli (1914-1996) ka lindur më 1914 në Skore të Pogonit në rrethin e Gjirokastrës. Në vitin 1930 pasi përfundoi gjimnazin në Athinë, u nis për studime teologjike në Rumani, të cilat i përfundoi në vitin 1934. Përveç studimeve teologjike në seminarin e Besarabisë, Beduli u specializua edhe në Muzikën Bizantine. Sapo u kthye nga Rumania në vitin 1934 punoi si pedagog dhe gjatë viteve 1935-1944 u emërua drejtor i seminarit "Apostull Pavli" në Tiranë. Me mbylljen e Seminarit në vitin 1945 Beduli filloi punë në Drejtorinë Qendrore të Oficinave në Durrës dhe në vijim shef plani në Uzinën Mekanike në Tiranë. Mund të themi se që nga viti 1945 deri në vitin 1967 kur u prishën kishat, janë plot 22 vjet, gjatë të cilave Beduli i talentuar ka qenë i mënjanuar. Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 66; Andrea Llukani, *Krishtërimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012, faqe 288.

⁹⁴-Petro Doçi ka lindur në Elbasan, më 20.07.1909. Në vitin 1928 siguroi një bursë nga Visarion Xhuvani për të ndjekur studimet teologjike në Seminarin e Manastirit (Bitolës). Gjatë viteve të seminarit ishte e detyruar mësimi i një vegle muzikore. Petro Doçi zgjodhi mandolinën. Seminarin e

Vlash Semini⁹⁵, Anastas Duka, Vangjel Popa, Petro Frashëri, Vlash Nushi⁹⁶, Sotir Kanxheri etj., të gjithë njerëz të shkolluar nëpër seminare dhe shkolla teologjike brenda ose jashtë vendit. Këta kishin qenë pjesë aktive e kishës, por Këshilli Ekonomik për mungesë fondesh disa prej tyre i kishte shkarkuar nga detyra dhe ata qenë të detyruar të punonin ku të mundnin që të siguronin jetesën. Teologët dhe seminaristët e larguar nga kisha e ndienin veten të shpërfillur dhe për këtë bënë me faj Kryesinë e Kishës. Njeri prej tyre Anastas Duka⁹⁷ ishte mjaft kritik ndaj Kryesisë së Kishës, sepse teologët dhe seminaristët qenë larguar nga kisha dhe qenë punësuar në administratën shtetërore.

Lidhja e Teologëve dhe Seminaristëve të K.O.A.Sh-it hartoi statutin, rregulloren dhe ligjëroi vulën. Simboli bazë në vulën e Lidhjes së Teologëve dhe

përfundoi në vitin 1934. Në vijim u kthye në Elbasan ku ka punuar si mësues. Më 19 shtator 1937 emërohet nga Kryepiskop Kristofor Kisi si predicator në kishat e Elbasanit. Më 1935 u martua me Vasillon. Më 25 shtator 1938 u dorëzua dhjakon nga Imzot Kristofor Kisi. Më pas është emëruar Protodhiakon i Kryesisë së Kishës. Më pas e gjejmë Drejtor Përgjegjës i revistës “Jeta Kristiane”. Në vitin 1950 u dorëzua prift. Ka marrë pjesë në konferenca të ndryshme kishtare brenda dhe jashtë vendit. Me mbylljen e kishave më 1967 Petro Doçi ka punuar në një pikë karburanti. Vite më vonë ka punuar roje në Laboratorin Shkencor të Fakultetit të Shkencave të Natyrës etj. Petro Doçi ka vdekur më 27 dhjetor 1983. Kristofor Beduli, *Saqellar atë Petro Doçi*, Neraida, Tiranë 2006, faqe 10-31.

⁹⁵-Vlash Semini ka lindur në qytetin e Kavajës më 1906. Pas përfundimit të studimeve teologjike në Bukuresht, Vlashi u kthye në Tiranë, ku ka shërbyer si kujdestar dhe psalt në Kishën e Shën Prokopit. Vlash Semini ka botuar shumë artikuj teologjik në shtypin periodik të K.O.A.Sh-it. Ai vdiq më 24 qershor të vitit 1989. Kristofor Beduli, *Dhimitër Beduli bir i zgjedhur dhe i përkushtuar i kishës sonë*, Ngjallja, Tiranë 2015, faqe 78; Kristofor Beduli, *Psaltët Vlash Nushi e Vlash Semini*, Ngjallja, gusht 1997, faqe 8; Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 296.

⁹⁶-Vlash Nushi ka lindur në Tiranë më 8 shkurt 1914. Pasi përfundoi shkollën fillore ka punuar pranë babait, i cili kishte një dyqan të vogël në Shën Vlash. Në vitet 1931-1935 përfundoi seminarin Apostull Pavli në Tiranë. Në vijim ka punuar si psalt në Tiranë, ndërsa më 1937 ka punuar si mësues feje. Në vitin 1940 ka punuar në Ministrinë e Ekonomisë në Tiranë. Gjatë viteve 1954-1959, Vlash Nushi ka punuar si referent i pasurive kishtare. Vlashi ka botuar disa artikuj në revistën “Predikimi”. Kur u themelua Lidhja e Teologëve dhe Seminaristëve të K.O.A.Sh-it më një korrik të vitit 1945 Vlash Nushi ka qenë i zgjedhur në kryesinë e lidhjes. Vlash Nushi ka vdekur në vitin 1981. Kristofor Beduli, *Shkollat teologjike-hieratike*, Neraida, Tiranë 2001, faqe 46-48; Kristofor Beduli, *Psaltët Vlash Nushi e Vlash Semini*, Ngjallja, gusht 1997, faqe 8; Andrea Llukani, *Atë Dhimitër Kokoneshi, figurë e shquar e kombit*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2010, faqe 25; Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 296; Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja nr. 1471, viti 1951, fl. 34-36.

⁹⁷-Anastas Duka ka lindur më 10 maj 1921 në Sheper të Gjirokastrës. Pasi kreu shkollën fillore në vendlindje ka bërë tre vjet shkolë të mesme në Gjirokastrë dhe pesë vjet në Tiranë ku ka përfunduar Liceun më 1942. Gjatë viteve të qëndrimit në Tiranë ka kryer seminarin Apostull Pavli ku ka qenë bursist. Në prill të vitit 1945 ka qenë në varësi të Kishës Ortodokse, duke punuar në vende të ndryshme. Gjatë muajve prill-gusht 1945 ka punuar në manastirin e Shën Gjon Vladimirit në Elbasan, prej andej për nëntë muaj ka punuar në manastirin e Shën Vlashit në Durrës. Në qershor 1946 ka punuar për disa muaj në manastirin e Ardenicës. Në periudhën dhjetor 1946 deri në mars 1947 ka punuar në Pogradec. Prej andej ka qenë në dispozicion të Kryesisë së Kishës në Zyrën e Llogarisë. Në janar 1948 ka shërbyer në Fier si predikues dhe mësues katekizmi. Në prill 1948 ka punuar në Shën Vlash të Durrësit dhe prej andej ka shkuar në vendlindje në Sheper, në pritje të një detyre të re nga Kryesia e Kishës. Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Dosja nr. 1470, viti 1951, fl.3-4.

Seminaristëve qenë dy duar të shtrënguara, duke mbajtur një kryq. Rreth këtij simboli shkruhej Lidhja e Teologëve dhe Seminaristëve të Kishës Ortodokse. Qendra e lidhjes ishte në Tiranë, por u krijuan degë nëpër rrethe si në Durrës, Korçë, Shkodër etj. Me vendimin e Gjykatës së Tiranës datë 19 shtator të vitit 1945, Lidhja e Teologëve dhe Seminaristëve të K.O.A.Sh-it u ligjërua zyrtarisht⁹⁸.

Lidhja e Teologëve dhe Seminaristëve të K.O.A.Sh-it pikëpamjet e saj i shfaqti në broshurën me titull "Ç'është dhe çfarë kërkon Lidhja e teologëve dhe e seminaristëve ortodoksë". Qëllimi kryesor i kësaj Lidhjeje ishte që të kontribuonte në përparimin dhe lartësimin e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, me qëllimin e vetëm që ajo të ruante integritetin e saj dhe të mos përshtatej me rrethanat që i diktonte sistemi. Në kryesinë e lidhjes u zgjodhën: Sotir Kanxheri⁹⁹, Dhimitër Beduli, Ilija Stavre, Vlash Semini dhe Arkile Kondi. Kryesia e lidhjes më 24 shtator 1945 i shkroi një letër¹⁰⁰ Sinodit të Shenjtë, me anë të së cilës i parashtroi synimet e saj. Sinodi i Shenjtë më 18 korrik 1945 iu përgjigj, se do ta studionte përmbajtjen e letrës, gjë që acaroi edhe më shumë marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të lidhjes dhe kryesisë së kishës. Anëtarët e Lidhjes fajësonin Kryepiskopin Kristofor për gjendjen e mjeruar në të cilën ishte katandisur Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë. Qëllimi i tyre ishte të merrnin në dorë situatën, duke tërhequr pas vetes klerikët dhe besimtarët. Teologët e seminaristët e rinj qenë njerëz të arsimuar dhe synonin të detyronin Kryepiskopin Kristofor që të përfshiheshin brenda strukturave të kishës. Në mbledhjen e datës 20 tetor 1945 Sinodi i Shenjtë refuzoi të njihnte Statutin e Lidhjes së Teologëve dhe Seminaristëve. Madje u vunë si kusht se nëse dëshironin njohjen e Lidhjes duhej ti kërkonin falje kryesisë së kishës për letrat me tone të ashpra që i kishin dërguar. Sinodi i Shenjtë ngarkoi episkopin e Gjirokastrës, Imzot Irineun tu komunikonte anëtarëve të Lidhjes vendimin e sinodit¹⁰¹. Në këto kushte teologët dhe seminaristët, por edhe kryesia e kishës vendosën të ulin tonet dhe të gjejnë gjuhën e përbashkët.

Në fund të dhjetorit Kryepiskopi Kristofor Kisi u bëri të ditur anëtarëve të Lidhjes së do ti merrte parasysh kërkesat e tyre, nëse ata do të tregonin respekt ndaj

⁹⁸-Kristofor Beduli, *Shkollat teologjike-hieratike*, Neraida, Tiranë 2001, faqe 46-48; Andrea Llukani, *Ndihmesa e Theofan Popës për shpëtimin e mbishkrimeve dhe objekteve liturgjike kishtare*, (Monografi), Trifon Xhagjika, Tiranë 2019, faqe 14; Andrea Llukani, *Krishterimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2014, faqe 351.

⁹⁹-Kryedhjakon Sotir Kanxheri ka lindur në qytetin e Korçës më 10 nëntor të vitit 1922. Në vitet 1932-1935 ndoqi Liceun Francez të Korçës dhe në vijim kreu Seminarin "Apostull Pavli" në Tiranë. Në vitin 1950 u dorëzua në dhjakon, ndërsa në vitin 1965 mori ofiqin e kryedhjakonit. Kanxheri me zërin e tij kumbues i lëçiste aq bukur ungjillin, paqësoret dhe himnet e Liturgjisë Hyjnore. Më 27 mars 2000 u zhvillua shërbesa e varrimit për kryedhjakon Sotir Kanxherin në Kishën e Ungjillëzimit në Tiranë. Kryedhjakon Sotir Kanxheri ka dhënë kontributin e tij në financat e kishës. *Fjeti Kryedhjakoni Sotir Kanxheri*, Ngjallja, prill 2000, faqe 3; Andrea Llukani, *Krishterimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012, faqe 161-162; Andrea Llukani, *Një nga ata*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 13-14.

¹⁰⁰-Disa nga pikat e letrës qenë: punësimi i teologëve dhe i seminaristëve, vendosja e njerëzve të ndershëm në Këshillin Ekonomik të kishës dhe në Këshillin Mikst, transparenca mbi shpenzimet e kishës etj.

¹⁰¹-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 20, viti 1945, fl. 42.

kryesisë së kishës¹⁰². Më 31 dhjetor 1945 Lidhja e Teologëve dhe Seminaristëve vendosi ti dërgojë një letër tjetër Kryepiskopit Kisi, me anën e së cilës e sqaronin se do të qenë bij të bindur të kishës¹⁰³. Madje ata ndryshuan edhe disa pika në statutin e tyre, duke pranuar autoritetin e kryesisë së kishës dhe premtorin se çdo gjë do të zhvillohej sipas statutit të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Pas kësaj, Kisi ishte i gatshëm ta njihje Lidhjen e Teologëve dhe Seminaristëve për të shmangur përçarjen në gjirin e kishës¹⁰⁴.

GJENDJA E KISHËS PAS ARRESTIMIT TË VISARION XHUVANIT DHE TË IRINE BANUSHIT

Kryesia e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë filloi të spastrojë radhët e saj. Njerëzit e aftë dhe me integritet shikoheshin me dyshim nga ata që qenë në shërbim të sistemit monist. Në vitin 1946 ndërroi jetë Mitropoliti i Korçës, Agathangjel Çamçe, ndërsa më 28 tetor të vitit 1946 u arrestua Irine Banushi¹⁰⁵. Në shënimet biografike Irineu ka shkruar: *...qëndrova si ndihmës Episkop i Kryesisë deri më 12 korrik 1945, në atë datë prej Sinodhit të kishës jam emëruar si Episkop për dioqezën e Gjirokastrës, por pushteti më ndaloi që të mos shkoj në Gjirokastrë dhe unë atëhere qëndrova këtu në Tiranë pranë Kryesisë së Kishës si titullar i dioqezës së Gjirokastrës deri më 28 tetor 1946, ditën që u arrestova*¹⁰⁶. (Fig.6) Akuzat ndaj Irineut qenë krejtësisht të pabaza¹⁰⁷. Dolën disa dëshmitarë të rremë, të cilët me paturpësinë më të madhe dëshmuan kundër tij. Pas disa muaj qëndrimi në hetuesi, më

¹⁰²-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1, viti 1945.

¹⁰³-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 20, viti 1945, fl. 43.

¹⁰⁴-Artan R. Hoxha, *Kisha Ortodokse nën komunizëm*, UETPRESS, Tiranë, 2017, faqe 52.

¹⁰⁵-Imzot Irineu do të provonte egërsinë e diktaturës kumuniste duke u burgosur dy herë në vitet 1946-1948 dhe 1952-1960. Pasi kreu dënimin atë e gjejmë në manastirin e Shën Vlshit. Lidhjet e shumta me njerëzit dhe ndikimi i madh që kishte në popull do të bëheshin shkak që organet e diktaturës ta transferonin Imzot Irineun në manastirin e Ardenicës. Tashmë i zhveshur nga çdo detyrë kishtarë punoi si llogaritar (1967). Danish Bebeziqi, *Si e njoha Peshkopin Irine*, Vegim Drite, Nr.4 qershor 1997, faqe 25; Tomor Aliko, *Genocidi mbi elitën intelektuale të kombit shqiptar nën terrorin komunist*, Maluka, Tiranë 2007, faqe 262; Tomor Aliko, *Genocide in the intellectual elite od the Albanian nation under the communist terror*, Maluka, Tirana 2007, page 262.

¹⁰⁶-Kristofor Beduli, *Episkop Irine Banushi, martir i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Tiranë 2000, faqe 17.

¹⁰⁷-Ka qenë në lidhje me armiqtë e popullit Gjergj Kokoshi, Dom Shtjefën Kurti etj. Ka zhvilluar aktivitet kundër Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë dhe ka nxitur elementë të tjerë për të shpifur kundër Kryesisë së Kishës me qëllim për të diskretituar udhëheqjen e saj dhe më në fund për ti hequr nga posti dhe për të kthyer Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë kundra vijës që ndjek sot dhe për të zhvilluar aktivitet kundër Pushtetit. Irine Banushi, element armik i Pushtetit dhe që paraqet rrezikshmëri për Republikën tonë Popullore i shtyrë nga urrejtja që ka kundër Pushtetit dhe për tu shërbyer armiqve është interesuar dhe ka mbledhur informata të ndryshme në vendin tonë dhe sidomos në portin e Durrësit mbi eksportet dhe importet që sjell shteti ynë nga jashtë, sidomos nga ato që vijnë nga Bashkimi Sovjetik se mos këta vaporë sjellin material luftarak. Ka folur kundër lëvizjes nacional çlirimtare dhe kundër pushtetit... Kristofor Beduli, *Episkop Irine Banushi, martir i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Tiranë 2000, faqe 32.

28 tetor 1946 iu komunikua vendimi, me anën e të cilit dënohej me pesë vjet heqje të lirisë¹⁰⁸. Irine Banushi e vuajti dënimin në burgun e Tiranës.

Pas arrestimit të Visarion Xhuvanit dhe Irine Banushit situata në Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë ishte kritike, sepse organi më i lartë që ishte Sinodi i Shenjtë kishte humbur kuorumin për të qenë funksional. I vetmi peshkop në sinod kishte mbetur Kristofor Kisi dhe sipas nenit 11 të statutit¹⁰⁹ të vitit 1929 për kuorumin e Sinodit të Shenjtë duhet të qenë gjysma plus një e anëtarëve të tij. Kryepiskopi Kristofor ja shprehu këtë shqetësim Manol Konomit, që në atë kohë mbante postin e ministrit të Drejtësisë. Kristofor Kisi i tha ministrit të Drejtësisë që në qershor do të shkonte për vizitë zyrtare në Bashkimin Sovjetik dhe nëse patriku Aleksej do ta pyeste për përbërjen e Sinodit të Shenjtë, atëhere nuk kishte se çfarë përgjigje ti jepte. Me anën e këtij argumenti bindës Kisi i kërkoi Konomit të lironte nga burgu Irine Banushin, por ministri nuk pranoi ta bënte këtë gjë¹¹⁰. Duke ndjekur zhvillimet kishtarë interesi i regjimit për Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë ishte që të zgjidhej çështja e Sinodit të Shenjtë. Në muajin shkurt 1949 ministri i Brendshëm, Mehmet Shehu e takoi Irine Banushin në burgun e Tiranës, ku folën për situatën, që po kalonte kisha në atë kohë. Dy muaj më pas, më 28 prill 1949, Irine Banushi u lirua nga burgu falë një amnistie. Irineu u çaktua në manastirin e Shën Vlashit në Durrës. Synimi i regjimit ishte që Irine Banushi do të shërbente si njeriu i pushtetit brenda kryesisë së kishës, por faktet treguan se Irineu nuk u thye.

VIZITA E DELEGACIONIT KISHTAR NË MOSKË

Më 8 maj të vitit 1947 u mbledh Sinodi i Shenjtë i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë në kryesinë e Kryehirësisë së tij, Kryepiskopit Kristofor Kisi, Mitropolitit të Beratit Imzot Visarionit dhe Ikonomit të Madh Stavrofor Vasil Marko. Qëllimi i mbledhjes së sinodit ishte dërgimi i një delegacioni kishtar në përgjigje të ftesës së Patrikut të Moskës dhe gjithë Ruisë Aleksej me rastin e 500 vjetorit të shpalljes së autoqefalisë së Kishës së Ruisë¹¹¹. Në ftesën e Patrikut Aleksej drejtuar Kristofor Kisit thuhej se periudha më e përshtatshme që fundi i shtatorit. Fillimisht u vendos që në përbërje të delegacionit të qenë: 1-Kristofor Kisi, Kryepiskop i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. 2-Ikonom Dhimitër

¹⁰⁸-Tomor Aliko, *Genocidi mbi elitën intelektuale të kombit shqiptar nën terrorin komunist*, Maluka, Tiranë 2007, faqe 262; Tomor Aliko, *Genocide in the intellectual elite of the Albanian nation under the communist terror*, Maluka, Tirana 2007, page 262.

¹⁰⁹-Në nenin 11 të Statutit të vitit 1929 është shkruar: “Sinodhi ka kuorum kur ndodhen prezentë gjysma plus një e numrit të të gjithë anëtarëve. Po kurdoherë mbledhje legale mund të bëhet vetëm kur përveç Kryepeshkopit ndodhen dhe dy anëtarë të tjerë.....”. *Statuti i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Fletorja Zyrtare, 14 gusht 1929; Andrea Llukani, *Kanonet dhe statutet e Kishës Ortodokse*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 193.

¹¹⁰-Artan R. Hoxha, *Kisha Ortodokse nën komunizëm*, UETPRESS, Tiranë, 2017, faqe 102.

¹¹¹-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 103, viti 1947, fl.2.

Kokoneshi, Kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Rrethit të Pogradecit. 3-Atë Petro Doçi, famullitar i komunitetit ortodoks të Tiranës dhe 4-Atë Llazar Popoviç, famullitar i komunitetit malazez të Shkodrës. Kjo ishte përbërja e delegacionit të lartë kishtar sipas shkresës që Kryepiskopi Kristofor i dërgonte më 11.VI.1947 Ministrisë së Punëve të Jashtme¹¹². Por keqësimi i shëndetit të Kristofor Kisit e bëri të pamundur pjesëmarrjen e tij. Kështu përbërja e delegacionit sipas shkresës së Kryesisë së Sinodit të Shenjtë Nr. 375 datë 15 dhjetor 1947 ishte: 1-Arkimandrit Paskal Vodica, drejtues administrativ i Episkopatës së Korçës, shef i delegacionit. 2-Ikonom Dhimitër Kokoneshi dhe 3-Ikonom Llazar Popoviç¹¹³. Delegacioni zyrtar (Fig.7) i Kishës Ortodokse të Shqipërisë qëndroi 18 ditë në Bashkimin Sovjetik. Gjatë ditëve të qëndrimit delegacioni shqiptar vizitoi Moskën, Leningradin dhe Kievin. Delegacioni shqiptar pati një pritje të përzemërt nga patriku Aleksej.

SHKARKIMI I KRISTOFOR KISIT DHE DORËZIMI I PASKAL VODICËS

Në kuadër të forcimit të miqësisë ndërmjet dy kishave tona rusët premtuan se në momentin e përshtatshëm do të dërgonin një delegacion të lartë kishtar për të vizituar Shqipërinë¹¹⁴. Patriku Aleksej i Moskës i dërgoi një letër Kristofor Kisit, me anën e së cilës theksonte se kisha ruse do të ndihmonte kishën shqiptare. Me fjalën ndihmë nënkuptohej mbështetja që do të jepte për krijimin e Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Në koordinim me Patriarkanën e Moskës, Ministria e Drejtësisë i kërkoi Kristofor Kisit, të përgatiste procedurat e hirotonisjes së dy episkopëve për dioqezat e Gjirokastrës dhe të Korçës. Kisi pranoi dhe sipas tij, kisha kishte nevojë të ngutshme vetëm për një episkop, ndërsa për të dytin priste puna. Delegacioni rus mbërriti në Shqipëri më 14 prill 1948. Ai përbëhej nga Kryepiskopi Nestor, protoprezviteri Pjetër Fillonov dhe atë Mihail Zjernov. Më 18 prill 1948 Nestori bashkë me Kristofor Kisin hirotonisën në gradën episkopale Paskal Vodicën në kishën katedrale të "Ungjillëzimit" në Tiranë. Pas dorëzimit si Mitropolit i Korçës, Paskal Vodica mori emrin Paisi¹¹⁵. Kandidatura e Paskal Vodicës nuk ishte shqyrtuar më parë në mbledhjen e Sinodit të Shenjtë dhe ishte antikanonike, pasi ai nuk plotësonte kriterin e arsimimit¹¹⁶ dhe të beqarisë, ndonëse prej vitesh kishte

¹¹²-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 151, viti 1947, fl.11.

¹¹³-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 151, viti 1947, fl.32.

¹¹⁴-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 217, viti 1948, fl. 23-24.

¹¹⁵-Kristofor Beduli, *At Marko Papajani dhe shënimet e tij*, Neraida, Tiranë 2004, faqe 30.

¹¹⁶-Në nenin 17 të Statutit të vitit 1929 theksohet: "Kryepeshkopi dhe Peshkopët e Shqipërisë që do të dorëzohen, përveç cilësive t' Artikullit 16 duhet të kenë dhe cilësitë që kërkojnë kanonet e Kishës, si dhe të kenë mbaruar një Fakultet Theologjic. Në rast nevojë, gjer më pesë vjet pas hyrjes në fuqi të këtij Statuti, mund të dorëzohet Peshkop edhe ay që ka diplomë fakulteti drejtësie, filologjie ose të një Seminarit Orthodhoks në gradë Liceu". *Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Fletorja Zyrtare, 14 gusht 1929; Andrea Llukani, *Kanonet dhe statutet e Kishës Ortodokse*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 195.

mbetur i ve. Procedura e dorëzimit të Paskal Vodicës ishte e rregullt, pasi që hirotonisur nga dy peshkopë kanonikë, Nestorit dhe Kristoforit.

Më 5 qershor 1948, në mbledhjen e Byrosë Politike, ndër të tjera diktatori Enver Hoxha diskutoi edhe për Kristofor Kisin, duke e cilësuar atë si agjent të perëndimit, që nuk dëshironte afrimin e Kishës Autodokse Autoqefale të Shqipërisë me Patriarkanën e Moskës. Hoxha pretendonte se Kisi gjatë vizitës së delegacionit rus, ishte përpjekur të lidhej me Legatën franceze në Tiranë, që të merrte udhëzime nga Perëndimi. Pas kësaj akuze false diktatori Enver Hoxha mendonte se Kisi duhej mënjanuar nga drejtimi i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë¹¹⁷.

Në muajin korrik 1948, autoritetet shtetërore i sugjeruan Kryepiskopit të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Fortlumturisë së Tij, Kristofor Kisit të tërhiqej nga administrimi i kishës, ndonëse në nenin 19 të statutit të vitit 1929 thuhej: “Kryepeshkopi dhe Peshkopët janë të përjetshëm në Dhioqezat e tyre përveç rasteve të parashikuara në këtë Statut”¹¹⁸. Ndonëse Kristofor Kisi mbeti formalisht në krye të kishës, udhëzimet do ti jepte Paisi me ndihmën e sekretarit të përgjithshëm Niko Çanes. Madje, Paisi iu besua edhe mbajtja e vulës së Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë¹¹⁹. Në fakt sipas nenit 22 të statutit, Sinodi i Shenjtë kishte të drejtën ta shkarkonte Kryepiskopin, për shkak të moshës së thyer ose problemeve shëndetësore, të cilat nuk e linin të përmbushte detyrën¹²⁰.

Paisi kishte nevojë për mbështetje brenda sinodit, prandaj kërkoi që anëtarë të sinodit të qenë edhe Arkimandrit Dhimitër Kokoneshi¹²¹, i cili në atë kohë drejtonte dioqezën e Beratit dhe Ikonom Aristotel Strato¹²², që administronte dioqezën e

¹¹⁷-Sipas studiuesit Artan Hoxha lidhjet e Kristofor Kisit me ministrin e Francës në Shqipëri, Guy Menant qenë të forta. Megjithatë organet e Sigurimit të Shtetit nuk raportojnë për asnjë lloj kontakti mes tyre gjatë muajit prill 1948, që përkonte me vizitën e delegacionit rus. Artan R. Hoxha, *Kisha Ortodokse nën komunizëm*, UETPRESS, Tiranë, 2017, faqe 105; Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi 140, Dosja Nr. 60, fleta 51.

¹¹⁸-*Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Fletorja Zyrtare, 14 gusht 1929, Andrea Llukani, *Kanonet dhe statutet e Kishës Ortodokse*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 196.

¹¹⁹-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi Nr. 536, Dosja Nr. 232, fl.115.

¹²⁰-Në nenin 22 të statutit është shkruar: “Kryepeshkopi, Peshkopët dhe Ikonomi i Madh Mitrofor, për shkak sëmundjeje kronike ose pleqërie, të cilat nuk u përmetojnë të përmbushin detyrat e tyre Peshkopale, kanë të drejtë t’i paraqisin kanonikisht dhe me të shkruar dorëheqjen e tyre Sinodhit, i cili vendos. Po Sinodhi mundet edhe *motu proprio* të çfaqë mejtimin mbi sëmundjen ose pleqërinë e tyre pas një raporti prej pesë mjekësh të zgjedhur dy prej Sinodhit vetë, dy prej të sëmurit dhe një prej Drejtorisë së P. të Shëndetësisë. Në qoftë se Kryepeshkopi ose Peshkopët nuk japin dorëheqjen brenda dy javëve prej datës së komunikimit, Sinodhi me një herë emëron një ndihmës Peshkop, i cili merr përsipër administrimin e Peshkopatës. Kryepeshkopi dhe Peshkopët të deklaruar të pamundur mbajnë titullin e tyre dhe përmenden në Kishë e në ceremonitë e Shenjta prej ndihmësit Peshkop dhe prej gjithë Klerit, po nuk ushtrojnë asnjë veprim administrativ dhe nuk marrin asnjë pjesë aktive në administrimin e Kishës. Në qoftë se Doktorët raportojnë pamundërinë e tyre, ata japin dorëheqjen duke marrë nga arka e përgjithshme e Kishës një shpërblim të përmuajshëm për Kryepeshkopin gjastëqind franga ari, dhe për Peshkopët katërqind fr. ar”. *Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Fletorja Zyrtare, 14 gusht 1929; Andrea Llukani, *Kanonet dhe statutet e Kishës Ortodokse*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 197.

¹²¹-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 155, viti 1948, fl. 5.

¹²²-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 155, viti 1948, fl. 8.

Gjirokastrës. Nga ana kanonike si Kokoneshi ashtu edhe Strato nuk mund të qenë anëtarë të sinodit, sepse nuk e patën marrë ende gradën episkopale. Ndërkohë që më 5 korrik 1949, Ministria e Drejtësisë e thirri Kisin dhe e urdhëroi të mbledhë sinodin. Kristofor Kisi u kërkoi autoriteteve shtetërore, që në përbërje të sinodit të ishte edhe Irine Banushi, por ata iu përgjigjën me diplomaci “do ta studiojmë si rast”. Duke mbetur i vetëm përballë klerikëve, që qenë caktuar nga regjimi, Kristofor Kisi më 9 korrik 1949 njohu Kokoneshin dhe Straton si anëtarë të sinodit¹²³. Duke patur në dorë Sinodin e Shenjtë, regjimi do të niste zbatimin e një politike të re brenda kishës me mbështetës të bindur ndaj kryesisë së kishës dhe të pushtetit.

Në mbledhjen e Sinodit të Shenjtë¹²⁴ të 25 gushtit 1949 Kryepiskop Kristofor Kisin e shkarkuan me akuza nga më banalet sikur kishte ngrënë dhe pirë në një çanak me pushtuesin, sikur mbante veshët çuar nga deti, duke pritur shpëtimin nga jashtë, sikur kishte bërë punë armiqësore të rrezikshme për të diskretuar pushtetin popullor etj¹²⁵. Në kohën që u shkarkua Kisi, Irine Banushi deklaroi se procedura e ndjekur ishte antikanonike, sepse duke u bazuar në nenin 21 të statutit ku thuhet: “*Pushimi i Kryepeshkopit, i Peshkopëve dhe i Ikonomit të Madh Mitrofor bëhet për fajë të rënda dogmatike dhe kanonike, për fajë ordinare dhe për arsye ekstraordinare.*”¹²⁶ Kisin e shkarkuan në mënyrë antikanonike dhe nuk u mjaftuan vetëm me kaq, por e mënjanuan dhe e izoluan në kishën e Shën Prokopit në Tiranë. Sinodi u mor edhe me problemin e Irine Banushit. Më 31 gusht 1949 Irineu u emërua peshkop ndihmës i kryesisë së kishës, por nuk u lejua që të drejtonte ndonjë dioqezë.

Pas shkarkimit së Kristofor Kisit i erdhi radha Paisi Vodicsë¹²⁷. Më 25 gusht 1949 Paisi Vodica u shpall Kryepiskop i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë¹²⁸. (Fig.8) (Fig.9)

¹²³-Artan R. Hoxha, *Kisha Ortodokse nën komunizëm*, UETPRESS, Tiranë, 2017, faqe 116.

¹²⁴-Në mbledhjen e Sinodit të Shenjtë qenë Paisi Vodica me cilësinë e kryetarit, Dhimitër Kokoneshi, anëtar, Aristotel Strato anëtar, Niko Çane, anëtar. Ikonomi i Madh Mitrofor Vasil Marku nuk mori pjesë për arsye shëndetësore.

¹²⁵-Disa nga akuzat sipas Paisit ndaj Kisit qenë: “Kristofor Kisi me origjinë nga Berati, por i mburitur në llumin e shovinizmit të Fanarit, u bë renegat i Kishës dhe i popullit tonë dhe tregtar e ryshfexhi i idealeve më të shenjta të saj, i fshehur nën maskën e Kryepiskopit dhe të Episkopit, punoi gjithmonë në dëm të Kishës sonë, të cilën nuk e drejtoi kurrë sipas interesave të saj dhe të popullit shqiptar, por sipas interesave dhe sugjerimeve e diktateve të të huajve, duke e shikuar gjithnjë çdo çështje nën prizmin e rryshfetit....Nën cilësinë e Kryetarit të Sinodit dhe të Këshillit Miks dhe në bashkëpunim të ngushtë me anëtarët e këtij të fundit Andon Beça, Vangjel Gozhomani e Mihal Sherko dhe në prapaskenë me doktor Petrotën e delegatin Apostolik vendosi hedhjen e Kishës sonë në prehërin e unizmit, duke e prurë këtë çështje gjatë një mbledhjeje të Këshillit Miks dhe duke pritur rastin e volitshëm që të shpallte bashkimin definitiv dhe zyrtarisht me papën”. Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 290, viti 1950, fl. 44-49.

¹²⁶-*Statuti i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Fletorja Zyrtare, 14 gusht 1929; Andrea Llukani, *Kanonet dhe statutet e Kishës Ortodokse*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 196.

¹²⁷-Paisi Vodica ka lindur më 1881 në Vodicë të Kolonjës. Në moshën 29-vjeçare u dorëzua prift dhe ka shërbyer në fshatin e tij të lindjes. Vite më vonë u zgjodh zëvendës episkop. Paisi Vodica ka përkrahur pa rezerva luftën nacional-çlirimtare deri në çlirimin e plotë të atdheut. Për meritat e tij patriotike gjatë luftës është nderuar me “Urdhërin e Flamurit” dhe medaljet e Kujtimit, Çlirimit dhe të Trimërisë. Pas çlirimit të vendit u zgjodh anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë. Paisi kishte qenë më parë i martuar dhe kishte mbetur i ve. Ai ishte i ati i Josif Pashkos, i

Me vendosjen e Paisit në krye të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë regjimi komunist nisi procesin e konsolidimit të pushtetit. Kryesia e Kishës tashmë gjithë veprimtarinë e saj e përqendroi në funksion të interesave të pushtetit. Për të realizuar këtë Kryesia e Kishës duhej të spastronte personelin nga njerëzit e papërshtatshëm. Personelit iu kërkua të dorëzonin biografite në Kryesinë e Kishës. Biografite¹²⁹ u përdorën për të eliminuar rivalët në radhët e personelit të kishës. Në organikën e kishës u shtua një post, ai i nëpunësit të biografive, i cili u shpërndante dhe më pas administronte formularët e biografive të personelit.

Problem tjetër i rëndësishëm që edhe uniteti i përçarë i njerëzve që qenë zgjedhur në rangjet e larta kishtarë. Pasi vendosi të kryente spastrime në radhët e personelit kishtar. Të parët që u vunë në shënjestër qenë anëtarët e kryesisë së Lidhjes së Teologëve dhe Seminaristëve, Theofan Popa, Vlash Nushi dhe Sotir Kanxheri, të cilët patën kundërshtuar hapur draftin e parë të Statutit. Mëria e teologëve të rinj ishte jo vetëm ndaj Paisit, por edhe ndaj Niko Çanes, që në atë kohë mbante postin e Sekretarit të Përgjithshëm të Kishës. Kundër Niko Çanes ishte edhe Dhimitër Kokoneshi. Në janar 1950 Kokoneshi i dërgoi një letër Mehmet Shehut me anën e së cilës e akuzonte rëndë Niko Çanen, si arkitektin e të gjitha konflikteve, që patën shpërthyer në Kryesinë e Kishës. Akuza më e fortë ishte se Niko Çane ishte njeriu i Kotokos në Kryesinë e Kishës. Ky fakt i vrau veshin Mehmet Shehut prandaj kërkoi një hetim të thellë mbi njeriun, që kishte kaq pushtet mbi Kryepiskopin Pasi Vodica. Kokoneshi, duke bashkëpunuar me Spiro Velin dhe Aristotel Straton kërkuan thirrjen e mbledhjes së Sinodit të Shenjtë, në të cilin do të merrej masa disiplinore ndaj kryesekretarit Niko Çane. Pasi Vodica vuri në dijeni kryeministrin Mehmet Shehu. Ky i fundit udhëzoi drejtorin e Komitetit Klerik, Gaço Peristerin që ta shkarkonte Çanen nga detyra e sekretarit dhe ta emëronte diku në administratën shtetërore. Në këtë moment u fut në lojë Josif Pashko, i cili i quajti shpifje akuzat e Kokoneshit. Madje, Pashko theksoi se konflikti është kurdisur nga Irine Banushi, Theofan Popa, Dhimitër Beduli dhe Sotir Kanxheri¹³⁰. Nga ana tjetër Niko Çane u hodh në sulm, duke e akuzuar Kokoneshin si papist e reaksionar, që punonte kundër interesave të kishës në bashkëpunim me armiqtë Theofan Popa, Dhimitër Beduli, Sotir Kanxheri dhe Vlash Nushi.

cili në atë kohë mbante postin e Ministrit të Ndërtimit. Më 18 prill të vitit 1948 në Kishën Katedrale të Ungjillëzimit në Tiranë, arkimandrit Pasi Vodica u dorëzua Mitropolit i Korçës prej Kryepiskopit Kristofor Kisi dhe një episkopi rus të quajtur Nestor, që kishte ardhur enkas për këtë punë. Ndërsa më 25 gusht 1949 Pasi u shpall Kryepiskop i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Andrea Llukani, *Krishtërimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2014, faqe 158.

¹²⁸-Dhori Qiriazi, *Krishtërimi në Shqipëri*, Argeta LMG, Tiranë 2000, faqe 169.

¹²⁹-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja nr. 1470, viti 1951; Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja nr. 1471, viti 1951; Azem Qazimi, *Komunitetet fetare në Shqipërinë Komuniste*, Instituti i Studimeve të Krimeve dhe pasojave të Komunizmit, Tiranë 2014, faqe 7-8.

¹³⁰-Artan R. Hoxha, *Kisha Ortodokse nën komunizëm*, UETPRESS, Tiranë, 2017, faqe 180-181.

VIZITA E PESHKOPIT NIKON NË SHQIPËRI

Më 27 maj 1951 një delegacion i kishës ruse mbërriti në Shqipëri. Në përbërje të delegacionit ishin peshkopi i Odesës, Nikon dhe eksarku i Dioqezës së Moskës Pavël Cvetkov. Në portin e Durrësit të dërguarve të patrikut të Moskës, Aleksej iu bë një pritje e përzemërt. Në vijim udhëtuan drejt kryeqytetit ku u sistemuan në Hotel Dajti. Në orën 18.00 të mbrëmjes delegacioni rus u prit në rezidencën e Kryepiskopit, ku në prani të klerikëve dorëzuan një letër nga patriku i Moskës, Aleksej dhe një arkëz me vezën e kuqe të Pashkës ku qe shkruar “Krishti u Ngjall”. Kryepiskop Pasisi thellësisht i prekur nga ky simbol i dashurisë vëllazërore kristiane shprehu gëzimin madh për harmoninë shpirtërore, që ekzistonte ndërmjet kishës shqiptare dhe asaj ruse. Në vijim folën përfaqësuesit e institucioneve të kryeqytetit, të cilët nuk i kursyen komplimentat për marrëdhëniet vëllazërore ndërmjet dy popujve tanë. Më 28 maj paradite delegacioni rus vizitoi muzeun e Luftës Nacional-çlirimtare, ndërsa pasdite në orën 18.00 u pritën në kishën e Shën Prokopit¹³¹. Ish Kryepiskopi Kristofor Kisi nuk u lejua të takonte delegacionin rus. Një orë përpara pritjes Kisit iu komunikua mospjesëmarrja në pritje, prej atë Dhanil Çulit. Pakënaqësinë e tij Kristofor Kisi e shprehu me anën e një letre, e cila mban datën 29 maj 1951. (Fig.10) (Fig.11)

Të nesërmen më 29 maj 1951 delegacioni i kishës ruse vizitoi manastirin e Shën Vlashit, ku u prit përzemërsisht nga murgeshat ruse, të cilat nën udhëheqjen e igumenes Maria këndonin psalmin “Engjëlli thërriste”. Pas tedeumit që u celebrua në kishën e manastirit u shtrua një drekë. Murgeshat ruse e përcollën delegacionin deri në rëzë të kodrës duke psallur kanonet e Pashkës¹³².

Delegacioni rus i nis drejt Durrësit ku bënë një tedeum në katedrale, në prani të besimtarëve, klerikëve dhe autoriteteve vendore. Në vijim delegacioni rus vizitoi qytetin. Më datën 30 maj 1951 delegacioni bëri një vizitë në komunitetin mysliman si dhe muzeun arkeologjik të kryeqytetit. Mresëlënëse ishte vizita që bënë më 31 maj në qytetin e Korçës. Një përfaqësi klerikësh dhe besimtarësh kishin dalë në Pogradec. Arkimandrit Dhimitër Kokoneshi kishte organizuar një pritje madhështore. Kortezhi i makinave sapo hyri në qytetin e Korçës u prit mes një entuziazmi të madh të besimtarëve, klerikëve dhe të autoriteteve vendore. Të pranishmit që morën fjalën në pritjen e organizuar me këtë rast folën përzemërsisht për miqësinë vëllazërore midis dy popujve. Pasdite u zhvillua dhoksologjia në kishën katedrale të Burimit Jetëdhënës, ku në emër të delegacionit rus foli peshkopi Nikon. Dhoksologjia u celebrua nën drejtimin e arkimandrit Dhimitër Kokoneshit dhe stavroforit Stavro Kanxheri me pjesëmarrjen e dhjetë priftërinjve dhe besimtarëve të shumtë. Më 1

¹³¹-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Dosja Nr. 4633, viti 1951, fl.1; Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 462, viti 1951, fl. 21.

¹³²-Sipas shkresës me Nr. Prot. 6/54, datë 29 maj 1950 në manastirin e Shën Vlashit qenë strehuar 17 murgesha ruse si dhe hieromonaku Germano Popov. Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 357, viti 1950, fl.7; Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 357, viti 1950, fl.15.

qershor 1951 delegacioni rus pati një takim me diktatorin Enver Hoxha në rezidencën e tij. Pasi pyeti për përshtypjet që kishin nga udhëtimi nëpër Shqipëri, Enveri u interesua për shëndetin e patrikut Aleksej dhe iu lut delegacionit që ti transmetojë atij urimet më të mira. Pasi përfundoi takimi me diktatorin Enver Hoxha, delegacioni rus i shoqëruar nga Kryepiskop Paisi, stavrofori Aristotel Strato dhe nga sekretari i Sinodit të Shenjtë, Niko Çane u nis për në portin e Durrësit ku i priste vapori “Çiaturi” me të cilin kishin ardhur nga Moska. Kryepiskop Paisi i dha rusëve një arkë të argjendtë, si dhuratë për Patrikun e Moskës, Aleksej¹³³.

KRIJIMI I SINODIT TË SHENJTË

Siç e kemi theksuar edhe më sipër më 25 gusht 1949 Paisi Vodica u shpall Kryepiskop i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Që të formonte Sinodin e Shenjtë të Kishës Autoqefale të Shqipërisë duheshin kandidatë të mundshëm potencialë që të plotësonin kriteret nga ana kanonike. Çështja e plotësimit të Sinodit të Shenjtë qe hapur që në Kongresin III të K.O.A.Sh-it, kur në sesionin e paradites së datës 8 shkurt 1950 delegati Siku Gjoka propozoi dorëzimin e arkimandritit Dhimitër Kokoneshi në gradën episkopale. Propozimi u prit me duartrokitje të zjarra nga ana e delegatëve, por Kokoneshi me modesti e refuzoi këtë propozim me arsyen se nuk i plotësonte kushtet për tu bërë episkop. Delegati i Gjirokastrës Niko Çane e miratoi refuzimin e Kokoneshit, ndërsa teologu Dhimitër Beduli theksoi faktin se në historinë kishtarë ka pasur raste, që klerikë të ndryshëm të ngrihen në gradën episkopale me imponimin e popullit, siç qe rasti i Ambrozit të Milanos¹³⁴.

Më 7 mars 1950, zëvendësepiskopi i Himarës, Jani Kutulla propozoi në emër të priftërinjve të zonës së Bregut kandidaturën e Foto Dunit. Më 17 tetor 1950 Sinodi i Shenjtë¹³⁵ i mbledhur nën kryesinë e Kryetarit të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Imzot Paisit, me anëtarët; arkimandrit Dhimitër Kokoneshi, Zëvendës i përgjithshëm e Episkopatës së Korçës dhe Ikonom Aristotel Straton, Zëvendës i përgjithshëm i Episkopatës së Gjirokastrës dhe me sekretar Z. Niko Çane vendoi unanimisht atë Spiro Velin¹³⁶ si titullar të Episkopatës së Beratit me cilësinë e

¹³³-Peshkopi Nikon, *Zhurnal Moskovskoj Patriarhij*, Nr. 9, shtator 1951; Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 462, viti 1951, fl. 26-30.

¹³⁴-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi nr. 536, Dosja Nr. 290, viti 1950; fl. 28-29; Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi nr. 536, Dosja Nr. 292, viti 1950, fl. 3.

¹³⁵-Me këtë përbërje Sinodi i Shenjtë ishte antikanonik. Sipas kanoneve kishtarë vetëm sinodi i përbërë nga tre episkopë kanonikë mund të propozonte kandidatë për episkopë edhe mund të dorëzonte episkopët e rinj.

¹³⁶-Spiro Veli (1914-1995) ka lindur më 1914, në Erind të Gjirokastrës. Që në moshën 18-vjeçare ka studiuar në seminarin Ortodoks “Apostol Pavli” në Tiranë, që drejtohej prej Vasarion Xhuvanit. Pas mbarimit të seminarit më 1936, banoi në qytetin e Durrësit, duke punuar mësues i fesë, njëkohësisht kryente edhe detyrën e psaltit në kishën e Shën Spioridhonit. Më 1 janar të vitit 1945 dorëzohet dhiak dhe më 3 janar të po atij viti, hirotoniset në gradën priftërore. Atë Spiro Veli shërbente në qytetin e Durrësit së bashku me Atë Erazmi Jorgon, duke lënë mbresat më të mira për urtësimë, ndershmërinë

zëvendësit episkopal¹³⁷. Gjithashtu atë Spiro Velit dhe atë Aristotel Stratos iu dha grada e nderit Ikonom-Stavrofor.

Pas shumë përpjekjesh dhe negociatash u hartua lista me kandidatët për episkopë: Arkimandrit Dhimitër Kokoneshi, Mitropolit i Gjirokastrës, Qirjako Efthimi (Naslazi), Mitropolit i Beratit, Foto Duni, Mitropolit i Korçës dhe Imzot Sofron Borova¹³⁸ ndihmës episkop. Miratimi i qeverisë për hirotonisjen e klerikëve në gradën episkopale u bë më 8 nëntor 1952. Problem i madh ishte se kush do të dorëzonte kandidatët për episkopë. Qe menduar se episkopët e rinj do ti dorëzonte Paisi dhe Irineu, por ky i fundit nuk pranoi në asnjë mënyrë të bënte veprime antikanonike. Sipas kanoneve kishtarë zgjedhja e episkopëve mund të bëhej nga një sinod i përbërë të paktën nga tre episkopë.

Në lidhje me dorëzimin e episkopëve të rinj Irine Banushi ka deklaruar: “Rruga e daljes ishte që më parë t’ja parashtronim udhëheqjes dhe nëse kjo dëshironte, Paisi dhe Irineu të shkonin në Moskë dhe aty të parashtronin situatën dhe të legalizohej Irineu (sepse ishte shkarkuar nga grada episkopale). Në vijim të mbledhjes sinodi kanonik i përbërë nga Paisi, Kristofori dhe Irineu, ku Paisi të ishte kryepiskop, ndërsa Kristofori dhe Irineu episkopë të ndonjë dioqeze. Vetëm sinodi i përbërë nga tre episkopë kanonikë mund të propozonte kandidatë për episkopë edhe mund të dorëzonte episkopët e rinj. Pasi të dorëzoheshin episkopët, Kristofori dhe Irineu do të jepnin dhorëheqjen. Irineu do ti parashtronte Sinodit dorëheqjen për shkak të sëmundjes, ndërsa Kristofori për shkak pleqërie. Kështu do të ishin brenda kanoneve dhe rregullave që përcakton neni 22 i statutit të vitit 1929, i cili thotë: “*Kryepeshkopi, Peshkopët dhe Ikonomi i Madh Mitrofor, për shkak sëmundjeje*

dhe profesionalizmin e tij. Në vitin 1948 së bashku me arqimandrit Dhimitër Kokoneshin morri pjesë në delegacion kishtar nga Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, në Bullgari e Rumani. Në vitin 1950 emërohet zëvendësi i përgjithshëm i Episkopatës së Beratit. Duke parë punën e tij të mirë organizative, më 1953 emërohet Zëvendës i përgjithshëm në Mitropolinë e Elbasanit. Gjatë viteve të diktaturës punoi në punë të ndryshme shekulare si shitës kinkalerie, shitës tullash apo roje. Në vitin 1991, rihapja e kishës së Shën Marisë në Elbasan e gëzoi pa masë. Ndonëse në moshën 81-vjeçare, Atë Spiro Veli punoi me përkushtim dhe devotshmëri deri sa vdiq më 23 prill 1995, në ditën e Pashkës së Madhe. At Stavri Çipi, *At Spiro Veli, shembull i një kleriku të devotshëm*, Ngjallja, qershor 2005, faqe 9; Andrea Lluknaji, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 263-264; Andrea Lluknaji, *Krishtërimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012, faqe 162-163.

¹³⁷-Atë Spiro Veli do të qe me cilësinë e zëvendësit episkopal të Përgjithshëm me të drejtat që i jepte eni 85 i Statutit: “Në mungesë episkopësh titullarë, në krye të një dioqeze mund të zgjidhet në të njëjtën mënyrë një klerik i dalluar me titull: “Zëvendës Episkopal i Përgjithshëm”, i cili porsa kohë që administron dioqezën vakante, ka po ato të drejta që ka edhe një episkop titullar, si edhe të njëjtën të drejtë anëtarësie në Sinodh, me përjashtim të atyre kompetencave që i përkasin ekskluzivisht gradës episkopate. Edhe ky jep të njëjtin betim përpara Sinodhit të Shenjtë”. Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi nr. 536, Dosja Nr. 293, viti 1950, fl. 13.

¹³⁸-Sofron Borova ka lindur në Borovë të Kolonjës më 1881. Në moshë të re shkoi në Athos ku u qeth murg. Pasi u kthye në atdhe ka shërbyer si klerik në rrethin e Korçës. Sofron Borova shihej me sy të mirë nga regjimi për shkakun se gjatë viteve të Luftës Antifashiste Nacional-çlirimtare nga familja e tij qenë gjashtë dëshmorë. Kriteri matës që përcaktonte qëndrimin e mirë politik në atë kohë ishte angazhimi personal ose familjar në lëvizjen nacional-çlirimtare. Në tetor 1952 u dorëzua në gradën episkopale, detyrë të cilën e kreu deri më 3 gusht 1963 kur edhe vdiq. Kristofor Beduli, *At Marko Papajani dhe shënimet e tij*, Neraida, Tiranë 2004, faqe 40-41.

kronike ose pleqërie, të cilat nuk u përmetojnë të përmbushin detyrat e tyre Peshkopale, kanë të drejtë t'i paraqisin kanonikisht dhe me të shkruar dorëheqjen e tyre Sinodhit, i cili vendos....”¹³⁹.

Kreu i Komitetit Klerik, Gaqo Peristeri dhe Niko Çane shkuan në manastirin e Shën Vlashit për të bindur Irineun, që të merrte pjesë në dorëzimin e episkopëve. Irine Banushi nuk pranoi. Ai kundërshtoi hapur shkeljet dogmatike dhe kanonike që po bëheshin në atë kohë nga njerëz të pashkolluar, të cilët kishin zënë poste drejtuese në kishë vetëm se kishin luftuar gjatë Luftës Antifashiste Nacional-çlirimtare. Irineu nuk pranoi të merrte pjesë në dorëzimin episkopëve të rinj, të cilët më parë kishin qenë priftërinj të martuar. Pasi kishin mbetur të ve ata kërkonin të ngjisnin shkallët më të larta të hierarkisë kishtare duke shkelur kanonet e shenjta. Ky ishte shkak që Irine Banushi u burgos përsëri në vitin 1952.

Në këto kushte alternativa e vetme ishte Kristofor Kisi. Në fund të gushtit 1952, Kisi pranoi të merrte pjesë bashkë me Vodicën në dorëzimin e episkopëve, duke kërkuar si shkëmbim rehabilitimin e tij. Më 14 shtator 1952 në kishën e Ungjillëzimit në Tiranë u dorëzua episkop i Gjirokastrës Dhimitër Kokoneshi, i cili mori emrin Damiano¹⁴⁰. Dorëzimi u bë nga episkopët Paisi dhe Kristofor. Më 21 shtator 1952 Sofron Borova u dorëzua episkop ndihmës prej episkopëve Paisi, Kristofor dhe Damiano. Më 28 shtator 1952 në katedralen Burimi Jetëdhënës në Korçë u hirotonis Foto Duni, i cili mori emrin Filothe, ndërsa më 12 tetor 1952 në katedralen e Shën Dhimitrit në Berat u hirotonis Qirjako Naslazi, i cili mori emrin Qirill¹⁴¹. Ky ishte Sinodi i Shenjtë i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. (Fig.12)

VDEKJA E DYSHIMTË E KRISTOFOR KISIT

Më 17 qershor 1958 Kristofor Kisi vdiq në rrethana të dyshimta në kishën e Shën Prokopit. Varrimi i Kristofor Kisit u bë më datën 18 qershor 1958. Arkivoli që mbante trupin e tij u vendos në mesin e kishës katedrale të “Ungjillëzimit” në Tiranë. Ceremonia e përmortshme u kryesua nga Fortlumturia e tij, Paisi, me pjesëmarrjen e Episkopit Ndhmës Sofronit, Arkimandrit Dhanil Çulit, Stavrofor Thoma Popës, Ikonom Marko Papajanit, Saqellar Petro Doçit, Kryedhjakonit Sotir Kanxheri etj. Në prani të të afërmve dhe besimtarëve të shumtë që kishin mbushur kishën, foli Sekretari i Sinodit të Shenjtë, Niko Çane, i cili theksoi virtytet e të ndjerit¹⁴².

Episkopi ndihmës, Sofron Borova vdiq në vitin 1963 në moshën 82-vjeçare dhe vendin e Episkopit të Apolonisë e zuri Dhanil Çuli. Me vdekjen e Mitropolitit të

¹³⁹-Kristofor Beduli, *Episkop Irine Banushi martir i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 2000, faqe 39.

¹⁴⁰-Kristofor Beduli, *At Marko Papajani dhe shënimet e tij*, Neraida, Tiranë 2004, faqe 31.

¹⁴¹-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi nr. 536, Dosja Nr. 476, viti 1950, fl. 44-54.

¹⁴²-Kristofor Beduli, *At Marko Papajani dhe shënimet e tij*, Tiranë 2004, faqe 37-38.

Korçës, Filotheut, vendin e tij e zuri Qirilli. Në vendin e Qirillit si Mitropolit i Beratit më 27 janar të vitit 1965 u dorëzua Spiridhon Papa¹⁴³. Kryeepiskop Paisi në vitet e fundit të jetës së tij ka qenë i sëmurë dhe administrimi i K.O.A.Sh-it bëhej prej episkopit ndihmës Dhanil Çulit. Paisi Vodica ndërroi jetë më 4 mars të vitit 1966 pas një hemoragjie cerebrale. Kryesia e Kishës me anën e një njoftimi të posaçëm¹⁴⁴, i cili mban datën 4 mars 1966 njoftonte vdekjen e Fortlumturisë së Tij, Paisit. Njoftimi është nënshkruar nga Episkop Damjan Kokoneshi, Episkop Spiridhon Papa, Episkop Dhanil Çuli, Niko Çane, Jorgji Pano, Ikonom Andrea Prifti, Ikonom Grigor Zografi etj. Ceremonia e varrimit u bë në 5 mars 1966 në Kishën Katedrale të “Ungjillëzimit” në Tiranë¹⁴⁵.

Sinodi i Shenjtë i K.O.A.Sh-it në mbledhjen e datës 7 mars 1966 zgjodhi unanimisht në postin vakant të kryeepiskopit, Episkopin e Gjirokastrës, Hirësinë e Tij, Damianin. (Fig.13) Me anën e Qarkores me numër 24/11, datë 14 mars 1966 njoftoheshin episkopatat e hirëshme dhe zëvendësitë mitropolitane në lidhje me vendimin e Sinodit të Shenjtë të datës 7 mars 1966, ku u zgjodh me vota unanime në postin e Kryeepiskopit të Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë, Hirësia e Tij, Damiani. (Fig.14) Gjithashtu Fortlumturia e Tij, Damiani do të mbante përkohësisht drejtimin e Mitropolisë së Gjirokastrës si *Ad interim*. Titullarët e Episkopatave të Hirëshme u porositen që gjatë celebrimit të shërbesave fetare të përmendnin emrin e Kryeepiskopit të sapofronëzuar. Qarkorja mbante firmën e Episkopit Ndihmës Dhanilit¹⁴⁶.

Pas zhvillimeve të mësipërme sinodi i ri përbëhej nga Fortlumturia e Tij, Damjani¹⁴⁷, në postin e Kryeepiskopit të Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë, Imzot Qirilli, Mitropolit i Korçës, Imzot Spiridhon Papa, Mitropolit i Beratit dhe Episkopi i Apolonisë, Dhanil Çuli si ndihmës i Kryeepiskopit.

¹⁴³-Spiro Papa ka lindur më 1885 në Sinjë të Beratit. Në vitin 1934 u dorëzua prift. Për 33 vjet ka shërbyer si famullitar i fshatit Paftal të Beratit. Pas disa viteve mbeti i ve dhe më 1965 u hirotonis Mitropolit i Beratit. Familja e tij ka qenë e lidhur me regjimin. Spiro Papa ka qenë babai i kryetarit të Komitetit Ekzekutiv të Beratit. Imzot Spiro Papa ka vdekur në vitin 1970. Ikonom Vangjel Xoxe, Ilia Zaka, *Spiro Theodor Papa*, Ngjallja, dhjetor 1999, faqe 9-10; *Ata që punuan për kishën tonë. Imzot Spiro Papa*, Ngjallja, korrik 2008, faqe 11.

¹⁴⁴-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja nr. 1333, viti 1966, fl.5.

¹⁴⁵-Kristofor Beduli, *Dhimitër Beduli bir i zgjedhur dhe i përkushtuar i kishës sonë*, Ngjallja, Tiranë 2015, faqe 77.

¹⁴⁶-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1334, Viti 1966, fl.1.

¹⁴⁷-Dhimitër Kokoneshi ka lindur më 26 tetor të vitit 1886 në fshatin Llëngë të Pogradecit. Në vitin 1925 Dhimitër Kokoneshi ka përfunduar Seminarin në Janinë të Greqisë. Në vitin 1927 Dhimitër Kokoneshi u dorëzua prift nga Kryeepiskop Visarion Xhuvani. Atë Dhimitër Kokoneshin e emëruan në kishën e Shën Marenës në manastirin e Llëngës. Më 31 korrik të vitit 1927 atë Dhimitër Kokoneshi ka celebruar meshën e parë në kishën e Shën Marenës. Me fjetjen e bashkëshortes në vitin 1939 atë Dhimitër Kokoneshi mori ofiqin e arkimandritit. Ndërkohë mori emrin Damjan. Në tetor të vitit 1947 arkimandrit Damjan Kokoneshi u dorëzua në gradën episkopale prej Hirësisë së Tij, Paisit dhe Hirësisë së Tij, Kristoforit dhe u emërua Mitropolit i Gjirokastrës. Më 7 mars 1966 Damjan Kokoneshi u fronëzua Kryeepiskop i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Dhimitër Kokoneshi vdiq më 18 tetor të vitit 1973 kur ishte në moshën 87-vjeçare. Pilo Peristeri, *Vdiq Dhimitër Kokoneshi*, Bashkimi, 19 tetor 1973, faqe 2; Kristofor Beduli, *Dhimitër Beduli bir i zgjedhur dhe i përkushtuar i kishës sonë*, Ngjallja, Tiranë 2015, faqe 78.

KREU I TRETË

TOMI PATRIKAL DHE SINODIK MBI BEKIMIN E AUTOQEFALISË SË KISHËS ORTODOKSE NË SHQIPËRI

VENIAMINI, me mëshirë të Perëndisë,
Kryepiskop i Konstandinopojës, Romës së Re dhe Patrik Ekumenik
Nr. 609 prot.

Kisha e Shenjtë e Krishtit, si një nënë e dhembshur, duke shfaqur hapur përkujdesjen dhe interesimin saj të pandërprerë kundrejt popullit të shpresëtarëve, nuk rresht së zbatuari detyrën e kujdesimit të shenjtë çdo herë me mënyrën e përshtatshme sipas kohës dhe vendit. Kur është e nevojshme, blaton dhuratat e saj më të begata për plotësimin e nevojave që dalin, në mënyrë që adminstrimi i punëve kishtarë të bëhet për ta pa pengesa dhe frytshmëria më Zotin, e cila është padyshim qëllimi i kujdesimit dhe i drejtimit kishtar, të jetë më e madhe. Kështu pra edhe tani, meqenëse të krishterët shpresëtarë orthodhoksë të të bekuarit prej Perëndisë Shtet të ri Shqiptar iu drejtuan Fronit tonë të Shenjtë Apostolik Patrikanor dhe Ekumenik, nën strehën e fuqishme të të cilit, si trashëgimi e vyer, prej shekujsh kanë gjetur mbrojtje e, me hirin e Krishtit, në vreshtin e Tij kanë gjetur shpëtim, morën guximin t'i drejtohen Atij, si një nënë të dhembshur, duke parashtruar nevojat e tyre të tanishme kishtarë, me urimin e ngrohtë dhe kërkesën që zona e tyre kishtarë të bekohet dhe të shpallet provincë kishtarë më vete, e pavarur, autoqefale, përderisa në kushtet e reja të situatës së atjeshme politike vetëm ky organizim mund të ndikojë për mirë në mbarëvajtjen dhe zhvillimin e punëve kishtarë dhe të jetë i mjaftë të sigurojë e të përçojë përparimin e pandërprerë të tyre në përparimin në tërësi të Shtetit të bekuar Shqiptar. Vetë Shteti i perëndimbrojtur Shqiptar, duke u kujdesur në mënyrë të besueshme për mbarëvajtjen pa pengesa e të lirë të nënshtetasve të vet, ka ofruar garanci për mëvetësinë dhe lirinë e plotë të Kishës Ortodokse, e cila gjendet brenda kufijve të tij. Prandaj dhe modestia jonë, së bashku me fort të nderuarit dhe të shenjtët Mitropolitë dhe fort të ndershmit bashkëmeshtarë dhe vëllezër më Shpirtin e Shenjtë, duke shqyrtuar me interesim plot dashuri kërkesën e tyre birësore dhe me udhërrëfyes dispozitat e kanoneve të shenjta dhe rendin e praktikën kishtarë, vendosëm të pranojmë me dashamirësi kërkesën që na drejtuan bijtë tanë shpirtërorë të Krishterë Orthodhoksë të Shqipërisë dhe të japim nga ana jonë bekimin dhe miratimin për organizimin e pavarur dhe autoqefal të punëve të tyre kishtarë.

Duke gjykuar pra edhe sinodikisht më Shpirtin e Shenjtë, urdhërojmë dhe shpallim në këto çaste të hareshme që të gjitha eparkitë dhe komunitetet orthodhokse që përfshihen në të perëndishpëtuarin Shtet Shqiptar të jenë këtej e tutje të bashkuara në një organizim të pavarur e autoqefal kishtar me emërtimin “Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë”. Kjo Kishë, e cila është motra jonë shpirtërore, të rregullojë

e të administrojë këtë e tutje çështjet e saj kishtare në mënyrë të pavarur e autoqefale sipas rendit dhe të drejtave sovrane edhe të Kishave të tjera Ortodokse Autoqefale, të ketë dhe të njohë si autoritet suprem administrativ kishtar Sinodin e Shenjtë, të përbërë prej Kryepiftërinjve ortodoksë kanonikë të Shqipërisë, me Kryetar të tij çdo herë Fort të Hirëshmin Kryepiskopin e Tiranës dhe të gjithë Shqipërisë. Për zbatimin e unitetit të shenjtë kanonik me Fronin tonë fort të Shenjtë Apostolik Patrikanor Ekumenik dhe me të gjitha Kishat Ortodokse Autoqefale, si dhe për ta dëshmuar këtë, Hirësia e Tij Kryepiskopi i çdoherëshëm i Tiranës dhe i gjithë Shqipërisë ka për detyrë që, sipas rendit të Kishës së Shenjtë Ortodokse, të njoftojë për zgjedhjen dhe hipjen e tij në fron nëpërmjet Letrave fronëzuese edhe Kishën tonë të Madhe të Krishtit, edhe të gjitha Kishat Ortodokse Autoqefale motra. Po ashtu duhet të bëjë për këtë qëllim homologjinë dhe premtimin e parashikuar në lidhje me zbatimin e padevijueshëm të besimit dhe shpresëtarisë ortodokse prej Kishës së Shenjtë që drejton dhe që i është besuar, dhe të gjithçkaje tjetër që Kanonet e Shenjta e Hyjnore dhe rendi i Kishës së Shenjtë Ortodokse urdhërojnë, si dhe të kujtojë sipas rendit në diptikë emrin e Patrikut Ekumenik dhe të Patrikëve të tjerë fort të shenjtë dhe të Kryetarëve Fort të Hirëshëm të Kishave të Shenjta Ortodokse Autoqefale. Urdhërojmë gjithashtu që edhe Kisha Ortodokse Autoqefale motër e Shqipërisë të marrë Miron e Shenjtë prej Kishës sonë të Madhe të Krishtit.

Po ashtu, rekomandojmë që, për çështje apo paqartësi të një natyre të përgjithshme kishtare, të cilat i kapërcejnë caqet e juridiksionit të Kishave Autoqefale në veçanti, Hirësia e Tij Kryepiskopi i Tiranës dhe i gjithë Shqipërisë t'i drejtohet Fronit tonë fort të Shenjtë Ekumenik, nëpërmjet të cilit realizohet kungimi me çdo Episkopatë të orthodhoksëve, shpjegues të drejtë të së vërtetës, duke kërkuar në këtë mënyrë mendimin dhe opinionin e vlefshëm të Kishave motra. Duke gjykuar pra në këtë mënyrë, gjë që pasqyrohet edhe në ato çka vendosëm dhe miratuam në mbledhjen e rregullt sinodike të 12 prillit të këtij viti, vërtetojmë për të gjitha kohët edhe nëpërmjet këtij Tomosi Patrikanor e Sinodik të shkruar e të nënshkruar në Kodikun e Kishës sonë të Madhe të Krishtit, i cili i është lëshuar dhe dërguar njëkohësisht me përmbajtje të njëjtë e të pandryshuar edhe Hirësisë së Tij, Kryepiskopit të Tiranës dhe gjithë Shqipërisë, vëllait tonë të dashur dhe bashkëmeshtarit, zotit Kristofor, Kryetar i Sinodit të Shenjtë të Kishës së Shenjtë Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë. Urojmë që Perëndia, me hirin dhe mëshirën e të parit dhe të Madhit Kryepift e Bariut Krisht, të mbështesë gjithmonë të themeluarën me sukses Kishë Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë dhe të shtojë e të përçojë drejt saj hirin dhe bekimin e Tij për lavdi të emrit të Tij të Shenjtë e në dobi të tërësisë shpresëtare të saj, si dhe në të njëjtën kohë për ngazëllimin e të gjitha Kishave të shenjta Autoqefale motra.

Në vitin shpëtimtar 1937, muaji prill (12), Epimenezi V.

Shprehet Patriku i Konstandinopojës

+VENIAMIN

+ Maksimi i Halkidhonës,

+ Polikarpi i Prusës,

+ Gjermanoi i Sardës dhe Pisidhisë,

- + Leoni i Theodorupolit,
- + Meleti i Kristupolit,
- + Gjermanoi i Enit,
- + Ioakimi i Dherkës,
- + Thomai i Pringjiponezit,
- + Genadi i Iliupolit,
- + Konstandini i Irinupolit,
- + Dhorotheu i Laodhikisë.

LETËRKËMBIMI NDËRMJET KRISTOFOR KISIT DHE AVOKAT VASIL DILOS

Këto shënime mbështeten në një bashkëbisedim, që pati bërë avokat Vasil K. Dilo dhe shkëmbimin e disa letrave, me Kryehirësinë e tij, ish Kryepiskopin e Shqipërisë, Imzot Kristofor Kissi, të sapodalë nga burgu (hetuesia). Kryehirësisë ju kërkua një informacion mbi zhvillimet në Kishën Ortodokse. Kryehirësia pati mirësinë t’i dërgojë avokatit një letër të gjatë më datë 30 dhjetor 1954.

“I Nderuar Zoti Dilo. Në letrën që më keni drejtuar bëni disa pyetje në lidhje me historinë e kishës sonë. Përgjigjen verbalisht ta dhashë në takimin që patëm në shtëpinë t’uaj. Por kur e këndova këto ditë për herë të dytë atëhetre, pashë se nga disa radhë të fundit rezultonte që Ju, këtë përgjigje e dashkeni, jo vetëm verbalisht por edhe me shkresë. Konform me këtë dëshirë që keni shfaqur, me kënaqësi po rrjeshtojmë këtu poshtë disa shënime, nga ato që mbajmë mend, prej ngjarjeve në Kishën tonë, gjatë tridhjetë e ca vjetëve të fundit sipas radhës së tyre kronologjike.

Më 1921 u mbloth në Berat i pari kongres kishtar, në kryesinë e At Josif Qyranës ku morën pjesë përfaqësues të katër dioqezave. Unë nuk u ndodha në këtë kongres, mbasi nuk kisha ardhur ende nga Stambolli. Më vonë kërkova po nuk gjeta dot asnjë proces-verbal mbi punimet e kongresit. Por nga disa përfaqësues mora vesh se kongresi mori mbi këto vendime.

1-Shpalli *de facto* autoqefalinë, domethënë pavarësinë e Kishës s’onë.

2-Përpilloi një Rregullore Administrimi.

3-Emëroi një këshillë provizore, që titullohej “Këshilli i Naltë i Kishës Orthodokse Autoqefale të Shqipërisë, i cili kryesohesh nga At Vasil Marku, me anëtarë: Dhosi Havjarin për dioqezën e Korçës; Simon Shuteriqin për dioqezën e Durrësit – Tiranës, Tol Arapin për dioqezën e Beratit dhe Stath Kondin për dioqezën e Gjirokastrës. Këshillit në fjalë i ngarkohej administrimi i kishës deri sa të formohej Sinodhi.

Kongresi çfaqti dëshirën që të bëheshin përçapje pranë Patriarkanës Ekumenike të Kostandinopojës me qëllim që Autoqefalia e vendosur *de facto* prej

kongresit të njëjeh dhe de jure nga Patriarkna, sikurse kanë vepruar edhe kishat e tjera Orthodhokse, që dikur qenë në juridiksionin e saj. Si qendrer e përkohëshme e Kryesisë së Kishës u caktua Korça, ku këshilli në fjalë mbante mbledhjet në datat e caktuara nga Rregullorja.

Pak kohe pas mbajtjes së Kongresit të Beratit, Patriarkana Ekumenike dërgoi në Korçë një delegat të saj, peshkopin Jerothe, i cili u vendos në Mitropolinë e Korçës. Më 1922, sipas dëshirës së shfaqur nga Kongresi, qeveria emëroi një delegacion dhe e autorizoi, që të shkonte në Stamboll për të kërkuar nga Patriarkana Ekumenike aktin e njohjes së autoqefalisë së vendosur nga Kongresi i Beratit. Delegacioni kryesohej nga At Vasili Marku me anetarë: At Harallamb Tarkën, Dhosi Havjarin, Kristaq Kirkën, Thoma Orollogajn etj. Patrik Ekumenik në atë kohë la qenë Meletios Metaksaqi. Delegacioni vizitoi disa herë Patrikun dhe i parashtrioi kërkesën e kishës sonë, por nuk mori ndonjë përgjigje të qartë. Patriku premtoi se Sinodhi do ti marrë këto çështje në studim. Kështu delegacioni u kthye pa mbaruar punë. Para se të largohej nga Stambolli, delegacioni erdhi në kontakt me të nënshkruarin (d.m.th. me peshkop Kristofor Kissin), i cili në atë kohë ishte peshkop në Makriqoj të Kostandinopojës dhe më propozoi, që të kthehesha në atdhe dhe të bashkohesha me Kishën Autoqefale. E pranova këtë propozim dhe sipas rregullave kishtarë, kërkoja nga Patriarkata lejen për t'u kthyer në atdhe. Por leja mu refuzua, duke më thënë se një i dërguar patriarkal ishte në Korçë edhe se nuk ishte nevoja që të vinte atje një peshkop tjetër para se të formohej Sinodhi i rregullt. Pa marrë parasysh këtë u nisa për në Korçë, një muaj pas largimit të delegacionit.

Në këtë kohë kishte ardhur nga Amerika i përndershmi Fan Noli, i cili me anë të këshillit na u drejtua ne, dy peshkopëve dhe na parashtrioi lutjen, që të dorëzohej peshkop. I nënshkruari (d.m.th. Peshkop Kristofor Kissi), duke marrë parasysh shërbimet, që i kishte bërë Fan Noli kishës, duke përkthyer shqip pjesën më të madhe të librave kishtarë, u deklarova në favor të këtij dorëzimi, ndërsa peshkopi Jerothe ishte kundër. Dorëzimi u krye me solemnitet të madh në Kishën e Shën Gjergjit të Korçës, në prani të gjithë autoriteteve.

Flitet se Fan Noli, para se të dorëzohej, kishte meshuar në Amerikë me këtë cilësi. Kjo nuk është e vërtetë. Ka të ngjarë që të ketë meshuar në Amerikë, duke mbajtur mitër. Ky zakon ekziston dhe në Kishën Ruse, ku disa priftërinjve, që kanë ofruar shërbime të mbedha u jepet e drejta që të mbajnë mitër. Në delegacionin që disa vjet më parë vizitoi vendin tonë nën kryesinë e peshkopit Nestor, merrte pjesë dhe një prift mitrofor, që mbante mitër në meshë. Kështu ka qenë ndër ne edhe At Vasil Marku, të cilit Kongresi i Korçës ia akordoi këtë të drejtë. Natyrisht këtu Fan Noli nuk meshoi kurrë me cilësinë e peshkopit, ose si prift me mitër para se të merrte këtë gradë regullisht pas dorëzimit.

Pas këtij dorëzimi Jerotheu u emërua Mitropolit i Korçës, që ishte atëherë qendra e kishës, Fan Noli, Mitropolit i Durrësit me qendër në Durrës dhe i nënshkruari (d.m.th. Peshkop Kristofor Kissi) Mitropolit i Beratit. Duhet të shënohet se në këtë kohë të gjithë titullarët mbanin, sipas zakonit të vjetër titullin Mitropolitit, ndërsa pas Kongresit të Korçës, ky titull iu rezervua vetëm Kryetarit të Kishës. Pas

një kryengritje, që plasi atëhere, kryetarët e lëvizjes u larguan nga Shqipëria si edhe Fan Noli, i cili u kthye në Amerikë.

Ndërkohë Patriarkata Ekumenike e Stambollit dërgoi një të dërguar të posaçëm, ish Mitropolin e Trapezundës Hrisanthin, për të biseduar me qeverinë tonë mbi çështjen kishtarë. Delegati në fjalë vizitoi qendrat e diqezave ku u prit me nderime të mëdha. Në Tiranë u emërua një komision nën kryesinë e Pandelit Evangjelit me anëtar Mihal Kason, Pilo Papën etj., për të biseduar me Hrisanthin. Pas një kohe delegati i mësipërm i paraqiti komisioni një memorandum. Nuk kam dijeni të saktë çfarë përmbante ky memorandum, por sipas informatave që mora, memorandumit përmbante disa kushte, të cilat nuk u pranuan nga qeveria e atëhershme. Kështu ardhja e këtij përfaqësuesi nuk përfundoi në asgjë. Megjithatë negociatat nuk u ndërpre, por ato vazhduan dhe pas largimit të të dërguarit patriarkal nga Shqipëria dhe kryeshin me anën e përfaqësuesve diplomatikë deri në vitin 1936.

Meqenëse u insistua që ishte nevojë, mbasi aktet duhej të nënshkruheshin prej meje si zëvendës i Kryesisë së Kishës, më në fund pranova dhe së bashku me Josif Kedhin, si anëtar, u nisëm për në Stamboll në fillim të vitit 1937. Më parë qëndruam dy muaj në Athinë ku e kishte selinë përfaqësuesi patriarkal ish Mitropolit i Trapezundës. Këtu Hrisanthi i rifilloi bisedimet dhe formulloi disa kërkesa, që ishin të papajtueshme me autoqefalinë e plotë. I nënshkruari u përgjigja se nuk ishim të autorizuar për të hyrë në bisedime po vetëm për të marë aktin e Tomit. Më në fund, duke parë sepse çështja po zgjatej, deklarova se do të detyrohesh të kthehesha në Tiranë, nëqoftëse çështja nuk do të merte fund me njohjen e plotë të Autoqefalisë në një shkallë me kishat e tjera orthodoxe dhe pa ndonjë kusht tjetër përveç atyre, që u pranuan nga qeveria jonë. Me këtë rast kërkoja edhe problemin e pushimeve, që ishin bërë nga Sinodhi i Patriarkanës ndaj disa klerikëve të kishës sonë të sipërshënuar, kërkesë e cila u pranua.

Pas kësaj morëm një shkresë nga delegati dhe shkuam në Kostandinopojë, ku u pritëm me nderime të mëdha. Bisedime të tjera këtu nuk u bënë përveçse vendimit të Sinodhit Patriarkal për heqjen e çgradimeve të klerikëve tanë sipas kërkesës, që kishim bërë. Pastaj u kryen ceremonitë, që bëhen zakonisht në raste të tilla. Pasi bëmë falënderimet dhe morëm Tomin të nënshkruar nga i gjithë Sinodhi Patriarkal, u kthyem në Tiranë, ku u pritëm gjithashtu me nderime. Tekstin e “Tomit” e përkthyem në shqip dhe dërguam nga një kopje në të gjitha kishat dhe manastiret e dioqezave tona.

Njikohësisht u mlodh Sinodhi, i cili vendosi emërimet e Titullarëve: I nënshkruari u emërua Kryepikop i gjithë Shqipërisë dhe Kryetar i Sinodhit me anëtarë: Evllogjio Kurrillën, peshkop i Korçës, Aganhangjel Çamçen, peshkop i Beratit, Pantelejmon Kotokon, peshkop i Gjirokastrës. Duhet të shtojmë këtu se të dy kandidatët i dorëzuan në Kostandinopojë, pa pjesëmarrjen e të nënshkruarit. Dy vjet më vonë Evllogjio Kurilla, me rastin e një udhëtimi që bëri në Athinë, botoi nëpër gazetat e këtij qyteti disa artikuj me anën e të cilëve bënte akuza të rënda kundra kishës sonë. Kur u morën vesh këto, u mblodh Sinodhi dhe procedoi në pushimin e

tij. Nga ana tjetër Pandelejmon Kotokoja, meqenëse gjatë luftës u largua nga Shqipëria pa ndonjë autorizim të kryesisë së Kishës, u pushua nga detyra.

Më 1946 Peshkopi i Shqiptarëve të Amerikës Fan Noli më dërgoi një letër, me anën e së cilës kërkonte që kisha në fjalë, të njihej si një pjesë e Kishës Autoqefale të Shqipërisë, sipas vendimit që kishte marë atje mbledhja e përgjithshme. Sapo mora letrën vizitova Minsitrin e Drejtësisë, Manol Konomin, dhe pasi i përshkrova çështjen i parashtrova edhe lutjet e mia personale për realizimin e kësaj kërkesë. Me këtë rast shtova dhe një kërkesë nga ana ime që të autorizohet Kryesia e Kishës për një fond, si shpërblim për Peshkopin e Amerikës, duke marrë parasysht punën që ka kryer, duke përkthyer shqip pjesën më të madhe të librave të shërbesave kishtarë.

Atë ditë, Ministri i Drejtësisë nuk më dha ndonjë përgjigje mbi objektin e kërkesës së Fan Nolit, por më tha se brenda pak ditëve do të ishte në gjendje që të më përgjigjej. Kujtoj se çështja duhej të bisedohej në këshill. Pas një jave vajta dhe një herë në Ministrinë e Drejtësisë, ku takova Ministrin dhe i kërkova përgjigjen. Ministri më tha se çështja e Kishës Shqiptare të Amerikës nuk mund të zgjidhet sot për sot, por do të mbetet për më vonë. Nuk dha ndonjë përgjigje dhe mbi kërkesën e dytë. Këtë përgjigje ia transmetova menjëherë Peshkopit të Amerikës, Fan Nolit dhe shtova dhe propozimin tim duke i shkruar: “Meqenëse përpjekjet e mia nuk patën asnjë sukses, mendimi im është që Ju personalisht t’i drejtoheni qeverisë sonë Demokratike telegrafisht, pasi letrat këtu mbërrijnë me vonesë.”

Një muaj më vonë mora nga Fan Noli një telegram me përmbajtjen: “Në bazë të këshillave tuaja iu drejtova sot drejtpërdrejt qeverisë”. Këtë telegram nuk e gjeta dot, ka të ngjarë që të ketë mbetur në arkivin e Kryesisë së Kishës. Mund të gjendet gjithashtu dhe në zyrat Post-Telegrafës. Se si përfunduan këto demarshe nuk kam dijeni. Nuk ka dyshim se këto të gjitha i mban mend ish ministri i Drejtësisë, Manol Konomi.

KRISTOFOR KISI NË PANAIRIN E SHËN GJON VLADIMIT

Të kremten e shenjtit, më 4 qershor, në manastir bëhej panair i madh. Prandaj thirrej paria e disa qyteteve e u bëhej një pritje madhështore. Sipas studiuesit gjerman Hahn, panairi zgjaste tri ditë. Pelegrinëve u jepej bukë, ullinj dhe djathë. Ata hidhnin të holla aq sa e kishin menduar. Paratë i mblidhte kujdestari i manastirit. Në panairin që bëhej në manastirin e Gjon Vladimit, kujdestaria e parë i takonte Durrësit, e dyta Kavajës dhe e treta Tiranës¹⁴⁸. Ndërmjet të tjerave, aty bëhej edhe pazari i shitjes së gjedhit. Pelegrinët nga Tirana, Durrësi, Dibra, Korça, Berati, Struga, Ohri dhe Manastiri vinin një ditë më parë, pra që më 3 qershor. Kishte njerëz me probleme shëndetësore, që flinin natën në kishë, duke iu lutur shenjtit të bënte mrekullinë. Gratë vinin rroba të ndryshme pranë arkës së shenjtit, ndërsa burrat fërkonin qeleshet dhe

¹⁴⁸-Johan Georg von Hahn, *Studime shqiptare, Instituti i Dialogut dhe Komunikimit*, Tiranë, 2007, faqe 233.

festet tek arka e shenjtit¹⁴⁹. Të tjerë këndonin në oborrin e kishës, ndërsa tregtarët ambulante u shërbenin pelegrinëve me produkte ushqimore. Pas liturgjisë hyjnore zhvillohej ceremonia e rrotullimit të lipsanit tri herë rreth kishës. Arka me lipsanet e shenjtit dilte nga dera jugore e kishës. Procesionin e paraprinin eksapterët dhe kryqi; pastaj vinin priftërinjtë që mbanin arkën me lipsanet e shenjtit; më pas vinte populli me qirinj të ndezur. Të gjithë me lutje, psalme dhe litani shoqëronin arkën me lipsanet e shenjtit. (Fig.1) Më pas, arka vendosej mbi një tavolinë përpara kishës dhe priftërinjtë shpërndanin pambukun që kishin lipsanet e shenjtit. Njerëzit prisnin në radhë dhe pasi puthnin arkën, merrnin pambukun dhe largoheshin me shprestari. Pambukun e vendosnin në djepet e fëmijëve për mbarësi, e mbanin me vete kur udhëtonin ose e mbanin në këndin e lutjes në shtëpi. Më pas, të gjithë të pranishmit drekonin së bashku. Kremtimet e panairit të vitit 1939 i ka drejtuar Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë, Imzot Kristofor Kisit. (Fig.2) Në këto kremtime mori pjesë edhe kori i kishës katedrale të “Ungjillëzimit” të Tiranës. Anëtarët e korit kanë qenë: Irini Gjoka, Anthulla Markidhi, Mariana Trebicka, Keti Cico, Gallata Kota, Tefta Kuqi, Enrieta Afezulli, Vasilika Murani, Zana Mata, Marika Simaku, Viollanda Xhometiku, Pandora Karakosta, Leni Dhama, Thanas Shkurti, Kristaq Tasho, Niko Zaharija, Themistokli Bimbli, Themistokli Jorgoni, Andrea Botka, Stavri Kondi, Nonda Rusi, Thoma Frashëri. Kori i kishës së “Ungjillëzimit” në Tiranë është krijuar nga Dhimitër Beduli¹⁵⁰. (Fig.3)

LABORATORI KIMIK I KISIT NË KISHËN E SHËN PROKOPIT

Projekti i kishës së Shën Prokopit në Tiranë u realizua nga ing. Skënder Luarasi. (Fig.4) Guri i themelit u vu më 6 prill 1940 nga Kryepiskopi Kristofor Kisi. Në murin e kishës ka qenë një pllakë e mermertë ku shkruhej: *Themelue në vitin 1940 në kohën e Kryepiskopit të Gjithë Shqipnis Imzot Kristoforit, me pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin e pleqësis kishtarë dhe të kujdestarisë së kishës së Tiranës, ndërtue me t’ardhunat e çpronësimit të kishës së vjetër të Shën Prokopit dhe me ndihmat e popullit orthodhoks, projektue dhe drejtue prej ing. Arch. Skënder Luarasit, zbatue prej sipërmarrjes Ing. Lucca e Co, Milano.*

Kisha e Shën Prokopit përfundoi së ndërtuari më 20 maj të vitit 1945. Kisha ka qenë e stilit bizantin e punuar me gurë të gdhendur deri në lartësinë dy metra dhe më pas muri vazhdonte me tulla. Kisha ishte 23,5 metra e gjatë dhe 18 metra e gjerë. DysHEMEJA e kishës ishte e shtruar me pllaka mermeri të bardhë. Ikonostasi gjithashtu ishte prej mermeri të bardhë dhe korniza fundore me mermer të zi. Ngjitur me kishën ishte shtëpia dykatëshe e famullitarit, e cila përbëhej nga katër dhoma dhe dy salla të

¹⁴⁹-Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi 138, dosja 16, fleta 16.

¹⁵⁰-Dhimitër Beduli, Vlash Dhora, Kostandin Mara, *Shënime për bashkësinë ortodokse të Tiranës*, Nereida, Tiranë 2007, faqe 24.

mëdha njera prej të cilave më vonë u kthye në laborator kimik¹⁵¹. Përrurimi i kishës u bë më 20 maj 1945 nga Kryeepiskopi Kristofor Kisi. Kujdestar dhe psalt në Kishën e Shën Prokopit ka qenë Vlash Semini¹⁵². Mihal Pjeshkazini ka qenë mësuesi i katekizmit për fëmijët. (Fig.5)

Në shënimet e tij atë Marko Papajani thotë se më 25 maj 1960 në kryesinë e kishës u zhvillua një mbledhje, në të cilën Kryeepiskop Paisi u komunikoi vendimin e qeverisë në lidhje me prishjen e kishës. *"...meqenëse në këtë vend tashti i thonë kodra e "Dëshmorëve të Kombit", vend në të cilin ndodhet edhe kisha, parashikohet që të bëhet një park i madh për kryeqytetin me liqenin artificial, kopshtin zoologjik, ambiente të tjera sportive dhe për dëfrime, hotele, bufera etj....me një fjalë kisha e "Shën Prokopit", nuk mund të qëndrojë më në atë vend, ku është ndërtuar dhe aq më tepër që do të bëhet më shumë vend dëfrimi dhe hareje, se sa vend faljeje, gjë kjo që e humbet kuptimin e adhurimit e faljes.... "* Më 20 tetor 1960 u hartua akti zyrtar i shpronësimit dhe menjëherë filloi zbrazja e kishës nga orenditë. Të gjitha objektet e shenjta, si ikonat, veshjet klerikale, disko-potirat, triqerët etj, u shpunë në kishën e "Ungjillëzimit të Hyjlindëses". Froni dhespotik gjithashtu u vendos në kishën e "Ungjillëzimit". Orenditë e tjera si tavolina, dollapë, karrige etj, u vendosën përkohësisht në dhomën e shërbyesit, ndërsa një pjesë orendive, duke përfshirë edhe ato të laboratorit kimik iu dhurua manastirit të "Shën Vlashit"¹⁵³.

¹⁵¹-Kryeepiskopi Kristofor Kisi ka qenë kimist. Ai bënte eksperimente kimike në laboratorin e tij. Këtë fakt e dëshmon miku i tij Dhimitër Sinjari dhe mbesa e tij, Liza Sastoli.

¹⁵²-Vlash Semini ka lindur në qytetin e Kavajës më 1906. Pas përfundimit të studimeve teologjike në Bukuresht, Vlasi u kthye në Tiranë, ku ka shërbyer si kujdestar dhe psalt në Kishën e Shën Prokopit. Vlash Semini ka botuar shumë artikuj teologjik në shtypin periodik të K.O.A.Sh-it. Vlasi vdiq më 1989. Kristofor Beduli, *Psaltët Vlash Nushi e Vlash Semini*, Ngjallja, gusht 1997, faqe 8.

¹⁵³-Kristofor Beduli, *At Marko Papajani dhe shënimet e tij*, Neraida, Tiranë 2004, faqe 55-60.

JETËSHKRIMI DHE AKOLLUTHIA

e dëshmorit të ri dhe isapostullit

SHËN KOZMA

kthyer nga greqishtja prej klerikut orthodhoks

KRISTOFOR KISI

Korçë, 1931

**NË MBRËMËSORE
PËRLESHORJA
TINGULLI IV**

Le ta kremtojmë Shën Kozman e përkujtuar, le ta lavdërojmë të gjithë o besnikë, yllin e Dëshmorëve, mburrjen e meshtarëve dhe të murgjëve, se si shok i apostujve dhe nërmjetar përpara Krishtit, u fal shërime të sëmurëve, që i afrohen me besë.

**LAVDI DHE TANI
TINGULLI II, EFRENESTHO**

Na shkëlqeve o Dëshmor me nam, o Shën Kozma si yll që lartazi, rojte mi dhenë si engjëll, çthurre ferrin besëlig, këtu pra sot po mblihdemi, dhe me lulet e këngëve, të mpleksim kurorë me të thirrura: O dëshmor i Shenjtë, dërgona hirin tënd dhe shpetoji besnikët prej gjithë helmeve.

**THIRRTORET
TINGULLI II, IKOS EFRATHA**

Ejani gjithë tok, me këngë ta lavdërojmë, Kozmanë që shkëlqeu, me fjalë dhe me vepra, dhe vdiq i varrur si Dëshmor.

Nxënës i Zotit Krisht, dhe shok i Apostujve, dhe mjek si anargjendët, dhe shembull për besënikët, fitoj kurorë si dëshmor.

Mblidhuni sot këtu, me lule ta stolisim, se na buron shërime, për shpirtet dhe për trupat, dëshmori Shën Kozma me nam.

**LAVDI
TINGULLI TËRTHOR II**

More kryqin mbi sup, Ungjillin e përhape, punove si Shën Pali, pra lutu pranë Krishtit, për ndjesën e besnikëve.

**TANI
HYJLINDËSORE**

Cili s'të lumëron tani, Shën Mari Virgjëreshë? Cili vallë nuk himnon lindjen tënde të shenjtë? Se Bir i Zotit Perëndi na ndriti i vetëmlinduri, se ay prej teje u mishërua, pa at'e pa shpjegim, si Perëndi që ishte, edhe na u bë njeri pa ndryshim përmbi dhe, dhe s'ish i ndarë aspak prej natyrave, i fortë prej të dyjave na u njoh i papërzieri. Atij pra lutu, o Zonjë Hyjlindëse, të na dhurojë hir të shpirtëve.

HYRJA

O DRITË GAZMORE

O Jesu Krisht, dritë gazmore e lavdisë së shenjtë të Atit të pavdekshëm qiellor, të shenjtë e të lumtur, si arritëm në perëndimin e diellit dhe pamë dritën e mbrëmjes, himnojmë, Atin, Birin dhe Shpirtin e Shenjtë, Perëndinë. Ti meriton në çdo kohë të himnosh me zëra të mbara o Bir i Perëndisë, që jep jetë; prandaj bota të lavdëron.

Paravargu i mbrëmjes dhe këndimet

PASVARGJET

TINGULLI TËRTHOR IV,

O TU PARADHOKSU

More forcë e hir që lartazi, si kryetrim shembullor, i bekuar prej Shpirtit Shenjt, i dërmove plotësisht, gjithë hordhitë e demonëve, ngrite tropera kundër barbarëve, ndrite me fjalë, besë dhe shpresë e mall; pra ndërmjeto për ne, që të kremtojmë besërisht kujtimin tënd, pranë Zotit Jesu Krisht, dhe shpirtet na shpëto.

Fjalën e lëçite plot me zell, dhe e lërove me mall, e vadite me shpresë e lot, dhe e mbolle me kujdes, nëpër zemrat e njerëzve; dhe mbolle lule, pemë edhe kallinj, plot me virtyte, dritë dhe dituri; pra ndërmjeto për ne, që të kremtojmë besërisht kujtimin tënd, pranë Zotit Jesu Krisht, dhe shpirtet na shpëto.

Ndrite dhe shkëlqeve me virtyt, Dëshmor i Shenjtë Kozma, asketi i virtyteve, shembull i besnikëve, dhe lëçitës i dogmave; dhe predikove një Perëndi dhe Zot, Trininë e Shenjtë, me dashuri dhe mall; pra ndërmjeto për ne, që të kremtojmë besërisht kujtimin tënd, pranë Zotit Jesu Krisht dhe shpirtet na shpëto.

LAVDI

Ne besnikët të nderojmë, o Shën Kozma o udhëheqës i lartë, se ti na mësove të baresim në udhën e drejtë. Lum ti që i shërbeve Krishtit, edhe i prure shumica prej besnikësh të mirëpritur, o shok i engjëjve dhe i apostujve, kurorë i Dëshmorëve dhe i Shenjtorëve, ndërmjeto me ata për shpëtimin e shpirtëve tona.

TANI

Priti Hyjlindëse, lutjet e shërbëtorëve, përkrahna dhe shpëtona prej rreziqeve dhe helmeve.

NË MËNGJESORE

Perëndia është Zoti dhe u shfaq ndër ne, i bekuar është ai që vjen në emrin e Zotit (katër herë).

Vargu I: Rrëfehuni te Zoti dhe thirrni emrin e tij të shenjtë.

Vargu II: Të gjithë kombet më rrethuan dhe me emrin e tij i mposhta.

Vargu III: Prej Zotit u bë kjo dhe është e çuditshme në sytë tanë.

NDENJËSORET TINGULLI I, TON TAFON SU

Me besën e Jesuit, si një shqyt dhe një armë, shkëlqeve me triumf, kundër gjithë armiqtë, me fjalë dhe me predikim, si me drapër prej korësi, preve pa pushim, çdo drizë prej pabesie, dhe përmyse krejt, intrigat e të ligut.

LAVDI DHE TANI

Si nënë të Jesuit, që të gjithë të njohim, o Zonjë Shën Mari, Virgjëreshë pas lindjes, përikim pra më ty me mall, si e mirë që je për ne, ty të kemi pra, ne mëkatarët si mbrojtje, prej rreziqeve, dhe shpëtimtare në ngasjet o Nënë Hyjlindëse.

TINGULLI TËRTHOR I TON SINANARKHON

Mbolle besën e mirë në mes të njerëzve, edhe kore me duaj kallinjt e drithëve, o Dëshmor i lavdëruar Shën Kozma, Krishtit ia shpure si një fli, një shumicë prej besnikësh mbi altarin e lartë që po mburren si Orthodoxë, me doktrinat e Shenjtorëve.

LAVDI DHE TANI

Virgjëreshë dhe nënë Mari Hyjlindëse, që hidhërimin e Evës e ktheve në gëzim, të himnojmë ne besnikët dhe të falemi, se na çlirove plotësisht, nga mallkimi prindëror o Zonj' e përmbibekuar; ndërmjeto pra për ne pa prerë që të shpëtojmë prej rreziqeve.

TINGULLI III EPEFANIS SIMERON

Kapërceve me lavdi, lumin e trubullt, kur në rrymën me tërbim, të hodhnë o Dëshmor me nam, dhe në Parajsën kalove drejt, edhe fitove, kurorën e engjëjve.

LAVDI DHE TANI

Virgjëreshë mbrojtëse për çdo nevojë, ndërmjeto për gjithë ne, që kemi shpresë tek ty, dhe na shpëto prej rreziqeve, o nënë e Krishtit, o ndihmë e besnikëve.

Meqenëse nuk ka Ungjill të Mëngjesit, këndohet menjëherë:

SHKURTORJA TINGULLI III, EPEFANIS SIMERON

Në Etolinë dritën pe, në Mal të Shenjtë, i thellove si një murg, gjithë misteret e Jesuit, dhe predikove me shpresë e mall, dhe derdhe gjakun si një apostull i tij.

SHTËPIA

Le ta nderojmë o besnikë, dhe le ta kurorëzojmë me lule Shën Kozmanë, bukurinë e dëshmorëve, mburrjen e murgjëve, predikuesin e besës, shembullin e priftërinjve, imituesin e mbaruar të apostujve, se bën çudira dhe na dhuron shërime. Le ta përshëndoshim pra, dhe le ti thërresim: gëzohu o ligjëronjës i besës, o kollonë e patundur e Kishës. Ruaje Kishën në paqe me ndërmjetime se ke kurajë përpara Shpëtimtarit, se derdhe gjakun si një apostull i tij..

SINAKSARI

Më 24 të muajit Gusht kujtojmë Shën Kozmanë, Atin tonë Oshënar, Hierodëshmor dhe Isapostull. Gjithë sot, kujtojmë Eftikun, Hierodëshmorin e Shenjtë, dishepullin e Shën Joan Teologut. Me ndërmjetimet e tyre o Krisht Perëndi mëshirona dhe shpëtona. Amin.

ZBRITËSORET TINGULLI TËRTHOR IV, STAVRON KHARAKSAS

Një kryq vijosi me shkop, Moisi Profeti dhe Deti i Kuq u ça më dysh, dhe Izraeli shkoj përtej; pastaj prapë e bashkoj, me një tjetër shkop dhe kryq, përsipër valëve dhe forcat edhe qeret, faraonit ia mbyti; pra Krishtin këndojmë si Perëndi dhe Zot, me brohori dhe gaz.

Shkopi një herë si një simbol i misterit na u shfaq, se filizat na treguan priftërinë, edhe për Kishën beronjë, ja ku mbiu edhe lulëzoj, Kryqi tani për forcë dhe për shigurim.

Kam dëgjuar o Zoti Krisht, si e rregullove këtë mister të madh kuptova veprimin tënd dhe të lavdërova Perëndia im.

O dru i lumur tri herë, përmbi të cilin u nde Mbret'i lartë Zoti Krisht, se prej teje u rrëzua djalli gjarpër, i gënjyer tmerësisht, prej Zotit të mbërthyer përmbi kryq, që u fal shpirtëve përdëllim dhe paqe gjithnjë.

Në barkun e bishës së detit, Profeti Shën Jona, duartë i zgjeroj në formë kryqi, dhe pësimin e Krishtit paratregonte kjarisht, pra i triditshëm jashtë u hodh dhe lajmën e përmbinatyrëshme e paralajmëroj, të Jesuit të mbërthyer mbi Kryqin për ne, që na e ndriti krijesën, me ngritjen prej varreve.

Urdhër të çmendur dha, tirani besëlig, e tundi popullin, botën e tmerroj, me blasfemi dhe paudhësi, po të Tre Djemat nuk i tronditi dot, tërbimi i egër, as furra me zjarr; dhe kur u fryri era vesëprurëse, këndonin brenda mu në zjarr; i përmbihyjnua je, Perëndi dhe Zot i Madh, për jetë i bekuar.

E bekonit Djema, si Trinia nga numëri Atin qiellor të vetmin Zot, himnoni Fjalën që mbi dhenë zbriti, dhe e bëri vesë zjarrin e furrave; dhe e lartësoi, dhe Shpirtin e Tërëshenjtë, që u dhuroj që të gjithëve jetën.

Në Madhështimet këndohen Troparet pasonjëse:

O Hyjlindëse Parajsë mistike je, se pa lërim lulëzove Zotin Krisht, që mbollti përmbi dhe jetëprurësin Kryq, që po lusim me besë, se ky po lartësohet, dhe me anën e tij, ty të madhështojmë sot.

Mallkim i vjetër i stërgjyshit, që rodhi nga farmaku i gjarpërit, u abolit me Kryqin e Zotit Krisht; bekimi erdhi për njerinë me Mari Hyjlindësen, që na lindi Jesunë çlironjësin; të gjitha pra fuqitë, e lavdërojmë në qiellin.

DËRGIMSORET

TNGULLI III, EPESKEPSATO

E mohove veten krejt, edhe e ngrite Kryqin tënd, dhe bëre shenja të mëdha, o Shën Kozma Dëshmor dhe Mjek, dhe predikove pa pushim, edhe në altar meshove, si prifti i Zotit Krisht.

Na linde o Hyjlindëse, Jesunë Krishtin Perëndi, që tërë botën e shpëtoi, nga ferri i demonëve; shpëtona nga sëmundjet pra, nga helmet dhe mëkatet, me lutjet e dhëmbshura.

LAVDËRIMET

TINGULLI I, TON URANION

Me predikime e mbolle besën e Zotit Krisht, me dritën e Trinisë, që përhape në botën, shpërndave errësirën o Shën Kozma, pranë asaj ndërmjeto për ne, që po kremtojmë me besë përunjesisht, dhe me bujë kujtimin tënd.

Lipsanin tënd çudibërës me mburrje po e mban, në gji të tij Berati, si thesar të paçmuar, që hir edhe çudi buron gjithnjë, për shërimin e trupave, dhe për shpëtimin e shpirtrave nga çdo vrer i armikut o Shën Kozma.

Dëfre Berat dhe gëzohu më besë e shpresë sot, se mban në gji thesarin e Dëshmorit të Shenjtë dhe mjekut anargjend Kozma që nderoj, kishën tonë me lavdërim, dhe na solli altarin si meshtar, dhe si mburrje e murgjëve.

LAVDI

TINGULLI II

Le ta lavdërojmë o vëllezër, isapostullin Kozma, zelltarin e Shën Palit, enës së zgjedhur dhe të parin e apostujve, se nuk ngjeroj as gjumë as prehje, gjersa ua përhapi Ungjillin të gjithëve; se i nxori zemrat e besnikëve, nga gremina e gënjeshtres, dhe u tregoi udhën e Perëndisë; se vaditi shpirtet e njerëzve dhe e përndau errësirën, me dritën e ëmbël të Trinisë. Me atë dritë ndriçona edhe ne o Shenjt dhe shpëtona nga leqet e armikut.

TANI

O Zonjë Shën Mari, që linde Perëndinë, Jesunë Shpëtimtarin, përkrahna dhe shpëtona, nga grackat e demonëve.

SHKURTORJA

TINGULLI IV, JOAKIM KE ANA

Joakimi dhe Ana që nuk kishin fëmijë, dhe Adami dhe Eva që ishin shtypur prej vdekjes, fituan gaz dhe liri me ty, kur linde o Hyjlindëse. Atë po kremtojmë ne besnikët, se tani u çliruam nga mëkati dhe themi: Beronja lindi Hyjlindësen dhe Nënë e Zotit.

DHOKSOLOGJIA

Lavdi Perëndisë që është në më të lartat dhe mbi dhenë paqe, dhe mbi njerëzit mirëdashje. Të himnojmë, të bekojmë, të falemi, të lavdërojmë, Ty të falenderojmë për lavdinë tënde të madhe. Zot mbret, Perëndi qiellor, Atë i tërëfuqishëm; Zot Bir i

vetëmlindur Jisu Krisht, edhe Shpirt i Shenjtë. Zot Perëndi, qengj i Perëndisë, Bir i Atit që ngre mëkatin e botës, mëshirona, Ti që ngre mëkatet e botës. Prano lutjen tonë, Ti që rri në të djathtë të Atit, edhe mëshirona. Se Ti je Shenjt i vetëm, Ti je Zot i vetëm, Jisu Krishti, për lavdi të Perëndisë Atit. Amin. Për mbrëmje do të të bekoj, dhe do të lavdëroj emrin tënd për jetë, e në jetë të jetës. O Zot u bëre streha jonë brez pas brezi, unë thashë: O Zot, mëshiromë, shëro shpirtin tim se fajtova tek Ti. O Zot, tek Ti gjeta strehë, mësomë të bëj dëshirën tënde se Ti je Perëndia im. Se pranë teje është burimi i jetës; me dritën tënde do të shohim dritë. Zgjate përdëllimin tënd mbi ata që të njohin. Bëna të denjë, o Zot, që të ruhemi këtë natë pa ndonjë mëkat. I bekuar je, o Zot, Perëndi i Etërvë tanë, dhe emri yt është i himnuar dhe i lavdëruar në jetët. Amin. Le të jetë, o Zot, përdëllimi yt mbi ne, sikurse kemi shpresuar tek Ti. I bekuar je, o Zot, mësomë porositë e tua. I bekuar je, o Zot, bëmë të mençëm në porositë e tua. I bekuar je, o i Shenjtë, ndriçomë me porositë e Tua. O Zot, mëshira jote është përjetë, mos i hiq sytë nga veprat e duarve të Tua. Ty të ka hije lëvdata, Ty të ka hije himni, Ty të ka hije lavdia, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

APOSTULLI

I drejti do të gëzohet me Zotin. Dëgjoma zërin o Perëndi.
Prej Letrës II së Palit për Timothënë.

Bir Timothe, forcohu me hirin e Jisu Krishtit, edhe ato që ke dëgjuar prej meje me shumë dëshirë ua dorëzo njerëzve besnikë, të cilët janë të zotët t'ua mësojnë edhe të tjerëve. Edhe duroji të këqijat si ushtar i mirë i Jesu Krishtit. Asnjë njeri, i cili vete ushtar nuk ngatërrohet në andrrallat e jetës, po përpiqet ti pëlqejë gjeneralit të vet. Dhe askush nuk e fiton kurorën e trimërisë veç nëqoftëse trimëron pas ligjës. Bujku, i cili mundohet ka të drejtë të marrë një pjesë të pemëve i pari. Kuptoji ato, që them edhe Zoti të dhëntë mend për të gjitha. Kujtoje Jesu Krishtin prej farës së Davidit, i cili u ngjall së vdekurësh pas Ungjillit tim, për të cilin vuaj të këqija gjer në burg si ndonjë keqbërës po falja e Perëndisë nuk lidhet me vargonj. Prandaj i duroj të gjitha për të zgjedhurit që të gjejnë edhe ata shpëtimin e Jisu Krishtit edhe lavdinë e pasosur.

UNGJILLI PAS JOANIT

Zoti u tha Dishepujve: Kjo është porosia ime, doni njëri-tjetrin. Nëqoftëse bota ju urren dijeni se mua më ka urreyer më parë se ju. Sikur të ishit prej botës, bota do tu deshte si të sajte, po meqenëse nuk jeni prej botës, nga e cila ju kam zgjedhur une, prandaj bota ju urren. Kujtojeni fjalën që ju thashë. Nuk ka shërbëtor më të madh se i Zoti. Ata që më kanë ndjekur mua do tu ndjekin edhe ju. Ata që kanë ruajtur fjalën time, do ta ruajnë edhe tuajën. Edhe këto të gjitha do t'ua bëjnë për emrin tim, se nuk e njohin atë, që më ka dërguar. Sikur të mos kisha ardhur dhe të mos u kisha folur,

nuk do të kishin mëkat. Po tani nuk kanë mëhanë për mëkatin e tyre. Ai që më urren mua, urren edhe tim Atë. Sikur të mos kisha bërë përpara tyre veprat, të cilat nuk i ka bërë asnjë tjetër, nuk do të kishin mëkat, po tani edhe i kanë parë veprat edhe më kanë urreyer edhe mua edhe tim Atë. Edhe kështu mbushen fjalët e shkruara në ligjën e atyre që më urreyen darovisht. Edhe kur të vijë Ngushëllimtari, Shpirti i së vërtetës, që dërgohet prej Atit, të cilin do t'ua dërgoj unë me anën e Atit, ai do të dëshmojë për mua. Po edhe ju dëshmoni se keni qenë me mua që në krye. Këto ua thashë që të mos skandalizoheni. Do tu nxjerrin jashtë sinagogave dhe vjen ora në të cilën ata që do tu vrasin do të mburren se i bënë një shërbim Perëndisë.

KUNGATORJA

I drejti do të kujtohet përjetë.

BURIME ARKIVORE

- Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi 647, Dosja nr. 206, fl. 1-2.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi 141, Dosja nr. 438, viti 1922.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 995, fl. 1-2.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1, viti 1945, fl. 1.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1, viti 1945, fl. 3-4.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1, viti 1945, fl. 5-6.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1, viti 1945, fl. 7-8.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1, viti 1945, fl. 18.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja nr. 1471, viti 1951, fl. 34-36.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Dosja nr. 1470, viti 1951, fl.3-4.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 20, viti 1945, fl. 42.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1, viti 1945.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 20, viti 1945, fl. 43.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 103, viti 1947, fl.2.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 151, viti 1947, fl.11.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 151, viti 1947, fl.32.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 217, viti 1948, fl. 23-24.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi 140, Dosja Nr. 60, fleta 51.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi Nr. 536, Dosja Nr. 232, fl.115.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 155, viti 1948, fl. 5.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 155, viti 1948, fl. 8.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 290, viti 1950, fl. 44-49.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja nr. 1470, viti 1951.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja nr. 1471, viti 1951
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Dosja Nr. 4633, viti 1951, fl.1.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 462, viti 1951, fl. 21.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 357, viti 1950, fl.7.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 357, viti 1950, fl.15.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 462, viti 1951, fl. 26-30.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi nr. 536, Dosja Nr. 290, viti 1950; fl. 28-29.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi nr. 536, Dosja Nr. 292, viti 1950, fl. 3.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi nr. 536, Dosja Nr. 293, viti 1950, fl. 13.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi nr. 536, Dosja Nr. 476, viti 1950, fl. 44-54.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja nr. 1333, viti 1966, fl.5.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1334, Viti 1966, fl.1.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi 138, dosja 16, fleta 16.
- Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Dosje formulare, Nr. 3328, faqe 16.
- Dekret-Ligjë mbi formimin e Komunitetet Fetare*, Korçë, 1929, në “Fletorja Zyrtare”, Nr. 38, 16 korrik 1929, faqe 1-3.
- Fletore Zyrtare, Nr. 49, datë 26.10.1922.
- Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Dhori Koti, Korçë 1923.
- Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Korçë, 1929, në “Fletorja Zyrtare”, Nr. 45, 14 gusht 1929.

BIBLIOGRAFI

- Andrea Llukani, *Ndihmesa e Theofan Popës për shpëtimin e mbishkrimeve dhe objekteve liturgjike kishtare*, (Monografi), Trifon Xhagjika, Tiranë 2019.
- Andrea Llukani, *Krishterimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2014.
- Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011.
- Andrea Llukani, *Kanonet dhe statutet e Kishës Ortodokse*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011.
- Andrea Llukani, *Si kusari thërres, komenti i liturgjisë hyjnore të Joan Gojartit*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2010.
- Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016.
- Apostolou Glavina, *H Orthodhoksi Aftoqefali Eklisia tis Alvanias*, Iperesia Dhimosievmaton, Thesaloniki 1998.
- Artan R. Hoxha, *Kisha Ortodokse nën komunizëm*, UETPRESS, Tiranë, 2017.
- Azem Qazimi, *Komunitetet fetare në Shqipërinë Komuniste*, Instituti i Studimeve të Krimeve dhe pasojave të Komunizmit, Tiranë 2014.
- Dhimitër Beduli, Vlash Dhora, Kostandin Mara, *Shënime për bashkësinë ortodokse të Tiranës*, Nereida, Tiranë 2007.
- Dhimitër Beduli, *Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë deri në vitin 1944*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë, 1992. -Dhimitër Beduli, *Kishë dhe kulturë*, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2006.
- Dhori Qiriazi, *Krishterimi në Shqipëri*, Argeta LMG, Tiranë 2000.
- Fan Noli, *Pesëdhjetore e Vogël*, Boston, Mass 1914.
- Fan S. Noli, *Vepra II*, Zgjedhur dhe përgatitur nga prof. Nasho Jorgaqi, Dudaj, Tiranë 2003.
- Foti Cici, *Midis shqiptarësisë dhe grekësisë*, Globus R, Tiranë 2006.
- Johan Georg von Hahn, *Studime shqiptare*, Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, Tiranë, 2007.
- Kaliopi Naska, *Shën Naumi dhe diplomacia e kohës*, Kristalina-KH, Tiranë 2012.
- Koço Tasi, *Shqiptarëvet të Krishten bashkëpunëtorë të Muhamendanëvet*, Athinë 1929.
- Kristofor Beduli, *At Marko Papajani dhe shënimet e tij*, Tiranë 2004.
- Kristofor Beduli, *Saqellar atë Petro Doçi*, Neraida, Tiranë 2006.
- Kristofor Beduli, *Shkollat teologjike-hieratike*, Neraida, Tiranë 2001.
- Kristofor Beduli, *Episkop Irine Banushi, martir i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Tiranë 2000.
- Kristofor Beduli, *Dhimitër Beduli bir i zgjedhur dhe i përkushtuar i kishës sonë*, Ngjallja, Tiranë 2015.
- Librë e Shërbesave të shënta të Kishës Orthodoxe*, kthyer nga gërqshtja prej priftit Orthodox Fan S. Noli, Boston Mass 1909.
- Mehmet Gëzhilli, *Fan S. Noli*, Argeta LMG, Tiranë 2003.
- Nos Xhuvani, Pavli Haxhillazi, *Na flet Visarion Xhuvani*, Tekno Paper, Tiranë 2008.
- Pëllumb Xhufi, *Shekulli i Voskopojës*, Toena, Tiranë 2010.
- Roberto Moroco della Roka, *Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920-1944*, Tiranë 1993.
- Tomor Aliko, *Genocidi mbi elitën intelektuale të kombit shqiptar nën terrorin komunist*, Maluka, Tiranë 2007.
- Tomor Aliko, *Genocide in the intellectual elite od the Albanian nation under the communist terror*, Maluka, Tirana 2007.
- Visarion Xhuvani, *Kujtim vepre dhe intrige*, shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926.
- Visarion Xhuvani, në kishë, në parlament dhe në burg*, Vepra, botimet 55, Tiranë 2007.
- Visarion Xhuvani, *Çashtje politiko-religjoze Kostandinopoli-Tiranë*, Pjesa I, shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926.
- Visarion Xhuvani, *Çashtje politiko-religjoze Kostandinopoli-Tiranë*, Pjesa II, shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926.
- Zoi Xoxa, *Kujtimet e një gazetari*, 55, Tiranë 2007.

ARTIKUJ

NË REVISTA SHKENCORE DHE GAZETA

- Alqi Jani, *Papapano Gjirokastra-figurë e shquar e kishës shqiptare, në 70-vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Akademia e shkencave, Tiranë 1993, faqe 88-92.
- Alqi Jani, *Të njohim dhe nderojmë klerikët e Kishës Ortodokse të Shqipërisë: Episkopi Eugjen Hoshteva*, Republika, 27 maj 2009, faqe 14-15.
- Andrea Llukani, *Ndihmesa e Theofan Popës për shpëtimin e mbishkrimeve dhe objekteve liturgjike kishtarë*, (monografi), Trifon Xhagjika, Tiranë, 2019, faqe 13.
- Andrea Llukani, *Dosja e teologut Theofan Popa*, Global Challenge, Revistë Shkencore Periodike, Botim i Akademisë Diplomatike Shqiptare, Volumi VI, Numri 2, Tiranë, Maj 2017, faqe 93.
- Andrea Llukani, Hasan Aliaj, *Il movimento Unita in Albania*, Le Radici, Anno 5, nr. 4, Ottobre 2007, pagina 1, 3.
- Andrea Llukani, *Historiku i kishës së Shën Prokopit*, Le Radici, Anno 15, n.3, Giugno 2017, pagina 17.
- Andrea Llukani, *Visarion Xhuvani martir i Kishës Ortodokse*, 55, 21 maj 2004, faqe 18.
- Danish Bebeziqi, *Si e njoha Peshkopin Irine*, Vegim Drite, Nr.4 qershor 1997, faqe 25.
- Dion Tushi, *Joakim Martiniani*, Kërkim, Nr. 6, Tiranë 2010, faqe 59-62.
- Dion Tushi, *Pjesë monografie për Evllogjio Kurillën*, Tempulli, Nr. 14, Korçë 2009, faqe 70-75.
- Dhimitër Beduli, *Teologë me origjinë shqiptare që janë diplomuar në Institutin Teologjik të Halkit*, Ngjallja, tetor 1996, faqe 10.
- Ilia Spiro Vasili, *Si e gjeta Episkopin Jerotheos*, Ngjallja, gusht 1996, faqe 9.
- Ilia Spiro Vasili, *Jeta dhe veprimtaria e dhespotit Jerotheos*, Ngjallja, maj 2003, faqe 9,10.
- Irine Banushi-martir i Kishës sonë Orthodokse, Ngjallja, nëntor 2018, faqe 9.
- Fatmira Rama, *Sinodi i parë shqiptar dhe Kongresi i dytë panortodoks i Kishës Ortodokse Autoqefale Kombëtare, 70-vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1993, faqe 62.
- Kristofor Beduli, *Revista Zëri i Orthodoksisë*, Ngjallja, qershor 2002, faqe 4.
- Kristofor Beduli, *Psaltët Vlash Nushi e Vlash Semini*, Ngjallja, gusht 1997, faqe 8.
- Kaliopi Naska, *Kongresi themeltar i Kishës Ortodokse Autoqefale në Berat, në 70-vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Akademia e shkencave, Tiranë 1993, faqe 14-15.
- Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Si nisi lëvizja për shqiptarizimin e kishës ortodokse autoqefale*, Tema, 10-11 prill 2005, faqe 9.
- Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *1929, si u krijua Sinodi i parë i KOASH-it*, Tema, 16 prill 2005, faqe 9.
- Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Historia e fshehur e Kongresit të dytë të KOASH-it*, Tema, 5-6 qershor 2005, faqe 12-13.
- Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Si zgjidhej kryepeshkopi ortodoks në bazë të Statutit*, Tema, 7 qershor 2005, faqe 12-13.
- Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Kryetari i KOASH Visarion Xhuvani shpjegon statutin*, Tema, 8 qershor 2005, faqe 12-13.
- Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Si betoheshin episkopët e kishës ortodokse shqiptare*, Tema, 12 prill 2005, faqe 9.
- Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Çfarë parashikonte Rregullorja e KOASH-it*, Tema, 9 qershor 2005, faqe 12-13.
- Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Roli i Mbretit Zog në krijimin e KOASH-it*, Tema, 10 qershor 2005, faqe 12-13.
- Paskal Milo, *Ja si e humbën Shën Naumin*, Gazeta Shqiptare, 29 gusht 2003, faqe 7.
- Pavli Haxhillazi, *Një letër e panjohur e Visarion Xhuvanit*, Shqiptarja.com, 14 tetor 2012, faqe 20.
- Pavli Haxhillazi, *Një letër e panjohur e Visarion Xhuvanit*, Le Radici, Anno 10, Nr. 5, Ottobre 2012, pagina 18.
- Pilo Peristeri, *Vdiq Dhimitër Kokoneshi*, Bashkimi, 19 tetor 1973, faqe 2.

- Pirro Kondili, *Orthodhoksia: burim qëndrese dhe shprehje lirie në Shqipërinë komuniste*, Kërkim, nr.16, Tiranë, 2019, faqe 52-72.
- Personalitet madhor i Kishës sonë Orthodhokse*, Ngjallja, korrik 1996, faqe 9.
- Viron Koka, *Përpyekjet për njohjen e Kishës Ortodokse Autoqefale nga Patriarkana (vitet 20-30), 70-vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1993, faqe 74.
- Veprimet e fundit Patriarkale dhe Sinodike të Kishës së Kostandinopojës*, Orthodhoksia, Kostandinopojë, viti XII, 1937.

TABELA E ILUSTRIMEVE

KREU I PARË

- Fig.1. Delegatët e Kongresit të Beratit
- Fig.2. Çertifikatë pjesëmarrjeje në Kongresin e Beratit
- Fig.3. Hirësia e Tij Kristofor Kisi
- Fig.4. Dorëzimi Fan Nolit në gradën episkopale (Viti 1923)
- Fig.5. Sinodi i Visarion Xhuvanit (Viti 1929)
- Fig.6. Sinodi i vitit 1937
- Fig.7. Episkop Irine Banushi
- Fig.8. Kisi dhe Viktore Emanueli
- Fig.9. Priftërinj unite

KREU I DYTË

- Fig.1. Shkresa e Ministrisë së Drejtësisë për shkarkimin e Kotokos
- Fig.2. Letra e Visarion Xhuvanit
- Fig.3. Agathangjeli Zëvendëson Kotokon
- Fig.4. Irine Banushi, Episkop i Strugës
- Fig.5. Irine Banushi, Episkop i Strugës
- Fig.6. Titullar i dioqezës së Gjirokastrës Irine Banushi
- Fig.7. Delegacioni zyrtar në Bashkimin Sovjetik
- Fig.8. Koka e shkresave zyrtare
- Fig.9. Imzot Pasisi Vodica, Kryeepiskop
- Fig.10. Letër e datës 29 maj 1951, ku Kisi i shprehu pakënaqësinë delegacionit rus
- Fig.11. Letër e datës 29 maj 1951, ku Kisi i shprehu pakënaqësinë delegacionit rus
- Fig.12. Sinodi i Shenjtë i vitit 1952
- Fig.13. Imzot Damjani, Episkop i Gjirokastrës
- Fig.14. Qarkore nr. 24/11, datë 14 mars 1966, Damjani Kryeepiskop

KREU I TRETË

- Fig.1. Panairi i Shën Gjon Vladimirit në Elbasan
- Fig.2. Kisi në kremtimet e panairit të Shën Gjon Vladimirit, viti 1939
- Fig.3. Kisi mes koristëve të kishës së “Ungjillëzimit” në panairin e Shën Gjon Vladimirit
- Fig.4. Pamje nga kisha e Shën Prokopit, Tiranë
- Fig.5. Mihal Pjeshkazini me nxënësit e katekizmit
- Fig.6. Jetëshkrimi dhe akoluthia e Shën Kozmait, përkthyer nga Kristofor Kisi

KREU I PARË



Fig.1. Delegatët e Kongresit të Beratit



Fig.2. Çertifikatë pjesëmarrjeje në Kongresin e Beratit



Fig.3. Hirësia e Tij Kristofor Kisi



Fig.4. Dorëzimi Fan Nolit në gradën episkopale (Viti 1923)



Fig.5. Sinodi i Visarion Xhuvanit (Viti 1929)



Fig.6. Sinodi i vitit 1937



Fig.7. Episkop Irine Banushi



Fig.8. Kisi dhe Viktore Emanueli



Fig.9. Priftërinj unitë

KREU I DYTË




Fig.1. Shkresa e Ministrisë së Drejtësisë për shkarkimin e Kotokos




Fig.2. Letra e Visarion Xhuvanit




Fig.3. Agathangjeli Zëvendëson Kotokon

18

SINODHI I SHENJT I KISHES ORTH.AUTOQEPALE
TE SHQIPERISE

Mbledhje e parë.-
V E N D I M

Sot, më 4 Korrik 1945 në Selin e Kryesis së Kishës Orth.Autoqefale u-mblodh Sinodhi i Shenjt i Kishës në kryesinë e Kr.H.Tij Kryepiskopit të Gjith Shqipërisë Imsof Kristofor dhe në antarë H.H.T.T. Mitropolitin e Beratit-Vlorës Im. Vissarionin dhe Episkopin e Korçës dhe Zevëndës i Përgjithëshëm i Gjirokastërës Im. Agathangjelit.

U-anuar në bisedim qështja e H.Tij Im. Irinent, episkop i Strugës. Kryetari Kr.H;Tij Im. Kristofori deklaroi se H. e Tij Imsof Irineu ka qenë emëruar në vendim të Sinodhit episkop i Strugës, por gjer në sot dekreti qeveritar s'që e mundur të dalë; me gjith kësë Sinodhi i Shenjt vendosi që H. e Tij të marrë pjesë si antar i Sinodhit me cilësin si episkop i Strugës.

KRYETAR I SINODHIT TË SHENJT
KRYEPISKOPI KRISTOFOR

A N T A R E T:

Mitropolit i Beratit dhe i Vlorës

V i s s a r i o n

Episkop i Korçës dhe Zev. i Për. i Gjirokastërës

A g a t h a n g j e l

Pas vendimit të mësipërmë u-thirr për të marrë pjesë si antar i Sinodhit H. e Tij Episkop Irineu.

Kr. H. e Tij Kryepiskopi, si përshëndeti n'emër të Sinodhit të Shenjt H. e Tij Episkopin Irine duke theksuar se Shenjtëria e Tij ka për të dhënë, si antar i Sinodhit, gjith kontributin e tij, në zgjidhjen e problemevet që i përkasin Kishës, i bëri një përshkrim të shkurtër Sinodhit të Shenjt rreth vdekjes dhe varrimit të të ndjerit Episkop të Prizrenit Serafin, mik i singert i Shqipërisë, dhe të kujdesjevet që Kryesia e Kishës ka treguar gjat kohës së qëndrimit të tij në Tiranë.

Përveçdi pastaj ngjarjen gashore të njohjes së Autoqefalës së Kishës Ortodokse të Bullgarisë nga ana e Patriarhsisë Ekumenike, të qasjes së konfliktit që eksistonte qysh prej 73 vjetësh nërmyjet të dy Kishave si edhe të zgjedhjes së Mitropolitit të Sofjes Stefan.

Fig.4. Irine Banushi, Episkop i Strugës



Fig.5. Irine Banushi, Episkop i Strugës



Fig.6. Titullar i dioqezës së Gjirokastrës Irine Banushi



Fig.7. Delegacioni zyrtar në Bashkimin Sovjetik



Fig.8. Koka e shkresave zyrtare



Fig.9. Imzot Pasisi Vodica, Kryepiskop

Tirana le 29 Mai 1951. ✓

A son Eminence, le Chef de la Délégation
Eccles. Russe et à sa Suite,

Tirana.

Eminence,

Je Vous transmets de nouveau mes
salutations fraternelles et mes vœux pour
un séjour agréable dans notre pays.

Le Dimanche, 27-V-1951, aussitôt que
j'ai appris Votre arrivée, j'ai voulu Vous
faire une visite, mais les Autorités Ecclesi-
astiques, moyennant le serviteur de l'Arche-
vêché Kristo, m'ont communiqué l'ordre de ne
visiter la Délégation sans avoir une auto-
risation préalable de la part de la Presiden-
ce actuelle de l'Eglise, ce que j'ai accepté.
Le soir donc du même jour je suis descendu
à Dajti et j'y ai rencontré Mons. Zhokë, haut
fonctionnaire de la Section des Cultes au-
près ^{de} la présidence du Conseil des Ministres.
Je lui ai communiqué mon intention ainsi
que l'ordre ci-dessus. Il m'a répondu " Pour
aujourd'hui, Dimanche, une visite n'est pas
recommandable, car les membres de la Délégati-
on sont fatigués. Mais, a-t-il ajouté, demain

Fig.10. Letër e datës 29 maj 1951, ku Kisi i shprehu pakënaqësinë delegacionit rus

Lundi, aura lieu une réception dans l'Eglise de Saint Prokop, à 4 ou cinq heures après midi. Or, c'est Vous mêmes qui vous allez faire cette réception". Nous restâmes d'accord.

Le Lendemain, Lundi, j'ai rencontré à l'Hotel Dajti Mons. Niko Çane, Secrétaire général du Synode et de la présidence et je lui ai demandé des informations sur la réception de l'après midi. Il m'a répondu avec ces mots "La Délégation Ecclésiastique est venue en Albanie pour avoir contact seulement avec le Chef de l'Eglise. Or, mais il n'est point besoin que vous vous présentiez devant la Délégation. Vous ne devez pas participer à la réception d'aujourd'hui, ni vous présenter. Je Vous dis cela pour votre intérêt personnel.

Cette ordre ne vient pas de la Présidence de l'Eglise""?)

Une heure avant la réception une nouvelle ordre de la présidence de l'Eglise m'a été communiqué par le prêtre At Dhail de ne pas participer à la réception.

Pour éviter toute malentendu j'ai pensé de Vous mettre au courant de ces faits et je regrette vivement de n'avoir pu remplir un devoir. A cette occasion je Vous exprime ma haute considération.

Agare en Christ.

L'Ex Archevêque Kristofor.

Kristofor

Fig.11. Letër e datës 29 maj 1951, ku Kisi i shprehu pakënaqësinë delegacionit rus



Fig.12. Sinodi i Shenjtë i vitit 1952



Fig.13. Imzot Damjani, Episkop i Gjirokastrës



Tirane, datë 14/3/ 1966

KISHA ORTHODHOKSE AUTOQEFALE
E SHQIPNIS

KKYESIA
E
SINODHIT TË SHËNTË

ADMINISTRATA

Nr. 24/11 Prot.

Handwritten signature and date 14/3/66

EPISKOPATAVE TË HIRËSHME DHE
GJITHË ZËVËNDËSIVE MITROPOLITANE DHE
EPISKOPALE.--

Tirane

Q A R K O R E

Kemi nderin t'ju njoftojmë se Sinodhi i Shëntë i Kishës s'onë, në mbledhjen e tij të posaçme me datë 7 Mars 1966, vendosi unanimitisht dhe zgjodhi për Kryetar të Kishës Orthodhokse Autoqefale dhe Kryepiskop të gjithë Shqipërisë, Hirësinë e tij Episkopin e Gjirokastrës Dhamiano, i cili, po në mbështetje të vendimit të lartpërmëndur të Sinodhit të Shëntë, do të mbajë përkohësisht edhe drejtimin e Episkopatës së hirëshme të Gjirokastrës, si Ad Interim.

Duke u mbështetur në faktin e lartpërmëndur, porositen titullarët e episkopatave të hirëshme dhe titullarët e klari mvarhtës i zëvendësive

e/c

Fig.14 Qarkore nr. 24/11, datë 14 mars 1966, Damjani Kryepiskop

KREU I TRETË




Fig.1. Panairi i Shën Gjon Vladimirit në Elbasan



Fig.2. Kisi në kremtimet e panairit të Shën Gjon Vladimirit, viti 1939



Fig.3. Kisi mes koristëve të kishës së “Ungjillëzimit” në panairin e Shën Gjon Vladimirit



Fig.4. Pamje nga kisha e Shën Prokopit, Tiranë



Fig.5. Mihal Pjeshkazini me nxënësit e katekizmit

**Jetëshkrimi dhe akoluthia
E DËSHMORIT TE RI DHE ISAPOSTOLLIT
SHEN KOZMA**

*Kthyer nga Gërqishtja
prej Klerikut Orthodhoks*

Kr. K.



**Shtyp. dhe Libraria DHORI KOTI, — Korçë
1931**

Fig.6. Jetëshkrimi dhe akoluthia e Shën Kozmait, përkthyer nga Kisi

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Parathënie	3
------------------	---

KREU I PARË

Kongresi i Beratit.....	4
Dorëzimi i Visarionit në gradën episkopale	12
Protokolli i Tiranës.....	13
Krijimi i Sinodit të Shenjtë.....	16
Kongresi i Korçës.....	18
Tomi i Autoqefalisë.....	21
Sinodi i vitit 1942.....	25
Lëvizja unitë në Shqipëri.....	26

KREU I DYTË

Shkarkimi i Kotokos.....	28
Përplasja e Kisit me teologët e rinj.....	31
Gjendja e kishës pas arrestimit të Visarion Xhuvanit dhe të Irine Banushit.....	34
Vizita e delegacionit kishtar në Moskë.....	35
Shkarkimi i Kristofor Kisit dhe dorëzimi i Paskal Vodicës.....	36
Vizita e peshkopit Nikon në Shqipëri.....	40
Krijimi i Sinodit të Shenjtë.....	41
Vdekja e dyshimtë e Kristofor Kisit.....	43

KREU I TRETË

Tomi patriarkal dhe sinodik mbi bekimin e autoqefalisë së Kishës Ortodokse në Shqipëri.....	45
Letërkëmbimi ndërmjet Kristofor Kisit dhe avokat Vasil Dilos.....	47
Kristofor Kisi në panairin e Shën Gjon Vladimirit.....	50
Laboratori kimik i Kisit në kishën e Shën Prokopit.....	51
Jetëshkrimi dhe akoluthia e Shën Kozmait.....	53
Burime arkivore.....	62
Bibliografi.....	63
Tabela e ilustrimeve.....	66
Përmbajtja e lëndës.....	86